

VËLLIMI XXX /KORRIK-SHTATOR/ 2025

VENDIMET E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS 2025

BULETINI ZYRTAR



PËRMBAJTJA

Nr.1194, Datë 21.07.2025	6
“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E TRANSPORTIT DETAR NDËRKOMBËTAR TË UDHËTARËVË NË PORTIN E DURRËSIT DHE VLORËS”	
Nr.1195, Datë 21.07.2025	10
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT, NËPËRMJET BLERJES SË KAPITALIT, NË SHOQËRINË INFOSOFT BUSINESS SOLUTIONS SHPK.”	
Nr.1196, Datë 21.07.2025	17
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR, PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË ASSECO POLAND S.A. NGA SHOQËRITË YUKON NIEBIESKI KAPITAL B.V. DHE ADAM GÓRAL FUNDACJA RODZINNA”	
Nr.1198, Datë 25.07.2025	21
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR, PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT, INDIREKT, TË SHOQËRISË RETAIL PARK SHKODRA SHPK NGA SHOQËRITË CEE – BIG B.V. DHE BALFIN - BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SHPK”	
Nr.1199, Datë 25.07.2025	28
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR, NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË TOPCON CORPORATION NGA SHOQËRIA TK CO., LTD. DHE INDIREKT NGA KKR”	
Nr.1200, Datë 25.07.2025	32
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË SPAR ALBANIA SHPK NGA SHOQËRIA VIVA FRESH SHPK”	
Nr.1201, Datë 25.07.2025	36
“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR. 1156, DATË 29.01.2025 “PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NDAJ NDËRMARRJEVE VODAFONE ALBANIA SHA DHE ONE ALBANIA SHA NË TREGUN ME PAKICË TË SHËRBIMEVE CELULARE”	
Nr.1202, Datë 25.07.2025	38
“MBI VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR. 1084, DATË 10.05.2024	

“MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR. 921, DATË 09.11.2022 “PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E MENAXHIMIT TË FACILITETEVE TË PARKIMIT TË AEROPORTIT “NËNË TEREZA” (TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT) DHE MIRATIMIN E ANGAZHIMEVE SI TË DETYRUESHME NË FORMËN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE PËR NDËRMARRJEN STAR PARKING ALBANIA SHPK”

Nr.1203, Datë 27.08.2025.....45

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT, INDIREKT, TË SHOQËRISË TELECOM ITALIA SPARKLE S.P.A. NGA MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCAVE E REPUBLIKËS SË ITALISË DHE RETELIT S.P.A. NËPËRMJET SHOQËRISË BOOST BIDCO S.R.L.”

Nr.1204, Datë 27.08.2025.....50

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ILIRIADA SHPK NGA SHOQËRIA 4 A-M SHPK”

Nr.1205, Datë 27.08.2025.....54

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË AUSTRIA JUICE GMBH NGA SHOQËRIA AGRANA INTERNATIONALE VERWALTUNGS-UND ASSET-MANAGEMENT GMBH”

Nr.1206, Datë 27.08.2025.....58

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRIVE ENERGOTEHNIKA-JUŽNA BAČKA DOO NOVI SAD DHE ELEKTROMONTAŽA D.O.O. KRALJEVO NGA SHOQËRIA MVM ENERGETIKA ZÁRTKÖRÜEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG”

Nr.1207, Datë 27.08.2025.....60

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NGA KRIJIMI I SHOQËRISË JUST FUN BALKANS SHPK NËPËRMJET KONTROLLIT TË PËRBASHKËT NGA SHOQËRITË BALFIN B.V. DHE PIAZ INVESTMENT DOO SKOPJE DHE KRIJIMI I SHOQËRISË JUST FUN DISTRIBUTION SHPK NËPËRMJET KONTROLLIT TË PËRBASHKËT NGA SHOQËRITË BALFIN – BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SHPK DHE PIAZ INVESTMENT DOO SKOPJE”

Nr.1208, Datë 27.08.2025.....67

“PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRIVE BALFIN B.V., BALFIN – BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SHPK DHE PIAZ INVESTMENT DOO SKOPJE, PËR MOS NJOFTIMIN BRENDA AFATIT TË PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NDËRMARRJES SË PËRBASHKËT, ME FUNKSIONE TË PLOTA, JUST

FUN BALKANS SHPK DHE JUST FUN DISTRIBUTION SHPK”.

Nr.1209, Datë 11.09.2025.....	71
“PËR NJË KORRIGJIM GABIMI NË PËRLLOGARITJE TË GJOBËS SË VENDOSUR SHOQËRIVE BALFIN B.V. DHE PIAZ INVESTMENT DOO SKOPJE ME VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR. 1208, DATË 27.08.2025, “PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRIVE BALFIN B.V., BALFIN – BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SHPK DHE PIAZ INVESTMENT DOO SKOPJE, PËR MOS NJOFTIMIN BRENDA AFATIT TË PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NDËRMARRJES SË PËRBASHKËT, ME FUNKSIONE TË PLOTA, JUST FUN BALKANS SHPK DHE JUST FUN DISTRIBUTION SHPK”	
Nr.1210, Datë 11.09.2025.....	74
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË NRG POWER SHPK NGA SHOQËRITË SUSTAINABLE ENERGY SOLUTIONS S.M.S.A. DHE DEPA COMMERCIAL S.A..”	
Nr.1211, Datë 11.09.2025.....	79
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. NGA SHOQËRITË EURIZON CAPITAL REAL ASSET SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A. dhe ERSEL ASSET MANAGEMENT SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A.. (i ndryshuar ¹)”	
Nr.1212, Datë 11.09.2025.....	84
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM, INDIREKT, TË SHOQËRIVE E.ON ENERGIE ROMÂNIA S.A. DHE E.ON ASIST COMPLET S.A. NGA SHOQËRIA MVM ENERGETIKA ZÁRTKÖRÜEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG”	
Nr.1213, Datë 11.09.2025.....	88
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË IVECO GROUP N.V. NGA SHOQËRIA TML CV HOLDINGS PTE. LTD.”	
Nr.1214, Datë 26.09.2025.....	92

¹ Ndryshuar me VKK nr. date 10.10.2025 “PËR NJË KORRIGJIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR.1211, DATË 11.09.2025, “MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. NGA SHOQËRITË EURIZON CAPITAL REAL ASSET SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A. DHE ERSEL ASSET MANAGEMENT SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A.”.

“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE LIDHUR ME DOKUMENTIN PËR KËSHILLIM PUBLIK “ANALIZË E TREGUT TELEFONISË FIKSE: TREGJET ME SHUMICË TË TERMINIMIT DHE TRANZITIMIT TË THIRRJEVE NË RRJETET TELEFONIKE PUBLIKE NGA VENDNDODHJE FIKSE”

Nr.1215, Datë 06.09.2025108

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR. 1171, DATË 26.03.2025 “PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE PËR NDËRMARRJET: OTP BANK ALBANIA SHA, BANKA KOMBËTARE TREGTARE SHA, CREDINS BANK SHA, BANKA RAIFFEISEN SHA, BANKA E TIRANËS SHA, INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SHA, UNION BANK SHA, E-BUSINESS SOLUTIONS SHPK, BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË SHA, BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA DHE ABI BROKER SIGURIMESH SHA DHE NË TREGUN E KREDIDHËNIES ME SIGURIM JETE PËR KREDITË QË JEPEN BRENDË BANKËS BANKËS SË PARË TË INVESTIMEVE SHA DHE BANKËS PROCREDIT SHA”

Nr.1216, Datë 26.09.2025111

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË NJËSISË SË BIZNESIT TË SHOQËRISË CAPITANI S.R.L. NGA SHOQËRIA ILLYCAFFÈ S.P.A.”

Nr.1217, Datë 26.09.2025115

MBI MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRJASHTIMIN E DISA KATEGORIVE TË MARRËVESHJEVE TË KËRKIMIT DHE ZHVILLIMIT”

VENDIM

Nr. 1194, Datë 21. 07. 2025

“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E TRANSPORTIT DETAR NDËRKOMBËTAR TË UDHËTARËVË NË PORTIN E Durrësit dhe Vlorës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21. 07. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimin e kërkesës së Sekretariatit për hapjen e procedurës së hetimit paraparak në tregun e transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve në portin e Durrësit dhe Vlorës.

Baza Ligjore: Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42 pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të: Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi monitorimin e tregut të transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve në portin e Durrësit dhe Vlorës”

VËREN SE :

Sekretari i Përgjithshëm, bazuar në nenin 28 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me anë të Urdhrit nr. 66, datë 03.06.2025 “Për ngritjen e grupit të punës “Për monitorimin e tregut të transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve në portin e Durrësit”, ngriti grupin e punës përgjegjës për monitorimin, për analizimin e kushteve të këtij tregu, me qëllim evidentimin nëse ka apo jo shenja të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës në këtë treg .

Në vijim, pranë Autoritetit të Konkurrencës në datë 05.06.2025, ka ardhur në rrugë elektronike (me e-mail), një ankesë, nëpërmjet së cilës pretendohet se nga tre tragete që kanë operuar në portin e Vlorës, tashmë operon vetëm një kompani, e cila sipas ankimesit, vendos çmime abuzive ndaj udhëtarëve (protokolluar pranë AK-së me nr. 547 prot., datë 10.06.2025). Prandaj, bazuar kësaj

ankese, në bazë të nenit 28 dhe 29/1 të ligjit nr. 9121/2003, Sekretari i Përgjithshëm me anë të Urdhrit nr. 66/1, datë 11.06.2025 “Për një shtesë në urdhrin nr. 66, datë 03.06.2025, “Për ngritjen e grupit të punës për monitorim e tregut të transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve në portin e Durrësit, në monitorim shtohet dhe porti i Vlorës.

Në vazhdim të procedurës, në zbatim të urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm u realizua monitorim në terren pranë ndërmarrjeve, Ventouris Ferries SHPK (Duni Port Agency), Adria Ferries SHPK dhe Euro Ferries SHPK si dhe u kërkuar informacion nga Autoriteti Portual Durres, Autoriteti Portual Vlorë dhe MIE.

Shërbimi i transportit detar ndërkombëtar i udhëtarëve kryhet nëpërmjet operatorëve dhe agjensive detare si më poshtë:

Në portin e Durrësit ushtrojnë veprimtarinë e tyre 3 operatorë të cilat kryejnë transportin detar ndërkombëtar të automjeteve dhe udhëtarëve nga Porti i Durrësit, në Portet e Barit, Ankonës.

Linja Durrës – Bari – Durrës. Në këtë linjë ushtrojnë veprimtarinë e tyre:

Operatori *Adria Ferries S.p.A*, me seli në Ankona, Itali, i cili përfaqësohet në Shqipëri nga agjensia *AF Agency shpk*, me qendër në Durrës, me numër NUIS M31912504F kryen transport në linjën ndërkombëtare detare për pasagjerë me nisje nga porti i Durrësit drejt portit të Barit dhe anasjelltas, nëpërmjet 3 trakteve përkatësisht, AF Francesca dhe AF Marina.

1. Operatori *Nobel Maritime INC* me seli në Pire, Greqi, është kompania menaxhuese e trakteve të “VENTOURIS FERRIES”, të cilët përfaqësohen në Shqipëri nga agjensia *Duni Port Agency SHPK*, dhe realizon transportin e automjeteve dhe udhëtarëve nga Porti i Durrësit drejt Portit të Barit, nëpërmjet 4 trakteve përkatësisht “Rigel I”, “Rigel II”, “Rigel III” dhe “Bari”.
2. Operatori *Grandi Navi Veloci*, i cili përfaqësohet në Shqipëri nga agjensia *Niki Mare SHPK*, dhe realizon transportin e automjeteve dhe udhëtarëve nga Porti i Durrësit në Portin e Barit nëpërmjet 1 trakti “GNV Azzurra”, operator i cili aktualisht është zëvendësues.

Në lidhje me cmimet e aplikuara nga ndërmarrjet Duni dhe Adria Ferries vërehen se për kategorinë kalim i thjesht (Deck) e cila është dhe kategoria e cila përdoret masivisht nga udhëtarët, cmimet e aplikuara në sezonin e ulët dhe të lartë paraqiten të përafërta me njëra – tjetrën midis këtyre dy ndërmarrjeve.

Linja Durrës – Ancona – Durrës: Në destinacionin Durrës-Ankona-Durrës operon vetëm linja e trakteve të Agjensisë Adria FerriesShpk:

3. Pra, për këtë linjë Operatori *AF Agency S.p.A*, me seli në Ancona, i cili përfaqësohet në Shqipëri nga agjensia *Adria Ferries SHPK*, operon nëpërmjet një trakti AF Michela, operator i cili nuk përballlet me konkurrentë të drejtëpërdrejtë, ai është i vetëm në tregun përkatës për këtë linjë.

Në lidhje me ofrimin e transportit ndërkombëtar të udhëtarëve për linjën Durrës – Ankona – Durrës, nga konstatimet e monitorimit pranë ndërmarrjes Adria Ferries, rezulton se vetëm kjo ndërmarrje operon në ofrimin e shërbimit të transportit në këtë linjë. Në lidhje me cmimet e aplikuara nga kjo ndërmarrje gjatë sezonit të ulët për periudhën janar – maj 2025, rezulton se kemi një rritje nga 10 – 30 euro për shumicën e kategorive të ofruara krahasuar me vitin 2024, ndërsa gjatë sezonit të lartë për periudhën janar – maj 2025 vihet re se për kategoritë që preferohen në masë nga pasagjerët përkatësisht kategoria hyrje e lirë dhe kategoria poltron nuk kanë pësuar ndryshime krahasuar me vitin 2024, por vetëm kategoritë e tjera të cilat përfshijnë kabina kanë pësuar një rritje nga 5 – 23 euro.

Linja Vlorë – Brindisi – Vlorë Në Portin e Vlorës ushtron veprimtarinë e tij operatori **Tnitsea Shipping LDA**, e cila përfaqësohet në Shqipëri nga agjencia: **Euroferries SHPK**, me seli në Vlorë me përfaqësues ligjor Z.Agron Brataj me NUIS L17324201O dhe e ushtron veprimtarinë e tij nëpërmjet 1 trageti. Ky traget kryen transportin detar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve nga Porti i Vlorës në Portin e Brindisit në Itali dhe anasjelltas. Ky traget është i vetmi që ushtron veprimtari në këtë port, pasi operatori **A-ships Management SA**, i cili përfaqësohej nga agjencia detare **Gerveni Sea Lines SHPK**, nuk operon më në këtë port, pavarësisht se ka pasur kërkesa për të operuar gjithë vitin, nuk ka operuar rregullisht, dhe në datë 04.10.2024 ka ndërprerë operimin në mënyrë të njëanshme. Edhe në këtë port për më shumë se një periudhë 1- vjeçare, ky operator e realizon transportin e mallrave dhe udhëtarëve i vetëm, duke mos patur konkurrentë në këtë zonë gjeografike.

Në lidhje me cmimet e aplikuara për periudhën janar – maj 2025 për ndërmarrjen Euroferries SHPK, rezulton se gjatë sezonit të lartë kemi një rritje prej 10 – 35 euro krahasuar me sezonin e ulët.

Sa më sipër rezulton se:

- Në linjën Durrës – Ankona Durrës operon vetëm ndërmarrja Adria SHPK nëpërmjet një trageti, operator i cili nuk përballlet me konkurrentë të drejtpërdrejtë, duke zotëruar 100% të tregut përkatës për këtë linjë, pra kemi një treg shumë të përqendruar;
- Në linjën Vlorë – Brindisi – Vlorë operon vetëm një operator nëpërmjet 1 trageti, operator i cili nuk përballlet me konkurrentë të drejtpërdrejtë, duke zotëruar 100% të tregut përkatës për këtë linjë duke sjellë një treg shumë të përqendruar;
- Në linjën Durrës – Bari – Durrës vërehet se operatorët aplikojnë tarifa drejt cmimit tavan në periudhat e sezonit të lartë duke paraqitur diferenca jo domethënëse ndërmjet njëra tjetres. Gjithashtu ritmi i ndryshimit të cmimit ndërmjet operatorëve në uljen dhe rritjen e tarifave të aplikuara është i njëjtë dhe në të njëjtën kohe.

Në përfundim, duke vlerësuar përqendrimin e lartë të tregut dhe mungesën e konkurrencës në linjat Vlorë – Brindisi – Vlorë dhe Durrës – Ankona – Durrës, sjelljen e operatorëve Adria Ferries përfaqësues i operatorit AFH S.P.A, agjencia Duni Shpk përfaqësues i Venturis Ferries,

të cilët operojnë në linjën Durrës – Bari – Durrës nëpërmjet aplikimit të çmimeve drejt maximumit në sezonin e lartë dhe me ritme të njëjta të ndryshimit në rritje dhe në zbritje, lind dyshimi i arsyeshëm që sjellja e ndërmarrjeve të cilat operojnë në portin e Durrësit dhe në Portin e Vlorës, mund të përbëjë pengim, kufizim apo shtrembërim të konkurrencës në tregun përkatës.

Për sa më sipër, sjellja e operatorëve dhe agjencive detare Adria Ferries përfaqësues i operatorit AF Agency S.P.A, agjensia Duni Shpk përfaqësues i Venturis Ferries dhe Ionnian Islan SHPK përfaqësues i European Seaways me destinacion portet italiane, duke tregtuar bileta me çmime thuajse të njëjta dhe afër tavanit të tarifave miratuar nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, mund të jetë një sjellje të koordinuar, e cila në bazë të nenit 4 ose 9, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, mund të përbëjë kufizim të konkurrencës në kuptim të neneve 4 dhe 9 të ligjit 9121, datë 28.07.2013 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 4, nenit 9, nenit 24, shkronja d), si dhe nenit 42 pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve në portin e Durrësit dhe Vlorës.
2. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 Janar 2022 deri në 30 Qershor 2025;
3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1195, Datë 21. 07. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT, NËPËRMJET BLERJES SË KAPITALIT, NË SHOQËRINË INFOSOFT BUSINESS SOLUTIONS SHPK.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21. 07. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit, nëpërmjet blerjes së kapitalit, në shoqërinë InfoSoft Business Solutions SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimit ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit, nëpërmjet blerjes së kapitalit, në shoqërinë InfoSoft Business Solutions SHPK,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar mbi transaksionin e përfutimit të kontrollit, nëpërmjet blerjes së kapitalit, në shoqërinë InfoSoft Business Solutions SHPK.

Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në transaksion janë:

Pala blerëse : z. Armand Shara dhe z. Bledar Dhima, shtetas shqiptar.

- z. Armand Shara zotëron kuota në shoqërinë InfoSoft Business Solutions SHPK, pjesëmarrje kontrolluese në shoqërinë TAG Engineering SHPK, e cila ka për objekt aktiviteti pjesëmarrje në shoqëri të tjera, si dhe në organe drejtuese të këtyre shoqërive dhe shoqëritë INFOSOFT SYSTEMS SHPK, ikubINFO SHPK, ikubINFO International SHPK dhe InfoSoft Business

Solutions SHPK, të cilat operojnë në tregun e teknologjisë së informacionit, import- eksport dhe tregtim të sistemeve të teknologjisë së informacionit për përpunimin e të dhënave të të gjitha llojeve si: hardware, software, networking dhe të gjithë periferikëve të tyre, si dhe dizënim software-i, analiza e kërkesave të sistemit software, projektimi i arkitekturës dhe projektimi i detajuar i sistemit software; zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software etj.

-z. Bledar Dhima, zotëron pjesëmarrje kontrolluese në shoqërinë INFOSOFT SYSTEMS SHPK dhe zotëron kuota në shoqërinë InfoSoft Business Solutions SHPK.

Pala shitëse: Investment Joti - Infosoft Group SHPK ka për objekt aktiviteti: Pjesëmarrje në shoqëri, si dhe në borde drejtuese të shoqërive. Konsulencë në menaxhim dhe administrim biznesi. Menaxhim i shoqërive tregtare. Veprimtari të blerjes, shitjes dhe qiradhënies, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme. Rekrutim dhe menaxhim i burimeve njerëzore etj. Konsulencë juridike dhe përfaqësim në institucione shtetërore në fushën civile, penale, tregtare dhe administrative. Konsulencë financiare, kontabiliteti, auditimi si dhe tatimore. Shërbime dhe zhvillime të programeve të teknologjisë informative, etj.

Shoqëria Target: InfoSoft Business Solutions SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar. InfoSoft Business Solutions SHPK ka për objekt aktiviteti: a. Dizënim software-i. Këtu përfshihet analiza e kërkesave të sistemit software, projektimi i arkitekturës dhe projektimi i detajuar i sistemit software; b. Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software. Këtu përfshihet programimi i sistemeve software, kodimi, instalimi, integrimi i të gjithë komponentëve, dokumentimi, identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve, modifikimet (pas momentit që software-i është vendosur në operim), mirëmbajtja e të gjithë komponentëve, suporti i sistemit si një tërësi komponentësh, që, në funksionimin e tyre, realizojnë qëllimin e Zgjidhjes Informatike. c. Testim software. Këtu përfshihet testimi i funksionaliteteve, të ngarkesës në punë, të performancës, të pranimi, të disponueshmërisë dhe të sigorisë së sistemit software. d. Dizënim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit. Këtu përfshihet analiza, planifikimi, projektimi, zbatimi, vendosja në punë dhe mirëmbajtja e sistemeve të komunikimit të rrjeteve të pajisjeve informatike (LAN/ WAN/ LAN/ MAN/ SAN/ CAN). e. Dizënim dhe zhvillim sistemesh të sigorisë. Këtu përfshihet analiza e kërkesave të sigorisë së klientit, projektimi i arkitekturës, instalimet dhe konfigurimet e komponentëve, vendosja në punë, testimet e sigorisë dhe mirëmbajtja përkatëse. f. Zhvillim sistemesh migrimi. Këtu përfshihet transferimi i të dhënave dhe infrastrukturës përkatëse nga një teknologji e vjetër në një teknologji të re. g. Përmirësim/upgrade sistemesh informatike. h. Operimi, menaxhimi, suporti i përdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik për sistemet software. i. Qendër e formimit profesional për implementim Microsoft Dynamics Nav, Aftësim profesional në Data Analytics and Business Intelligence, Analizë Biznesi në Business Central, si dhe Implementim Dynamics CRM. Shoqëria mund të kryejë edhe veprimtari të tjera ndihmëse të cilat mbështesin arritjen e qëllimit të saj kryesor në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Struktura e pronësisë në shoqërinë InfoSoft Business Solutions SHPK, para transaksionit, rezultonte e ndarë me 3 (tre) kuota, ku: shoqëria Investment Joti – Infosoft Group SHPK zotëronte

një kuotë që përfaqëson XX% të kapitalit të shoqërisë; z. Bledar Dhima zotëronte një kuotë që përfaqëson XX% të kapitalit të shoqërisë dhe shoqëria TAG Engineering SHPK zotëronte një kuotë që përfaqëson XX% të kapitalit të shoqërisë.

II. Transaksioni

Nëpërmjet palës blerëse z. Armand Shara (dhënës pëlqimi znj. Edlira Shara), z. Bledar Dhima (dhënës pëlqimi znj. Mirela Dhima) dhe palës shitëse shoqërisë Investment Joti – Infosoft Group SHPK është lidhur “Kontratë për shitjen e kuotës (Me kusht)”, nënshkruar më datë [_____] dhe “Amendament nr.1 të Kontratës për shitjen e kuotës me kusht, datë [_____]”, datë [_____].

Referuar “Kontratës për shitjen e kuotës (Me kusht)”, datë [_____] , objekt i kësaj kontrate është shitja dhe transferimi i Kuotës në Shitje (që përfaqëson XX% të kapitalit, me vlerë nominale të regjistruar prej X [_____] lekë në pronësi të blerësve në shoqërinë InfoSoft Business Solutions SHPK, nga shitësi tek blerësit sipas kushteve të kësaj kontrate.

Pas kalimit të pronësisë së Kuotës në Shitje tek blerësit, shitësi largohet nga shoqëria dhe blerësit mbeten ortakët e vetëm të shoqërisë, si vijon:

- (i) z. Armand Shara zotëron XX% të kapitalit të shoqërisë,
- (ii) z. Bledar Dhima zotëron XX% të kapitalit të shoqërisë,
- (iii) Shoqëria TAG Engineering SHPK zotëron XX% të kapitalit të shoqërisë (indirekt nga z. Shara).

Referuar pikës 3.1 të nenit 3 “Kalimi i pronësisë së kuotave në shitje” të Kontratës, pronësia mbi Kuotat në Shitje i kalon blerësve pas likuidimit të plotë nga secili prej tyre i çmimit të plotë të kësaj Kontrate.

Nëpërmjet Vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë Investment Joti – Infosoft Group SHPK dhe InfoSoft Business Solution SHPK, është vendosur; miratimi i shitjes së plotë të kuotës (XX%) që ortaku i shoqërisë Investment Joti – Infosoft Group SHPK, zotëron në kapitalin e shoqërisë Info Business Solutions SHPK, në favor të ortakëve z. Armand Shara dhe z. Bledar Dhima.

Po më datë [_____] , me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve të shoqërisë Investment Joti – Infosoft Group është vendosur: Emërimi i z. Bledar Dhima si përfaqësues i posaçëm i shoqërisë Investment Joti – Infosoft Group SHPK me të drejta dhe kompetenca të plota për të përfaqësuar ligjërisht shoqërinë Investment Joti – Infosoft Group SHPK, me të gjitha tagrat, në marrëdhënie me shoqërinë Info Business Solutions SHPK, në marrëdhëniet me administrimin, administratorin/et e kësaj shoqërie, si dhe në mbledhjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë Info Business Solutions SHPK, etj.

Të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesi, sipas këtij vendimi, në emër dhe për llogari të shoqërisë Investment Joti – Infosoft Group SHPK, konsiderohen të mirëqena dhe të drejta, si të

ishin kryer nga vetë shoqëria. Ky vendim është i vlefshëm deri në plotësimin e kushtit sipas Kontratës për shitblerjen e Kuotës datë [_____].

Më datë [_____], pala blerëse dhe pala shitëse kanë nënshkruar “Amendament nr.1 të Kontratës për shitjen e kuotës me kusht, datë [_____]”.

Në këtë Kontratë është cilësuar se kanë ndodhur ndryshime në kontratën bazë “Kontratë për shitjen e kuotës (Me kusht)”, nënshkruar më datë [_____] ku gjatë kësaj kohe, emri i shoqërisë ishte Info Business Solutions SHPK dhe ka ndryshuar në InfoSoft Business Solutions SHPK.

Në amendimin e kontratës, janë pasqyruar ndryshime në nenin 3 “Kalimi i pronësisë së kuotave në shitje”, ku përmbajtja e pikës 3.1 citonte se: Pronësia mbi Kuotat në Shitje i kalon blerësve pas likuidimit të plotë nga secili prej tyre i çmimit të plotë të kësaj Kontrate.

Kjo pikë shprehet me përmbajtjen: Pronësia mbi Kuotat në Shitje i kalon blerësve në datën e nënshkrimit të këtij amendamenti dhe konkretisht më datë [_____]. Nga kjo datë, pronësia e Kuotës në Shitje kalon tek blerësit, dhe shitësi largohet nga shoqëria duke qëndruar ortakët si vijon:

- (i) z. Armand Shara zotëron XX% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë nominale [_____]lekë.
- (ii) z. Bledar Dhima zotëron XX% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë nominale [_____]lekë.
- (iii) Shoqëria TAG Engineering SHPK zotëron XX% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë nominale, [_____] lekë.

Referuar Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimit ndërmjet ndërmarrjeve”, pika 78 është përcaktuar se: Hyrja e aksionarëve të rinj në një ndërmarrje të kontrolluar bashkërisht ose duke shtuar numrin e aksionarëve tashmë kontrollues ose duke zëvendësuar një nga ata, gjithashtu përbën një përqendrim që duhet njoftuar, pavarësisht se ndërmarrja kontrollohet bashkërisht para dhe pas operacionit. *Së pari*, gjithashtu në këtë skenar ka një aksionar, i cili rishtazi përfton kontrollin e joint venture. *Së dyti*, cilësia e kontrollit të joint venture përcaktohet duke identifikuar të gjithë aksionarët kontrollues. Kjo shtrihet në natyrën e kontrollit të përbashkët ku secili aksionar më vete ka të drejta bllokuese në lidhje me vendime strategjike, aksionarët e përbashkët kontrollues duhet të marrin në konsideratë interesat e njëri-tjetrit dhe u kërkohet që të bashkëpunojnë për përcaktimin e sjelljeve strategjike të një sipërmarrje të përbashkët.

Duke qenë se, në shoqërinë target InfoSoft Business Solutions SHPK ka hyrë një aksionar i ri kontrollues, z. Armand Shara, i cili do të zotërojë në vazhdim direkt në shoqërinë target XX% të kapitalit të shoqërisë dhe indirekt XX% të kapitalit të shoqërisë, atëherë hyrja e këtij aksionari të ri në shoqërinë target të kontrolluar bashkërisht, përbën një ndryshim kontrolli.

Ortaku z. Bledar Dhima do të zotërojë XX% të kapitalit, duke i dhënë të drejtën që për vendimet me shumicë të thjeshtë, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.

Për sa më sipër, transaksioni i realizuar konsiston në përftimin e kontrollit, nëpërmjet blerjes së kuotave në shoqërinë InfoSoft Business Solutions SHPK, transaksion i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i zgjidhjeve software-ike.

Tregu përkatës gjeografik: Për analizimin e këtij rasti, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Tregu i zgjidhjeve software-ike është pjesë e tregut të teknologjisë së informacionit, i cili përfshin një tërësi produktesh digjitale ose teknologjike, të cilat shpesh integrohen në sisteme më të gjera duke ndërvepruar me njëri-tjetrin, ose nëpërmjet ofrimit mes një morie shërbimesh të lidhura mes tyre. Shërbimet digjitale shpesh ofrohen në platforma shumë-palëshe, potencialisht të kontrolluara nga kompanitë që kanë një rol të dyfishtë si ndërmjetëse dhe konkurrencte në këto platforma.

Dy segmentet kryesore të tregut të teknologjisë së informacionit janë **softueri dhe hardueri**.

Softueri është një set instruksionesh, të dhënash ose programesh që përdoren në funksion të kompjuterit.

Softueri mund të ndahet në 2 kategori kryesore:

1. Softuer aplikacioni (application software), i cili kryen detyra specifike për përdoruesit.
2. Softuer sistemi (systems software) është projektuar për të drejtuar harduerin e një kompjuteri dhe ofron një platformë për aplikacionet që do të funksionojnë mbi të.

Shoqëria target, InfoSoft Business Soution SHPK, ofron shërbime sipas nevojës së klientit, në fusha funksionale si: Menaxhim burimesh njerëzore dhe pagash (HR& Payroll); menaxhim kontratash dhe buxhetesh; zgjidhje për e-commerce dhe fiskalizim elektronik; Business Intelligence (BI) përmes platformave Power BI dhe SQL Server; zhvillim aplikacionesh dhe konfigurime lejesh përdorimi; menaxhim inventari dhe zinxhirit të furnizimit dhe Integrim sistemesh dhe migrim të dhënash.

Pavarësisht evidentimit nga pala njoftuese e produkteve të diferencuara, për efekt të vlerësimit të strukturave të tregut dhe për arsye të mungesës së të dhënave sasiore, të detajuara, mbi këto produkte në treg, është gjykuar që përcaktimi i tregut përkatës të produktit të mos diferencohet në nivelin e natyrës së produktit, por të përkufizohet si tregu i zgjidhjeve software-ike.

Shoqëritë INFOSOFT SYSTEM SHPK, InfoSoft Business Soution SHPK, ikubINFO SHPK dhe ikubINFO International SHPK kanë realizuar të ardhura në tregun përkatës të produktit dhe mbështetur mbi të dhënat e administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për vitin 2022-

2023, u konstatua se shoqëria target dhe shoqëritë e lidhura me palët në transaksion zotërojnë së bashku rreth zë X% të tregut për vitin 2022 dhe 2023.

Tregu i zgjidhjeve software-ike karakterizohet nga një numër shumë i madh ndërmarrjesh, ku secila prej tyre zotëron një pjesë të vogël tregu dhe treguesi i përqendrimit HHI është shumë i ulët, duke treguar për një treg me përqendrim të ulët.

Nga analiza e konkurrencës, u konstatua se transaksioni i ndryshimit të kontrollit të shoqërisë Infosoft Business Solutions SHPK, nuk pati për pasojë ndryshimin e strukturave të tregut përkatës, pasi z. Armand Shara ka qenë ortak kontrollues, indirekt, edhe më parë në kuotat e shoqërive të sipërcituara. Për pasojë struktura e tregut do të mbetet e pandryshuar edhe pas realizmit të përqendrimit.

Duke qene se shoqëria INFOSOFT SYSTEMS SHPK, realizon mbi XX% të të ardhurave në tregun e hardware-ve, mbështetur në të dhënat e DPT u analizua edhe struktura e tregut të shitjes së pajisjeve elektronike, që përfshin: tregtinë me shumicë të kompjuterëve, pajisjeve periferike të kompjuterëve dhe programeve dhe tregtinë me pakicë të kompjuterëve, njësive periferike në dyqane të specializuara.

Nga vlerësimi i informacionit të administruar, u konstatua se shoqëria INFOSOFT SYSTEM SHPK është një nga shoqëritë kryesore në tregun e shitje së hardware-ve dhe pajisjeve të lidhura me to, por pa evidentuar pjesë të konsiderueshme në treg. Edhe ky treg karakterizohet nga një numër i madh ndërmarrjesh dhe më indekse të ulëta të përqendrimit të tregut.

Edhe në këtë treg, transaksioni i ndryshimit të kontrollit të shoqërisë Infosoft Business Solutions SHPK, nuk do të sjellë për pasojë ndryshimin e strukturës të tregut të lidhur, pasi z. Armand Shara dhe z. Bledar Dhima kanë qenë ortak kontrollues, direkt/indirekt, edhe më parë në kuotat e shoqërisë INFOSOFT SYSTEM SHPK. Për pasojë struktura e tregut do të mbetet e pandryshuar edhe pas realizmit të përqendrimit.

Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës vlerëson se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit, nëpërmjet blerjes së aksioneve në shoqërinë InfoSoft Business Solutions SHPK.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1196, Datë 21. 07. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR, PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË ASSECO POLAND S.A. NGA SHOQËRITË YUKON NIEBIESKI KAPITAL B.V. DHE ADAM GÓRAL FUNDACJA RODZINNA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21. 07. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar, për përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë ASSECO POLAND S.A. nga shoqëritë Yukon Niebieski Kapital B.V. dhe ADAM GÓRAL FUNDACJA RODZINNA.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përftimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë ASSECO POLAND S.A. nga shoqëritë Yukon Niebieski Kapital B.V. dhe ADAM GÓRAL FUNDACJA RODZINNA,

VËREN SE :

1. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i propozuar për përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë ASSECO POLAND S.A. nga shoqëritë Yukon Niebieski Kapital B.V. dhe ADAM GÓRAL FUNDACJA RODZINNA.

Aplikuesi 1: Yukon Niebieski Kapital B.V. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Holandës, e krijuar për qëllimet e transaksionit të propozuar dhe për këtë arsye nuk ka ndonjë aktivitet biznesi të vetin.

Yukon Niebieski Kapital B.V. zotërohet 100% nga shoqëria TSS EUROPE B.V., [_____]. Kjo e fundit kontrollohet vetëm nga Constellation Software Inc. (CSI), e cila blen, menaxhon dhe ndërton biznese që ofrojnë zgjidhje softuerike në të gjithë botën.

Yukon dhe CSI nuk kanë prezencë ligjore në Shqipëri [_____].

Aplikuesi 2: ADAM GÓRAL FUNDACJA RODZINNA (AG) është një fondacion familjar, i themeluar sipas ligjeve të Polonisë, i cili menaxhon investimet në emër të z. Adam Góral.

AG nuk është prezente dhe nuk ka realizuar xhiro në Shqipëri.

Shoqëria Target: ASSECO POLAND S.A. është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit të Polonisë, e listuar publikisht me aksionet e saj në Bursën e Varshavës. ASSECO POLAND S.A. është shoqëria aksionare e grupit të shoqërive Asseco (Grupi Asseco), i cili operon në sektorët e softuerëve dhe IT-së.

ASSECO POLAND S.A. operon në mënyrë indirekte në tregun shqiptar nëpërmjet shoqërive *ASEE Albania SHPK, HELIUS SYSTEMS SHPK dhe CLEVER SOLUTION SHPK*, shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, të themeluara sipas legjislacionit shqiptar, aktive në tregun e ofrimit të produkteve softuerike dhe shërbimeve të IT-së.

Shoqëria target aktualisht zotërohet nga AG, Yukon Niebieski Kapital B.V., Allianz OFE, Nationale Nederlanden OFE, ASSECO POLAND (aksione vetjake²), PZU Zlota Jesien OFE dhe të tjera. Sipas deklaratës së palës njoftuese, përqindja e aksioneve të zotëruara nga Yukon Niebieski Kapital B.V. dhe AG në ASSECO POLAND S.A. përbëjnë një interes jo-kontrollues. Asnjë nga aksionarët nuk e kontrollon vetëm ose bashkërisht ASSECO POLAND S.A.

2. Transaksioni³

Më datë [_____], palët Yukon Niebieski Kapital B.V., ADAM GÓRAL FUNDACJA RODZINNA dhe ASSECO POLAND S.A. kanë nënshkruar “Marrëveshje me kushte për shitjen dhe blerjen e aksioneve”.

Referuar kësaj marrëveshje, Yukon Niebieski Kapital B.V. synon të blejë aksione thesari nga ASSECO POLAND S.A., që përfaqësojnë një shtesë prej XX% të kapitalit aksionar të ASSECO, duke e rritur pjesëmarrjen e përgjithshme të Yukon Niebieski Kapital B.V. në ASSECO në afërsisht XX%.

Më datë [_____], palët ADAM GÓRAL FUNDACJA RODZINNA, Yukon Niebieski Kapital B.V. dhe TSS Europe BV kanë nënshkruar “Marrëveshja e Aksionarëve”, e cila përcakton dhe rregullon kushtet e marrëdhënies ndërmjet ADAM GÓRAL FUNDACJA RODZINNA dhe Yukon Niebieski Kapital B.V. si aksionarë të shoqërisë ASSECO POLAND S.A.

ASSECO POLAND S.A. merr vendime nëpërmjet dy organe kryesore vendimmarrëse: i) Bordi

² [_____]

³ Konfidenciale

Mbikëqyrës dhe ii) Bordi Drejtues.

[_____].

Referuar Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” pika 52 përcaktohet se zotërimi i një pakice të aksioneve mund të çojë në kontroll de facto kur aksionari që zotëron pakicën e aksioneve mund të arrijë shumicën në asamblëtë e aksionarëve, duke patur parasysht nivelin e aksioneve të tij dhe pjesëmarrjen e aksionarëve në mbledhjet e mëparshme të asamblesë. Kjo vlen edhe në rastet kur dy ose më shumë ndërmarrje fitojnë aksione të aksionarëve që zotërojnë pakicën e aksioneve dhe veprojnë së bashku në ushtrimin e të drejtave të tyre të votës, në mënyrë të tillë që aksionet e tyre të kombinuara të arrijnë në një shumicë de facto të të drejtave të votës në asamblëtë e aksionarëve (siç parashikohet në Udhëzim, pika 66).

Si rrjedhojë, aplikuesit presin të kenë një shumicë të qëndrueshme votash në asamblëtë e ardhshme të përgjithshme të ASSECO POLAND S. A. dhe për këtë arsye do të marrin kontroll të përbashkët de facto mbi shoqërinë e blerë. Pas finalizimit të transaksionit të propozuar, përqindja e kapitalit aksionar të ASSECO në pronësi të Yukon Niebieski Kapital B.V. dhe AG së bashku do të arrijë në afërsisht XX%.

Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë ASSECO POLAND S.A. nga shoqëritë Yukon Niebieski Kapital B.V. dhe ADAM GÓRAL FUNDACJA RODZINNA, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

3. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i ofrimit të produkteve softuerike dhe shërbimeve të IT-së, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë ASSECO POLAND S.A. nga shoqëritë Yukon Niebieski Kapital B.V. dhe ADAM GÓRAL FUNDACJA RODZINNA.

YUKON NIEBIESKI KAPITAL B.V. është një shoqëri e themeluar për qëllime të këtij transaksioni duke mos patur një aktivitet biznesi të vetin. Yukon zotërohet 100% nga TSS EUROPE B.V., pjesë e Grupit CSI. Yukon dhe CSI nuk kanë prezencë ligjore në Shqipëri [_____].

ADAM GÓRAL FUNDACJA RODZINNA është një fondacion familjar i regjistruar sipas ligjeve të Polonisë, i cili menaxhon investimet në emër të z. Adam Góral. AG nuk është prezente dhe nuk

ka realizuar xhiro në Shqipëri.

ASSECO është shoqëria aksionare e grupit të shoqërive Asseco (Grupi Asseco), i cili operon në sektorët e softuerëve dhe IT-së.

ASSECO është prezente dhe realizon xhiro në Shqipëri indirekt nëpërmjet ASEE Albania SHPK, HELIUS SYSTEMS SHPK dhe CLEVER SOLUTION SHPK, por shoqëritë zotërojnë së bashku një pjesë shumë të vogël tregu. Transaksioni do të ndodhë në tregun e Polonisë ku pas realizimit të transaksionit, YUKON dhe AG do të kontrollojnë bashkërisht Shoqërinë Target.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshime në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar, për përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë ASSECO POLAND S.A. nga shoqëritë Yukon Niebieski Kapital B.V. dhe ADAM GÓRAL FUNDACJA RODZINNA.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1198, Datë 25. 07. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR, PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT, INDIREKT, TË SHOQËRISË RETAIL PARK SHKODRA SHPK NGA SHOQËRITË CEE – BIG B.V. DHE BALFIN - BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25. 07. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar, për përfitim të kontrollit të përbashkët, indirekt, të shoqërisë Retail Park Shkodra SHPK nga shoqëritë CEE – BIG B.V. dhe Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimit ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi përqendrimin e propozuar, për përfitim të kontrollit të përbashkët, indirekt, të shoqërisë Retail Park Shkodra SHPK nga shoqëritë CEE – BIG B.V. dhe Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar mbi transaksionin e propozuar të përfitimit të kontrollit të përbashkët, indirekt, të shoqërisë Retail Park Shkodra SHPK nga shoqëritë CEE – BIG B.V. dhe Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK.

Nga vlerësimi i dokumentacionit të dosjes, u konstatua se ndërmjet palëve janë nënshkruar disa marrëveshje, të cilat janë vlerësuar si transaksione të ndërlidhura, me qëllimin final përfitim të

kontrollit mbi shoqërinë Retail Park Shkodra SHPK.

Faza I

I. Përftimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë BIG Pénzügyi Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëritë CEE – BIG B.V dhe Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për shitjen dhe blerjen e aksioneve”, palët në marrëveshje janë:

Pala Blerëse 1: CEE – BIG B.V. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Holandës. Objektivat e shoqërisë janë: investimi në dhe zhvillimi i qendrave tregtare, duke përfshirë pa kufizim qendrat tregtare, qendrat tregtare të hapura, të vendosura në Republikën e Serbisë, Malit të Zi dhe Kroacisë, si dhe çdo vend tjetër që shoqëria e konsideron të përshtatshëm; të themelojë, të marrë pjesë, të bashkëpunojë, të financojë, të menaxhojë, administrojë, të këshillojë shoqëri të tjera dhe tu ofrojë shërbime ndërmarrjeve të tjera; të investojë kapital në të arkëtueshme (hipotekore), pasuri të paluajtshme, valutë, tituj dhe asete në përgjithësi etj.

CEE – BIG B.V. përfaqëson degën evropiane të grupit izraelit BIG Shopping Centers Ltd.

Pala Blerëse 2: Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK (Balfin) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: (i) investimi në instrument financiar (të cilët përfshijnë pa kufizime titujt e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërive tregtare, titujt e borxhit, aksionet ose kuotat në fonde investimesh etj), investimin në pasuri të paluajtshme dhe në asete (të prekshme apo të paprekshme), si dhe (ii) ofrimi i shërbimeve të konsulencës për shoqëritë e kontrolluara prej saj dhe/ose nga të tretë (të cilët përfshijnë pa kufizime konsulencën e natyrës financiare, manaxheriale, ligjore, IT, zhvillim softuare etj), në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, etj.

Balfin operon në një numër të madh industrish si në Sektorin Bankar, në Zhvillimin e Pasurive të Paluajtshme, në Administrim Qendrash Tregtare, në Industrinë Retail, Logjistike Transport, etj brenda dhe jashtë vendit.

Pala shitëse: BIG Shopping Centers Ltd është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Izraelit, veprimtaria e së cilës shtrihet në Izrael, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Serbi, Mali i Zi dhe Francë. Grupi BIG Shopping Centers Ltd përfshin gjithë zinxhirin e zhvillimit të pasurive të paluajtshme, nga identifikimi i tokave, financimi, projektimi, ndërtimi, dhënia me qira dhe menaxhimi i aseteve. Grupi është veçanërisht i njohur për zhvillimin e destinacioneve moderne të retail-it me karakter komunitar, që ofrojnë një përzierje të qartë të blerjes, argëtimit dhe shërbimeve në ambiente të hapura dhe funksionale.

Shoqëria Target: BIG Pénzügyi Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Hungarisë, me objekt aktiviteti kryesor menaxhimin e aseteve dhe aktivitete të tjera si: dhënia me qira dhe operimi i pronave të veta dhe

të marra me qira, ndërmjetësimi i pasurive të paluajtshme dhe menaxhimi i pronave, administrimi i pronës, aktivitete të tjera të konsulencës së biznesit etj.

BIG Pénzügyi Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság, para transaksionit zotërohej plotësisht nga BIG Shopping Centers Ltd.

II. Transaksioni

Më datë [_____], shoqëritë CEE – BIG B.V. dhe Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK (në cilësinë e blerësit 1 dhe blerësit 2) dhe shoqëria BIG Shopping Centers Ltd. (në cilësinë e shitësit), kanë nënshkruar “Marrëveshje për shitjen dhe blerjen e aksioneve”.

Referuar kësaj marrëveshje, shitësi zotëron plotësisht shoqërinë BIG Pénzügyi Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság dhe do të shesë të gjitha aksionet e tij, të cilat do t’u transferohen blerësve në Finalizim. Palët bien dakord që shitja dhe blerja e aksionit të transferuar i nënshtrohet miratimit nga Autoriteti Lokal Anti – Monopol i blerësit 2.

Referuar deklaratës të palës njoftuese, shoqëria target BIG Pénzügyi Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság do të ristrukturohet, rikonfigurohet dhe do të veprojë nën emrin tregtar CEE – BIG – Balfin Holding Development Limited Liability Company (BIG – Balfin Holding Development Ltd). Pas transformimit, kjo shoqëri do të veprojë si struktura mbajtëse e përbashkët për projektet investuese të ardhshme që synohen në Shqipëri në sektorin e zhvillimit të parqeve tregtare (retail parks).

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi me marrjen e Miratimit Anti-Monopol. Palët bien dakord që nëse brenda 3 muajve nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje nuk merret miratimi Anti-Monopol, kjo marrëveshje do të konsiderohet e pavlefshme në përputhje me Kodin Civil hungarez pa asnjë veprim dhe/ose ndërhyrje të mëtejshme dhe asnjë nga palët nuk do të ketë pretendime ndaj njëra – tjetrës.

Në përfundim të Fazës së I të këtij transaksioni të propozuar, shoqëria BIG Pénzügyi Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság (CEE – BIG – Balfin Holding Development Limited Liability Company), do të zotërohet XX% nga Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK dhe XX% nga CEE – BIG B.V.

Faza II

Përftimi i kontrollit të shoqërisë Retail Park Shkodra SHPK nga shoqëria CEE – BIG – BALFIN Holding Development Ltd.

Referuar dokumentit “Letër Angazhimi” dhe Aneksit A “Marrëveshje për shitje dhe blerje aksionesh” bashkëlidhur kontratës, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: CEE – BIG – BALFIN Holding Development Ltd. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë, me objekt aktiviteti menaxhimit të aseteve, dhënia me qira dhe operimi i pronave të veta dhe të marra me qira,

ndërmjetësimi i pasurive të paluajtshme dhe menaxhimi i pronave, administrimi i pronës etj.

CEE – BIG – BALFIN Holding Development Ltd. do të zotërohet XX% nga CEE – BIG B.V. dhe XX% nga Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK.

Pala shitëse: Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK.

Shoqëria target: Retail Park Shkodra SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti tregtimin e artikujve të ndryshëm, import – eksport, shitja me shumicë e pakicë e pajisjeve elektrike, elektronike, lëndë të parë për industrinë, materiale ndërtimi; import – eksport, shitja me shumicë e pakicë e produkteve tekstile, veshje të të gjitha llojeve, shitja me shumicë e pakicë e të gjitha mallrave industriale e ushqimore; transport i mallrave dhe udhëtarëve brenda dhe jashtë vendit, menaxhimi i qendrave tregtare, bareve, restoranteve etj.

Shoqëria është themeluar për qëllimin specifik të zhvillimit, menaxhimit dhe operimit të një parku tregtar në qytetin e Shkodrës, si pjesë e një programi më të gjerë investimesh në infrastrukturën komerciale në Shqipëri. Aktualisht shoqëria nuk ka aktivitet, por është themeluar për zhvillimin dhe dhënien me qira të hapësirave për shitje me pakicë dhe shërbime komerciale në një format të konceptuar si retail park.

Përqendrimi

Më datë [____], shoqëritë Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK dhe CEE – BIG B.V. kanë nënshkruar “Letër Angazhimi”.

Referuar kësaj marrëveshje, palët pranojnë dhe bien dakord që “Marrëveshja për shitblerjen e kuotave” (SPA) të Retail Park Shkodra do të nënshkruhet nga Balfin dhe CEE – BIG – BALFIN Holding Development Ltd. menjëherë pas përmbushjes së kushteve të përcaktuara në marrëveshje.

Kjo letër përbën ligjërisht një angazhim të detyrueshëm për palët për të nënshkruar SPA Retail Park Shkodra në formën e bashkëlidhur kësaj kontrate si Aneksi A. SPA Retail Park Shkodra, njihet nga të dyja palët si një version i negociuar dhe do të konsiderohet përfundimtar, përveç nëse dakordohet ndryshe me shkrim.

Referuar Aneksit A “Marrëveshje për shitje dhe blerje kuotash”, shitësi, Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK, shet, transferon dhe dorëzon në favor të blerësit pronësinë e plotë të kuotës, e cila përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë Retail Park Shkodra SHPK.

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje dhe me pagesën e plotë dhe të pakushtëzuar të Çmimit të Blerjes, pronësia dhe zotërimi i kuotës së synuar kalojnë në mënyrë të pakthyeshme nga shitësi tek blerësi, duke u konsideruar të plotësuar të gjitha kërkesat ligjore dhe procedurale për transferimin e pronësisë.

Në përfundim të Fazës së II të këtij transaksioni të propozuar, Retail Park Shkodra SHPK do të zotërohet plotësisht nga CEE – BIG – BALFIN Holding Development Ltd. dhe indirekt nga CEE

– BIG B.V. dhe Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK.

Referuar Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, kapitulli 1.5 “Transaksionet e ndërlidhura” parashikon se disa transaksione mund të konsiderohen si një përqendrim i vetëm, nëse *kontrolli është përfshur së fundmi nga e njëjta/ të njëjtat ndërmarrje*. Vetëm në këto rrethana, dy ose më shumë transaksione mund të konsiderohen si unike në natyrë dhe si rrjedhim të përbëjnë një përqendrim të vetëm. Pika 37 e Udhëzimit parashikon se tregues të mëtejshëm mbi *ndërvarësinë e disa transaksioneve mund të jenë deklaratat e vetë palëve ose përmbylljet e menjëhershme të marrëveshjeve përkatëse*. Parimi se disa transaksione mund të trajtohen si një përqendrim i vetëm zbatohet vetëm nëse rezultati, është që *kontrolli i një ose më shumë ndërmarrjeve përfshohet nga i njëjti person ose ndërmarrje*.

Referuar deklaratës së palës njoftuese, përfshimi i përbashkët i kontrollit nga shoqëritë CEE – BIG B.V. & Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK, mbi shoqërinë BIG Pénzügyi Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság (CEE – BIG – BALFIN Holding Development Ltd.) dhe përfshimi i kontrollit nga kjo e fundit mbi shoqërinë Retail Park Shkodra SHPK, janë hapa të ndërlidhur funksionalisht dhe ekonomikisht dhe përbëjnë fazat fillestare të një transaksioni me një perspektivë qëndrueshmërie afatgjatë.

SPV Shkodra përfaqëson projektin e parë konkret dhe palët parashikojnë të realizojnë një sërë investimesh të tjera të ngjashme, nëpërmjet krijimit ose blerjes së shoqërive vendase të dedikuara për secilin projekt, të cilat do të jenë në pronësi të përbashkët të Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK dhe CEE – BIG B.V.

Përfshimi i përbashkët i kontrollit mbi shoqërinë BIG Pénzügyi Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság (CEE – BIG – BALFIN Holding Development Ltd.) dhe përfshimi i kontrollit nga kjo e fundit mbi shoqërinë Retail Park Shkodra SHPK nuk do të hyjnë në fuqi dhe nuk do të zbatohen përpara marrjes së autorizimit paraparak nga Autoriteti i Konkurrencës.

Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfshimin e kontrollit të përbashkët, indirekt, të shoqërisë Retail Park Shkodra SHPK nga shoqëritë CEE – BIG B.V. dhe Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK, nëpërmjet BIG Pénzügyi Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság (CEE – BIG – BALFIN Holding Development Ltd.), transaksion i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i ndërtimit dhe menaxhimit të pasurive të paluajtshme për përdorim komercial në zhvillimin e projekteve të parqeve tregtare dhe krijimi i infrastrukturës për ofrimin e hapësirave me qira për aktivitete të shitjes me pakicë.

Tregu përkatës gjeografik: Për analizimin e këtij rasti, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet rrethi i Shkodrës.

Transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të përbashkët, indirekt, të shoqërisë Retail Park Shkodra SHPK nga shoqëritë CEE – BIG B.V. dhe Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK.

Ky përqendrim lidhet me zhvillimin e një platforme të përbashkët për investime në sektorin e pasurive të paluajtshme komerciale, konkretisht në konceptin e “retail parks”, të cilët përbëjnë një format të ri në tregun shqiptar të pasurive të paluajtshme për shitje me pakicë. Retail Park do të jetë një segment i ri në tregun e pasurive të paluajtshme komerciale në Shqipëri, ende i pazhvilluar dhe që plotëson nevoja të reja të ndryshme nga format ekzistuese.

Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK është një grup i diversifikuar investimesh, i angazhuar kryesisht në shitjen me pakicë, pasuritë e paluajtshme, veprimtarinë minerare dhe shërbimet bankare. Për Balfin transaksioni i propozuar përbën një zgjerim të natyrshëm dhe të synuar të portofolit të tij të investimeve në infrastrukturën komerciale për retail, duke vënë në funksion përvojën e tij të gjatë në ndërtimin dhe menaxhimin e pasurive të paluajtshme në tregun shqiptar.

CEE – BIG B.V. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe përfaqëson degën evropiane të grupit izraelit BIG Shopping Centers Ltd. Për CEE – BIG B.V., bashkëpunimi me Balfin përbën një mundësi të strukturuar për hyrje në tregun shqiptar, nëpërmjet një partneri vendas me pozicion të konsoliduar. Investimi lejon CEE – BIG B.V. të vendoset në një treg me zhvillim të shpejtë, me potencial për rritje në segmentin e retail parks.

BIG Shopping Centers Ltd. ka ndërtuar një strukturë të integruar, që përfshin gjithë zinxhirin e zhvillimit të pasurive të paluajtshme duke filluar nga identifikimi i tokave, financimi, projektimi, ndërtimi, dhënia me qira dhe menaxhimi i aseteve.

BIG Shopping Centers Ltd. dhe CEE – BIG B.V. nuk kanë pasur aktivitet në Shqipëri, por futen nëpërmjet sipërmarrjes së përbashkët me Grupin Balfin, duke mos krijuar një mbivendosje horizontale të aktivitetit të palëve në transaksion.

Nga aspekti vertikal, Balfin do të angazhohet në zhvillimin dhe ndërtimin e projekteve të retail park-ut dhe gjithashtu në administrimin e disa prej aseteve fillestare, ndërsa BIG pritet të fokusohet kryesisht në menaxhimin dhe operimin e tyre pas ndërtimit sipas praktikës dhe ekspertizës së saj ndërkombëtare, pa patur marrëdhënie si furnitor-klient.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i propozuar nuk do të sjellë ndryshime në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar, për përftimin e kontrollit të përbashkët, indirekt, të shoqërisë Retail Park Shkodra SHPK nga shoqëritë CEE – BIG B.V. dhe Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1199, Datë 25. 07. 2025

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR, NËPËRMJET
PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË TOPCON
CORPORATION NGA SHOQËRIA TK CO., LTD. DHE INDIREKT NGA KKR”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25. 07. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar, nëpërmjet përfhtimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë TOPCON CORPORATION nga shoqëria TK Co., Ltd. dhe indirekt nga KKR.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimit ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi përfhtimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë TOPCON CORPORATION nga shoqëria TK Co., Ltd. dhe indirekt nga KKR,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në transaksion janë:

Ofertuesi/Blerësi: - TK Co., Ltd, është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Japonisë, me objekt aktiviteti: Tregti dhe të gjitha aktivitetet e tjera që janë të ndërlidhura ose plotësuese me tregtimin. Gjithashtu biznesi kryesor i kësaj shoqërie është blerja dhe zotërimi i Letrave me Vlerë të shoqërisë nëpërmjet Ofertës së Tenderit, si dhe kontrolli dhe menaxhimi i aktiviteteve të biznesit të shoqërisë pas përfundimit të Ofertës së Tenderit.

Aksionet e emetuara të kësaj shoqërie zotërohen nga TK Holdings Co., Ltd., e cila është një

shoqëri aksionare e regjistruar sipas legjislacionit Japonez dhe që kontrollohet nga TK Investment LP (Fondi KKR).

Ofertuesi TK Co., Ltd është një shoqëri e krijuar për qëllim të veçantë të transaksionit (SPV), që zotërohet indirekt nga fondet e investimit, strukturat dhe/ose llogaritë e këshilluara dhe të administruara nga filiale të ndryshme të KKR & Co. Inc.

KKR është një firmë globale investimesh që ofron menaxhim të aseteve alternative, si dhe zgjidhje për tregjet e kapitaleve dhe sigurimet. KKR nuk ka filiale në Shqipëri, por realizon të ardhura nëpërmjet shitjeve të realizuara nga shoqëritë me portofol të kontrolluar dhe të menaxhuara nga filiale të ndryshme të KKR & Co.

Shoqëria Target: TOPCON CORPORATION është një shoqëri e regjistruar sipas ligjeve të Japonisë, e cila bashkë me filialet përbëjnë Grupin Topcon. Topcon është një zhvillues, prodhues dhe furnizues i pajisjeve dhe software-it në dy linja kryesore biznesi: sisteme pozicionimi për klientët e infrastrukturës dhe agrikulturës dhe pajisje të kujdesit për sytë, në fushën e mjekësisë.

Në Shqipëri, TOPCON CORPORATION nuk ka prezencë juridike, por është aktiv në fushat e tij të biznesit të kujdesit për sytë dhe infrastrukturën.

II. Transaksioni

Më datë [____], palët TOPCON CORPORATION (target), TK Co., Ltd. (Ofertuesi), TK Holdings Co., Ltd. (shoqëria mëmë ofertuese), TK Investment LP (Fondi KKR), kanë hyrë në marrëveshje me një sërë transaksionesh për privatizimin e aksioneve të kompanisë TOPCON CORPORATION, që do të kryhet nëpërmjet një oferte tenderimi.

Palët kanë përcaktuar si fillim të Ofertës së tenderit, fundin e korrikut 2025 (e planifikuar).

Sipas deklaratimit të palës njoftuese, ky njoftim i referohet blerjes së propozuar deri më 100% të aksioneve dhe të drejtave të votës në shoqërinë TOPCON CORPORATION (së bashku me filialet e saj) dhe të një procesi të mëvonshëm [____], nëpërmjet të cilit TK Co., Ltd., do të përvetësojë të gjitha aksionet e mbetura që nuk janë përvetësuar në ofertën publike për blerje.

Para përfundimit të transaksionit (mbylljes), pritet që fondet e investimit të këshilluara dhe të administruara nga JIC Capital, Ltd., një shoqëri japoneze e zotëruar plotësisht nga Japan Investment Corporation, të blejnë afërsisht XX% të aksioneve dhe të drejtave të votimit në shoqërinë mëmë të drejtpërdrejtë të blerësit, TK Holdings Co., Ltd. Si rrjedhojë, fondet, strukturat dhe/ose llogaritë e këshilluara dhe të administruara nga KKR do të zotërojnë në mënyrë indirekte rreth XX% të kapitalit në shoqërinë Japan HoldCo.

Referuar dokumentit “Njoftim lidhur me Opinionin Mbështetës dhe Opinionin e Rekomandimit të Tenderit për Fillimin e Planifikuar të Ofertës së Tenderit për Certifikatat e Aksioneve të Kompanisë” nga TK Co., Ltd si pjesë e zbatimit të MBO-së (Blerja e menaxhimit) dhe pjesëmarrjes në kapital nga KKR Japan dhe JIC Capital, Ltd.”, datë [____], në varësi të të gjitha

kushteve precedente, ofertuesi i tenderit ka vendosur në datën e këtij njoftimi që të zbatojë ofertën e tenderit në të cilën ofertuesi i tenderit bëhet aksionar i vetëm i shoqërisë, si pjesë e një serie transaksionesh që synojnë heqjen nga bursa të Aksioneve të shoqërisë të listuara në tregun kryesor të bursës.

Në lidhje me ofertën e tenderit, Fondi KKR ka hyrë në një Marrëveshje me z. Takashi Eto, President dhe drejtor i shoqërisë që nga data [____], në lidhje me kushtet kryesore të marrëveshjes dhe Fondi KKR ka konfirmuar se z. Eto synon të ofrojë të gjitha aksionet e shoqërisë së tij në ofertën e tenderit. dhe ka arritur një marrëveshje me z. Eto, që ky i fundit do të nënshkruajë për aksione të shoqërisë mëmë ofertuese TK Holdings Co., Ltd. dhe do të riinvestojë një pjesë të shumës së marrë për pjesëmarrjen në Ofertën e Tenderit të shoqërisë TK Holdings Co., Ltd.(riinvestimi).

Më datë [____], Bordi Drejtues i shoqërisë TOPCON CORPORATION ka shprehur mbështetjen e tij për transaksionin dhe rekomandoi që aksionarët të dorëzojnë aksionet e tyre në ofertë. Pas përmbylljes, TOPCON CORPORATION do të bëhet një filial në pronësi të plotë të Blerësit, i cili vetë është në pronësi të plotë të Japan HoldCo.

Pas përfundimit të transaksionit, KKR do të fitojë kontroll të vetëm indirekt mbi TOPCON CORPORATION.

Përmbyllja e transaksionit pritet të ndodhë në tremujorin e katërt të vitit 2025, me kusht marrjen e të gjitha miratimeve të enteve rregullatore dhe të jenë përmbushur të gjitha kushtet e tjera për përmbyllje.

Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë TOPCON CORPORATION nga shoqëria TK Co., Ltd. dhe indirekt nga KKR, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenit 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet: i) tregu i furnizimit me pajisje oftalmike dhe ii) tregu i furnizimit me pajisje ndërtimi dhe kontroll makinerish, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur.

Tregu përkatës gjeografik: Për analizimin e këtij rasti, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Pala blerëse, TK Co.Ltd, është një shoqëri pa aktivitet të mëparshëm biznesi dhe e krijuar për qëllime të këtij transaksioni. TK Co.Ltd zotërohet tërësisht, në mënyra indirekte, nga fondet e investimeve, mjetet dhe/ose drejtuar dhe menaxhuar nga filiale të ndryshme të KKR & Co. Inc.

KKR & Co, Inc. është një shoqëri investimesh globale që merret me administrimin e aseteve alternative në tregun e kapitaleve dhe sigurimeve, e cila nuk ka filiale në Shqipëri, por realizon të ardhura nëpërmjet shitjeve të realizuara nga shoqëritë me portofol të kontrolluar dhe të menaxhuara nga filiale të ndryshme të KKR & Co.

Shoqëria target, TOPCON CORPORATION, bashkë me filialet përbëjnë Grupin Topcon, i cili është një zhvillues, prodhues dhe furnizues i pajisjeve dhe software-it në dy linja kryesore biznesi: sisteme pozicionimi për klientët e infrastrukturës dhe agrikulturës dhe pajisje të kujdesit për sytë, në fushën e mjekësisë.

Shoqëria Topcon ofron matëse dhe zgjidhje IT të fokusuara në përmirësimin e produktivitetit bujqësor, në fushën e infrastrukturës për sistemet e lëvizjes së tokave, zgjedhjet për asfaltimin, asfaltimin e betonit, ndërtimin e ndërtesave dhe mjetet për matje, si dhe në fushën e shëndetësisë duke ofruar pajisje oftalmike, që përfshijnë pajisje për ekzaminim dhe kontrollin e hershëm të syve, trajtimin e sëmundjeve të syve, etj.

Në Shqipëri Topcon ka realizuar të ardhura të ulëta nga shitja e pajisjeve të ndërtimit dhe kontrollit të makinerive dhe në shitjen e pajisjeve oftalmike.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës vlerëson se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar, nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë TOPCON CORPORATION nga shoqëria TK Co., Ltd. dhe indirekt nga KKR.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1200, Datë 25. 07. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË SPAR ALBANIA SHPK NGA SHOQËRIA VIVA FRESH SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25. 07. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Spar Albania SHPK nga shoqëria Viva Fresh SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar mbi përfitimin e kontrollit të shoqërisë Spar Albania SHPK nga shoqëria Viva Fresh SHPK,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi në lidhje me transaksionin e përfitimit të kontrollit të shoqërisë Spar Albania SHPK nga shoqëria Viva Fresh SHPK.

Shoqëritë Viva Fresh SHPK (blerësi), shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK (shitësi) dhe shoqëria Spar Albania SHPK (target) nënshtruan “Kontratë shitblerje kuote”, më datë datë 21 mars 2025. Referuar objektit të kësaj Marrëveshje, shitësi do të shiste 100% kuotën e shoqërisë target Spar Albania SHPK (së bashku me të gjitha të drejtat dhe interesat që u lidhën me të në datën e finalizimit të transaksionit) tek blerësi dhe blerësi do të blinte 100% kuotën e shoqërisë target nga shitësi, të pastër dhe të lirë nga çdo barrë, kundrejt pagesës së çmimit.

Marrëveshja përcaktonte detyrimin për të marrë miratimet e nevojshme për finalizimin e transaksionit.

Bazuar në nenin 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, me vendimin nr. 1177, datë 24.04.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të përkohshëm të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Spar Albania SHPK nga shoqëria Viva Fresh SHPK”, vendosi:

1. Të autorizojë përkohësisht përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Spar Albania SHPK nga shoqëria Viva Fresh SHPK.
2. Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm do të jetë i vlefshëm deri në momentin e finalizimit përfundimtar të transaksionit.
3. Pala njoftuese ka detyrimin të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës, njoftimin nga palët pjesëmarrëse në transaksion mbi finalizimin përfundimtar të këtij transaksioni, pas të cilës Sekretariati do të fillojë procedurën e kontrollit të përqendrimeve bazuar në nenet 53-64 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Studio ligjore Boga & Associates, me shkresën nr. 371/12 prot. i AK, datë 13.05.2025, “Kërkesë për autorizim përqendrimi”, ka dorëzuar miratimin zyrtar të dhënë nga Spar International B.V. për miratimin e transferimit të kuotës së Spar Albania SHPK nga Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK tek Viva Fresh SHPK.

Me shkresën nr. 371/14, datë 21.07.2025 “Kërkesë për autorizim përqendrimi”, jemi njoftuar nga studio ligjore Boga & Associates, se të gjitha kushtet për përmbylljen e “Kontratë shitblerje kuote”, të nënshkruar më datë 21 mars 2025, janë plotësuar dhe transaksioni është finalizuar në datë 18.07.2025.

Me shkresën nr. 675, datë 22.07.2025 “Kërkesë për autorizim përqendrimi” (Viva Fresh / Spar Albania), jemi njoftuar nga studio ligjore Boga & Associates për nënshkrimin e dokumentit “Akti i Transferimit të Kuotës”.

Referuar këtij dokumenti “Akti i Transferimit të Kuotës”, të nënshkruar në datë 17.07.2025, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: Viva Fresh SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Kosovës. Viva Fresh SHPK, është pjesë e rrjetit të supermarketeve që operon në Kosovë dhe rajon, e cila zotërohet plotësisht nga ortakut i vetëm z Xhevdet Rexhepi.

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj si aktivitet kryesor; Tregtinë me pakicë në dyqane jo të specializuara, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani. Aktivitet sekondar: Tregtinë me pakicë të frutave dhe perimeve në dyqane të specializuara. Aktivitete të tjera: Tregtia me pakicë e mishit dhe produkteve të mishit në dyqane të specializuara.

Pala shitëse: Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK është një shoqëri me

përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: (i) investimi në instrument financiar (të cilët përfshijnë pa kufizime titujt e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërive tregtare, titujt e borxhit, aksionet ose kuotat në fonde investimesh etj), investimin në pasuri të paluajtshme dhe në asete (të prekshme apo të paprekshme), si dhe (ii) ofrimi i shërbimeve të konsulencës për shoqëritë e kontrolluara prej saj dhe/ose nga të tretë etj.

Aksionar i kësaj shoqërie është Z. Samir Mane me 100% të kuotave.

Shoqëria Target: Spar Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar. Kuota e shoqërisë target përbëhet nga (një) kuotë, e cila përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të SPAR Albania SHPK.

Spar Albania SHPK zotëron një rrjet supermarketesh në Shqipëri, që operon në markën ndërkombëtare Spar, e cila zotërohet plotësisht nga ortaku i vetëm i saj Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK.

Shoqëria ka për objekt parësor veprimtarie kryerjen e aktiviteteve të listuara më poshtë: ngritjen, hapjen dhe administrimin e marketeve, supermarketeve dhe hipermarketeve “Spar” në Shqipëri dhe jashtë saj; import-eksport dhe /ose kultivim, prodhim, përpunim i produkteve ushqimore; import-eksport dhe /ose prodhim i produkteve jo-ushqimore; shitja me shumicë dhe/ose pakicë e produkteve ushqimore – të përpunuara ose të papërpunuara dhe jo-ushqimore; stokimi dhe ruajtja e produkteve ushqimore të përpunuara ose të papërpunuara dhe jo-ushqimore etj.

II. Përqendrimi

Më datë 17 korrik 2025, shoqëritë Viva Fresh SHPK (në cilësinë e Blerësit) dhe Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK (në cilësinë e shitësit) kanë nënshkruar “Akti i Transferimit të Kuotës”.

Referuar kësaj kontrate, blerësi në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate ka depozituar në llogarinë e shitësit Çmimin e plotë të shitjes. Në çdo rast pagesa e plotë e çmimit të shitjes nga blerësi është kusht thelbësor për përfundimin e pronësisë së kuotës nga blerësi sipas objektit të kësaj marrëveshje.

Pas transferimit të mësipërm të kuotës, veprim i cili për të shmangur çdo dyshim do të jetë i vlefshëm dhe regjistrohët në zyrën e Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), shitësi nuk gëzon më asnjë të drejtë ose titull mbi kuotën e mësipërme dhe blerësi, të cilit i janë transferuar dhe dorëzuar kuota, do të gëzojë të drejtën të zotërojë, posedojë, përdorë, shfrytëzojë dhe disponojë ato me vullnetin e tij të lirë si pronar dhe posedues i tyre.

Transaksioni i njoftuar konsiston në përfundimin e kontrollit të shoqërisë Spar Albania SHPK nga shoqëria Viva Fresh SHPK, transaksion, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shitjes me pakicë të produkteve ushqimore dhe produkteve jo ushqimore. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i njoftuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë Spar Albania SHPK nga shoqëria Viva Fresh SHPK.

Viva Fresh SHPK është aktive në shitjen me pakicë të produkteve ushqimore dhe jo ushqimore në tregun e Kosovës.

Në Shqipëri, Viva Fresh është prezent nëpërmjet filialit të saj “VIVA FRESH” SHPK dhe ka realizuar të ardhura vetëm nëpërmjet qiradhënies së hapësirave të saj për ambiente zyrash dhe magazina.

Spar Albania SHPK është një shoqëri shqiptare e cila operon përmes rrjetit të saj të marketeve, supermarketeve dhe hipermarketeve nën markën ndërkombëtare “SPAR”.

Në Shqipëri, Viva Fresh dhe SPAR nuk operojnë në të njëjtin treg përkatës.

Transaksioni nuk do të sjellë ndryshime të strukturës së tregut në Shqipëri pasi Viva Fresh është aktive vetëm në Kosovë në tregun e shitjes me pakicë të produkteve ushqimore dhe jo ushqimore, ndërsa SPAR është aktiv vetëm në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i njoftuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Spar Albania SHPK nga shoqëria Viva Fresh SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1201, Datë 25. 07. 2025

“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR. 1156, DATË 29.01.2025 “PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPAK NDAJ NDËRMARRJEVE VODAFONE ALBANIA SHA DHE ONE ALBANIA SHA NË TREGUN ME PAKICË TË SHËRBIMEVE CELULARE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25. 07. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1156, datë 29.01.2025 “Për hapjen e procedurës së hetimit parapak ndaj ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”.

Baza Ligjore: Neni 24, germa (d) dhe neni 26 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës:

VËREN SE :

1. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1156, datë 29.01.2025 “Për hapjen e procedurës së hetimit parapak ndaj ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA, në tregun me pakicë të shërbimeve celulare, për periudhën nga 1 janar 2022 deri më 31 dhjetor 2024.
2. Për realizimin e procedurave hetimore bazuar në nenin 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, janë kërkuar të dhëna dhe informacione nga AKEP dhe ndërmarrjet Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA.

3. Komisioni i Konkurrencës, vlerëson se me qëllim realizimin e një analize të plotë të sjelljes së ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun me pakicë të shërbimeve celulare, koha e mbetur në dispozicion e bën të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit brenda afatit në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1156, datë 29.01.2025.
4. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraparak me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në treg, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d) dhe nenin 26 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1156, datë 29.01.2025 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraparak ndaj ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”, pikat II dhe III, të ndryshohen si vijon:

II. “Hetimi paraparak të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2022 deri në 25.07.2025”.

III. “Raporti i hetimit paraparak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 29 Tetor 2025”.

- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1202, Datë 25. 07. 2025

**“MBI VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR. 1084, DATË 10.05.2024
“MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS NR. 921, DATË 09.11.2022 “PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË
HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E MENAXHIMIT TË FACILITETEVE TË
PARKIMIT TË AEROPORTIT “NËNË TEREZA” (TIRANA INTERNATIONAL
AIRPORT) DHE MIRATIMIN E ANGAZHIMEVE SI TË DETYRUESHME NË
FORMËN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE PËR NDËRMARRJEN STAR PARKING
ALBANIA SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25. 07. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbi Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1084, datë 10.05.2024 “Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 921, datë 09.11.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të aeroportit “Nënë Tereza” (Tirana International Airport) dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK” .

Bazë ligjore: Neni 24, germa (d) dhe neni 26, ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1084, datë 10.05.2024 “Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 921, datë 09.11.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të aeroportit “Nënë Tereza” (Tirana International Airport) dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK SHPK,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 921, datë 09.11.2022, Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Aeroportit “Nënë Tereza” dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen “Star Parking Albania” SHPK”, vendosi:

I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Aeroportit “Nënë Tereza” (Tirana International Airport).

II. Gjykitjen e ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK në masën 1% të xhiros të vitit paraardhës financiar, përkatësisht në shumën 1,614,899 (një milion e gjashtëqind e katërmëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) Lekë.

III. Miratimin e angazhimeve të depozituar nga ndërmarrja Star Parking Albania SHPK, si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve, si më poshtë vijon:

- a) Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK të hartojë një metodologji për llogaritjen e kostove për formimin e çmimit të telepasit;*
- b) Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK të aplikojë tarifa të orientuara drejt kostos, për ndërmarrjet që pajisen me telepas si dhe për çdo shërbim tjetër;*
- c) Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK nuk do të zbatojë kushte të pabarabarta me ndërmarrjet të cilat lidhin kontratë me Star Parking për tu pajisur me telepas, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence.*

IV. Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK ka detyrimin të mos abuzojë me pozitën dominuese veçanërisht:

- a) vendosjen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit;*
- b) kufizimin e prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik;*
- c) zbatimin e kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;*
- d) vendosjen e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.*

V. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja Star Parking Albania SHPK në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohet me penalitetin përkatës.

VI. Për përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në pikën III të këtij vendimi, ndërmarrja Star Parking Albania SHPK do të monitorohet për një periudhë 1 vjeçare.

2. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 1084, datë 10.05.2024 “Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 921, datë 09.11.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të aeroportit “Nënë Tereza” (Tirana International Airport) dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK SHPK”, vendosi:

I. Vijimin e monitorimit të zbatimit të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në pikën III të vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 921, datë 09.11.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Aeroportit “Nënë Tereza” dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen “Star Parking Albania SHPK”, edhe për një periudhë 1 vjeçare.

II. Gjykitjen e ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK, për moszbatimin e detyrimeve të sanksionuara në pikën III të VKK nr. 921/2022, në masën 756,581 Lekë (shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) Lekë.

3. AK në vijim të monitorimit, nëpërmjet shkresës nr.431/1 prot., datë 09.05.2025 dhe nr. 431/4 prot., datë 29.05.2025 ka kërkuar informacion ndaj ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK mbi zbatimin e pikës III të dispozitivit të vendimit të VKK nr. 921/2022.
4. Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK, nëpërmjet shkresës së saj nr. 431/3 prot, datë 22.05.2025 “Dërgim informacioni”, dhe nr. 431/5 prot, datë 05.06.2025 “Dërgim dokumentacioni”, ka depozituar informacionin mbi për periudhën 1 vjeçare të monitorimit.
5. Nga administrimi dhe përpunimi i informacionit për ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK, konstatohet si më poshtë vijon:

i. Lidhur me angazhimin e pikës III/a: Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK të hartojë një metodologji për llogaritjen e kostove për formimin e çmimit të telepasit.

6. Në datën 08.04.2025, në vijim të monitorimit të zbatimit të VKK nr. 1084, datë 10.05.2024, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ka realizuar një takim konsultativ me ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK ku është diskutuar dhe pyetur ndërmarrja mbi monitorimin e zbatimit të VKK nr. 921/2022 dhe nr. 1084/2024 si dhe nëse kanë një metodologji për koston,

mbështetur në faktin se në përfundim të monitorimit të fundit rezultonte një pikë e pa zbatuar nga ndërmarrja.

7. Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK, gjatë seancës dëgjimore u shpreh se ka dhe po zbaton gjerat b dhe c të pikës III të dispozitivit të VKK nr. 921/2022, por përse i përket gjerës a, të po kësaj pike, ndërmarrja ende nuk ka implementuar një metodologji kosto pasi po has vështirësi në krijimin e saj. Në këto kushte, Sekretariati i AK i ka kërkuar ndërmarrjes që këto pretendime t'i dërgojë me shkresë zyrtare pranë AK për vlerësim.
8. Me tej Star Parking Albania SHPK deklaron se, edhe pse mungon një metodologji e miratuar për përcaktimin e tarifave të shërbimit të parkimit, ajo vlerëson se çdo vlerësim mbi drejtësinë ose proporcionalitetin e këtyre tarifave duhet të trajtohet me kujdes të shtuar dhe në kontekst më të gjerë të funksionimit të tregut.
9. Në pikën 10 të VKK nr. 1084/2024 është shprehur se: Pasja e një metodologjie për llogaritjen e kostove për formimin e çmimit të telepasit apo dhe shërbimeve të tjera është esenciale për ndërmarrje që gëzojnë një ekskluzivitet, ashtu si ndërmarrja Star Parking Albania SHPK, e cila është subjekti i vetëm që menaxhon facilitetet e parkimit, shërbimet dhe pajisjet e karrocave në Aeroportin “Nënë Tereza” (TIA). Kjo metodologji e formimit të çmimit është edhe me e nevojshme në momentin kur kjo ndërmarrje operon me norma fitimi mbi 40%.
10. Si rrjedhojë, AK, nuk kërkon një metodologji të miratuar (nga institucionet rregullatore) të tarifave të shërbimeve të parkimit (siç shprehet Star Parking Albania SHPK se mungon), por se si përcaktohet nga ana e ndërmarrjes çmimi, duke u mbështetur në kostot që has biznesi, segmenti i telepasit në veçanti. Duke qenë se ky çmim përcaktohet në fillim të veprimtarisë, apo periudhës, ai nuk mund të jetë pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve që kryhet në fund të periudhës (siç dhe Star Parking Albania SHPK ka sjellë më parë pranë AK për të justifikuar metodologjinë e kostos).
11. Në një metodologji kostoje për të caktuar çmimin, tregohen qartë kostot fikse dhe ato variabël për njësinë e veprimtarisë, (në këtë rast, postet me telepas) si dhe norma e fitimit (në përqindje dhe/apo vlerë kur kjo njihet) e cila është e mirëpërcaktuar që në fazën e caktimit të çmimit të orientuar në kosto. Kjo normë fitimi nuk mund të ndryshojë nga viti në vit kur çmimi qendron i njëjtë, siç ndodh me metodologjinë e sjellë nga ndërmarrja gjatë fazës së monitorimit për vitet 2022-2024.
12. Me shkresën nr. 431/6 prot., datë 22.07.2025, ndërmarrja Star Parking Albania SHPK ka dorëzuar një dokument i cili për vitin 2022, 2023 dhe 2024 përmban:
 - Koston Kapitale për Njësi (*dhe formulën përkatëse*)

- Amortizimin Vjetor të Investimit *(dhe formulën përkatëse)*
- Koston Operative Vjetore për Njësi *(dhe formulën përkatëse)*
- Koston Totale Vjetore për Njësi *(dhe formulën përkatëse)*
- Normën e Interesit *(dhe formulën përkatëse)*
- Shndërrimi në Njësi më të Vogla (ditë/muaj)
- Llogaritjen e Kostos për vitet e mësipërme
- Tabelat e llogaritjeve të mësipërme për 2022, 2023 dhe 2024 (Kosto e Investimit, Amortizimi Vjetor, Kosto Operative për njësi), si dhe tabelën përmbledhëse për secilin vit.

13. Nga dokumenti i mësipërm rezulton se kosto ditore për një vend parkimi është 343 lekë në vitin 2022, 498 lekë për vitin 2023 dhe 374 lekë për vitin 2024.

14. Sa më sipër, lidhur me zbatimin e pikës III/a të VKK nr. 921/2022, rezulton se ndërmarrja Star Parking Albania SHPK ka hartuar një metodologji për llogaritjen e kostove për formimin e çmimit të telepas-it apo të posteve të parkimit.

15. *Lidhur me angazhimin e pikës III/b: Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK të aplikojë tarifa të orientuara drejt kostos, për ndërmarrjet që pajisen me telepas si dhe për çdo shërbim tjetër.*

16. Star Parking Albania SHPK vë në dukje se edhe se është operatori më i madh dhe tërësisht i automatizuar, nuk është ndërmarrja e vetme që operon në atë zonë ku janë dhe 2-3 [parkime] të tjera jashtë administrimit të Star Parking. Gjithashtu, ndërmarrja, vë në dukje se çdo transaksion i saj deklarohet në organet tatimore nëpërmjet sistemit DevPOS, ndërsa ndërmarrjet e tjera edhe se aplikojnë çmime të njejta me të, operojnë në mënyrë informale.

17. Star Parking Albania SHPK shpjegon se, subjektet që operojnë në ambientet e parkimit që ajo administron ndahen në tre kategori:⁴

- Subjektet që japin makina me qera – operojnë me leje të posaçme dhe kanë nga 2 deri në 10 poste parkimi me tarifë fikse mujore prej 36 000 lekë për post. Pagesat realizohen me bankë.
- Subjekte të transportit urban/interurban – kjo kategori ka vendin e vet, të konturuar dhe me vende të dedikuara. Pagesë fikse mujore prej 36 000 lekë për post dhe pagesat realizohen me bankë.
- Subjekte që ushtrojnë aktivitetet tregtar në TIA dhe paguajnë abone – me mjete 6 apo 7+1 vende për subjektet që operojnë kryesisht në turizmin dentar, estetik apo që presin e

⁴ Informacioni i cili është i verifikuar edhe nga shkresa e depozituar nga vetë ndërmarrja Star Parking Albania SHPK nëpërmjet shkresës nr. 431/5 prot., datë 05.06.2025 “Tabela e pagesave të faturave, tabelat përmbledhëse të kontratave, tabelat e të ardhurave nga faturat për parkim (ku evidentohet subjekti, nr i vendeve dhe pagesa)

përcjellin klientët e tyre. Aboneja kushton 15 000 lekë në muaj, ndërkohë që mjetet mund të hyjnë e dalin disa herë në ditë nga parkingu.

18. Komisioni i Konkurrencës në pikën 12 të Vendimit nr. 1084, datë 10.05.2024 “Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 921, datë 09.11.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të aeroportit “Nënë Tereza” (Tirana International Airport) dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK SHPK”, ka shprehur se: Pavarësisht se ndërmarrja Star Parking është shprehur se, nuk ka aplikuar dhe nuk parashikon të aplikojë asnjë rritje të tarifave të telepasëve, duke i krahasuar këto tarifa me periudhën para marrjes së vendimit nga Komisioni i Konkurrencës, pra për periudhën janar - qershor 2021, detyrimi mujor për ndërmarrjet që operojnë në transportin e udhëtarëve (shërbimi autobus) nga TIA ka qenë 18,000 lekë/muaj për 1 telepas, ndërsa gjatë periudhës së monitorimit kjo tarifë ka qenë 36,000 lekë/copa për 1 telepas. Vihet re një rritje e çmimit të telepasit nga 18,000 lekë/copa në 36,000 lekë/copa.
19. Duke krahasuar tarifat për ndërmarrjet që operojnë në transportin e udhëtarëve nga TIA, nga vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr. 1084, datë 10.05.2024, rezulton se tarifat për këto ndërmarrje vijnë të jenë 36,000 lekë/muaj për një post parkimi, pra nuk vihet re një rritje e çmimit të telepasit.
20. Sa më sipër, mbështetur edhe në shkresën nr. 431/6 prot., datë 22.07.2025, lidhur me zbatimin e pikës III/b të VKK nr. 921/2022, rezulton se ndërmarrja Star Parking Albania SHPK zbaton një metodologji kosto dhe tarifat orientohen drejt koston.
- ii. *Lidhur me angazhimin e pikës III/c: Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK nuk do të zbatojë kushte të pabarabarta me ndërmarrjet të cilat lidhin kontratë me Star Parking për tu pajisur me telepas, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence.*
21. Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK lidhur me angazhimin e pikës “c” ka depozituar një kopje të kontratave të lidhura me subjektet që operojnë në ambientet e parkimit të Star Parking Albania SHPK gjatë periudhës 10 maj 2024 – 10 maj 2025.
22. Nga kontratat e qerasë për poste/vende parkimi të lidhura gjatë periudhës së monitorimit vihet re se, ndërmarrja Star Parking Albania SHPK ka zbatuar kushte të njëjta për të gjitha subjektet.
23. Si përfundim sa më sipër, lidhur me zbatimin e pikës III/c të VKK nr. 921/2022, rezulton se ndërmarrja Star Parking Albania SHPK nuk ka zbatuar kushte të pabarabarta me ndërmarrjet të cilat lidhin kontratë me Star Parking për të pasur një post parkimi.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d) dhe nenin 26, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së monitorimit në zbatim të Vendimit nr. 1084, datë 10.05.2024 “Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 921, datë 09.11.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të aeroportit “Nënë Tereza” (Tirana International Airport) dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK”
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1203, Datë 27. 08. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT, INDIREKT, TË SHOQËRISË TELECOM ITALIA SPARKLE S.P.A. NGA MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCIVE E REPUBLIKËS SË ITALISË DHE RETELIT S.P.A. NËPËRMJET SHOQËRISË BOOST BIDCO S.R.L.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27. 08. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përfitim të kontrollit të përbashkët, indirekt, i shoqërisë TELECOM ITALIA SPARKLE S.P.A. nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Republikës së Italisë dhe RETELIT S.P.A. nëpërmjet shoqërisë Boost BidCo S.r.l..

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfimit të kontrollit të përbashkët, indirekt, i shoqërisë TELECOM ITALIA SPARKLE S.P.A. nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Republikës së Italisë dhe RETELIT S.P.A, nëpërmjet shoqërisë Boost BidCo S.r.l.”

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfimit të kontrollit të përbashkët, indirekt, i shoqërisë TELECOM ITALIA SPARKLE S.P.A. nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Republikës së Italisë dhe RETELIT S.P.A, nëpërmjet shoqërisë Boost BidCo S.r.l.”.

Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: Boost BidCo S.r.l. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Italisë, me objekt aktiviteti zotërimin e aksioneve dhe pjesëmarrje në shoqëri të tjera. Boost BidCo S.r.l. është në pronësi të plotë të Boost HoldCo S.r.l.

Boost HoldCo S.r.l. është një shoqëri e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Italisë, kapitali aksionar i së cilës, në mbyllje të këtij transaksioni, do të zotërohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Republikës së Italisë dhe nga RETELIT S.P.A.

Boost BidCo S.r.l. dhe Boost HoldCo S.r.l. janë shoqëri të themeluara nga RETELIT S.P.A. për qëllime të kryerjes së transaksionit.

RETELIT S.P.A. është shoqëria holding e një grupi italian që ofron shërbime të të dhënave dhe infrastrukturës për tregun e telekomunikacionit, duke përfshirë lidhje me fibra optike për rrjetet *backbone* dhe *backhaul*, si dhe zgjidhje për *housing* dhe *cloud*.

RETELIT S.P.A. nuk ka prani ligjore dhe nuk ka realizuar xhiro në Shqipëri.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Republikës së Italisë është një organ qeveritar i Republikës së Italisë, përgjegjës për politikën ekonomike të shtetit, financat publike, tatimet dhe kontrollin e shpenzimeve publike.

Pala shitëse: Telecom Italia S.p.A. (TIM S.p.A.) është një shoqëri e themeluar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Italisë. TIM S.p.A. është një shoqëri telekomunikacioni, e listuar publikisht, e cila ofron shërbime telekomunikacioni fiks dhe celular, akses në internet, transmetim të të dhënave, riparime dhe shërbime pas shitjes, si dhe telefona dhe aksesorë.

Shoqëria target: TELECOM ITALIA SPARKLE S.P.A. është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Italisë, aktualisht e zotëruar nga TIM. Target administron një rrjet Tier 1 dhe operon në nivel ndërkombëtar përmes rrjetit të saj me fibra optike Seabone, duke përdorur teknologjinë DWDM, e fokusuar në ofrim të shërbimeve ndërkombëtare për operatorë fiks dhe mobil, ISP dhe kompani shumëkombëshe.

TELECOM ITALIA SPARKLE S.P.A. nuk ka prezencë juridike në Shqipëri, megjithatë ajo gjeneron xhiro në tregun vendas përmes marrëveshjeve të shërbimit dhe marrëdhënieve tregtare me operatorë dhe klientë vendas. Këto aktivitete hyjnë në tregjet e furnizimit me shumicë të shërbimeve të Transmetimit të Thirrjeve në Rrjete Ndërkombëtare dhe Shërbimeve me Shumicë të Lidhjes me Internetin.

II. Përqendrimi

Transaksioni i njoftuar do të zhvillohet në dy faza, të cilat janë të ndërlidhura ndërmjet tyre dhe vlerësohen si një transaksion i vetëm.

Në një fazë të parë, palët Telecom Italia S.p.A. (në cilësinë e shitësit) dhe Boost BidCo S.r.l. (në cilësinë e blerësit) kanë lidhur “Marrëveshje blerje aksionesh” më datë [_____].

Në datën e kësaj marrëveshje, shitësi zotërues i 100% të kapitalit aksionar të emetuar dhe të

papaguar të shoqërisë target TELECOM ITALIA SPARKLE S.P.A., pranon t'ia shesë blerësit me titull të plotë pronësie dhe të lira nga çdo barrë aksionet e shitjes. Në përfundim të kësaj faze, blerësi Boost BidCo S.r.l. do të zotërojë plotësisht TELECOM ITALIA SPARKLE S.P.A.

Pas përfundimit të blerjes së plotë të kapitalit të shoqërisë target, pritët që Boost BidCo S.r.l. të bashkohet me TELECOM ITALIA SPARKLE S.P.A., në mënyrë që kjo e fundit të jetë një filial i drejtpërdrejtë i Boost HoldCo S.r.l.

Në një fazë të dytë dhe në të njëjtën ditë me marrëveshjen e mësipërme, palët Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Republikës së Italisë, RETELIT S.P.A. (aksionari), Boost HoldCo S.r.l. dhe Boost BidCo S.r.l. kanë lidhur “Marrëveshja e Investimit dhe Aksionarëve”.

Marrëveshja e Investimit dhe Aksionarëve ka për qëllim që palët të: i) të bien dakord për strukturën e transaksionit dhe angazhimet e secilës palë në lidhje me të dhe ii) të rregullojnë marrëdhëniet dhe interesat e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Italisë dhe RETELIT S.P.A. si aksionarë të ardhshëm të Boost HoldCo S.r.l. dhe aksionarë indirekt të TELECOM ITALIA SPARKLE S.P.A., përsa i përket qeverisjes dhe transferimit të aksioneve në Boost HoldCo S.r.l. Marrëveshja përcakton gjithashtu angazhimet e palëve për të financuar blerjen e aksioneve, e cila do të kryhet nëpërmjet zmadhimit të kapitalit të Boost HoldCo S.r.l. dhe Boost BidCo S.r.l. dhe ose / huave të aksionarëve.

Në përfundim të kësaj marrëveshje, kapitali aksionar i Boost HoldCo S.r.l. do të zotërohet XX% nga Ministria dhe XX% nga RETELIT S.P.A.

Referuar termave të kësaj marrëveshje, vendimmarrja e shoqërisë për çështje të caktuara, do të realizohet në mënyrë të vlefshme vetëm me [_____].

Referuar Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, kapitulli 1.5 Transaksionet e ndërlidhura parashikon se disa transaksione mund të konsiderohen si një përqendrim i vetëm, nëse *kontrolli është përfutur së fundmi nga e njëjta/ të njëjtat ndërmarrje*. Vetëm në këto rrethana, dy ose më shumë transaksione mund të konsiderohen si unike në natyrë dhe si rrjedhim të përbëjnë një përqendrim të vetëm. Është e përshtatshme që të trajtohen si një përqendrim i vetëm, ato transaksione që janë të lidhura ngushtë. Kriteri që përcakton nëse transaksioni është i ndërruarur kërkon që *transaksionet të jenë të lidhura më kusht*. Pika 37 e Udhëzimit parashikon se tregues të mëtejshëm mbi *ndërrarësinë e disa transaksioneve mund të jenë deklaratat e vetë palëve ose përmbylljet e menjëhershme të marrëveshjeve përkatëse*. Parimi se disa transaksione mund të trajtohen si një përqendrim i vetëm zbatohet vetëm nëse rezultati, është që *kontrolli i një ose më shumë ndërmarrjeve përftohet nga i njëjti person ose ndërmarrje*.

Referuar deklaratës së palëve, transaksioni i propozuar është konceptuar, strukturuar dhe zbatuar si një operacion i vetëm ekonomik, i kryer përmes një sekuence hapash të ndërruarur.

Për sa më sipër, transaksioni i propozuar, i cili implementohet përmes marrëveshjeve dhe hapave kontraktuale të ndërruarura, përbën një përqendrim të vetëm.

Transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të përbashkët, indirekt, të shoqërisë TELECOM ITALIA SPARKLE S.P.A. nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Republikës së Italisë dhe RETELIT S.P.A., nëpërmjet shoqërisë Boost BidCo S.r.l., duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

III. Analiza e Konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i: (i) shërbimeve me shumicë të lidhjes së internetit; (ii) shërbimeve ndërkombëtare me shumicë për operatorë; (iii) furnizimit me shumicë të shërbimeve të transmetimit të thirrjeve në rrjete ndërkombëtare; (iv) furnizimit me shumicë të shërbimeve Bulk SMS dhe (v) furnizimit me pakicë të shërbimeve të lidhjes për bizneset, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të përbashkët, indirekt, të shoqërisë TELECOM ITALIA SPARKLE S.P.A. nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Republikës së Italisë dhe RETELIT S.P.A., nëpërmjet shoqërisë Boost BidCo S.r.l.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Republikës së Italisë është një organ qeveritar i Republikës së Italisë, përgjegjës për politikën ekonomike të shtetit, financat publike, tatimet dhe kontrollin e shpenzimeve publike.

Shoqëria RETELIT S.P.A. ofron shërbime të të dhënave dhe infrastrukturës për tregun e telekomunikacionit, duke përfshirë lidhje me fibra optike për rrjetet backbone dhe backhaul, si dhe zgjidhje për housing dhe cloud. RETELIT S.P.A. ka themeluar dy shoqëri për qëllime të kryerjes së transaksionit, Boost BidCo S.r.l. dhe Boost HoldCo S.r.l. RETELIT S.P.A. nuk ka prani ligjore dhe nuk ka realizuar xhiro në Shqipëri.

Shoqëria target TELECOM ITALIA SPARKLE S.P.A. administron një rrjet Tier 1 dhe operon në nivel ndërkombëtar përmes rrjetit të saj me fibra optike Seabone, duke përdorur teknologjinë DWDM. TELECOM ITALIA SPARKLE S.P.A. nuk ka ndonjë subjekt të regjistruar në Shqipëri, megjithatë ajo gjeneron xhiro në tregun vendas përmes marrëveshjeve të shërbimit dhe marrëdhënieve tregtare me operatorë dhe klientë vendas.

Sipas deklaratës së palës, transaksioni i propozuar përfaqëson një mundësi investimi për Ministrinë dhe RETELIT, me qëllim zhvillimin e aktivitetit të tyre dhe zgjerimin e shtrirjes gjeografike të veprimtarisë së tyre. Në veçanti, Ministria ka shprehur interesin për të përfituar kontrollin mbi target, si pjesë e një strategjie më të gjerë të politikës industriale që synon mbrojtjen e aseteve strategjike kombëtare në infrastrukturën dhe shërbimet e telekomunikacionit. Transaksioni paraqet gjithashtu një mundësi për të forcuar pozicionin e Ministrisë dhe RETELIT në treg, si dhe për të

diversifikuar aktivitetet e tyre, pasi veprimtaria e target është plotësuese ndaj asaj që RETELIT ushtron aktualisht.

Transaksioni i propozuar nuk krijon mbivendosje horizontale dhe vertikale midis aktiviteteve të palëve në Shqipëri, për faktin se palët nuk janë të pranishme në tregun përkatës në Shqipëri dhe për këto arsye kushtet e konkurrencës në treg do të mbeten të pandryshuara pas realizimit të transaksionit.

Nga sa me sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët, indirekt, të shoqërisë TELECOM ITALIA SPARKLE S.P.A. nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Republikës së Italisë dhe RETELIT S.P.A., nëpërmjet shoqërisë Boost BidCo S.r.l.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1204, Datë 27. 08. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ILIRIADA SHPK NGA SHOQËRIA 4 A-M SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27. 08. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ILIRIADA SHPK nga shoqëria 4 A-M SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfutimit të kontrollit të shoqërisë ILIRIADA SHPK nga shoqëria 4 A-M SHPK”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfutimit të kontrollit të shoqërisë ILIRIADA SHPK nga shoqëria 4 A-M SHPK. Referuar dokumentit “Kontratë për shitjen e kuotës”, palët në marrëveshje janë:

Pala Blerëse: 4 A-M SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar. Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj; Punime elektrike, tregtim me shumicë e pakicë të materialeve elektrike, import eksportin e tyre, prodhim dhe tregtim betoni dhe

inerte, tregtim me shumicë dhe me pakicë, import-eksport të artikujve të ndryshëm industrial, ushqimore, elektroshtëpiake, konfeksione, kozmetike. Tregtim dhe shitje produktesh artizanati, kimike, tekstile, artikuj plastike. Tregtim produktesh të gatshme me shumicë e pakicë, etj. Në fushën e ndërtimit, të ndërtimeve civile, industriale, turistike, bujqësore, mbi 2 kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme për to. Në fushën e projektimit dhe zbatimin duke përfshirë, por pa u kufizuar, i veprave urbane, civile, industriale, arkitekturore, rrugore dhe hekurudhore, urave dhe veprave të artit, si dhe punime inxhinierike, topografike dhe hidrologjike, inxhinierike të impianteve të prodhimit dhe transmetimit të energjisë etj.

Shoqëria 4 A-M SHPK, zotëron kuota në shoqëritë MD green energy SHPK; O-SP Albania SHA dhe GREEN ENERGY PLUS SHPK.

Pala Shitëse: Z. Ermal Tahiraj shtetas shqiptar, zotërues i XX% të kapitalit të shoqërisë target.

Shoqëria Target: ILIRIADA SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e cila ka për objekt aktiviteti: Shitblerje me shumicë e pakicë, eksport import të mallrave të ndryshme, restorant, hoteleri, turizëm, etj. Karburante e vajra lubrifikante, bimë medicinale, tregtim automjesh. Transport mallrash të të gjitha llojeve e udhëtarëve etj, përpunim druri, prodhim i qymyr drurit, grumbullimi e përpunimi i produkteve bujqësore blegtorale etj. Pyllëzime dhe përmirësime pyjore. Prodhim materiale ndërtimi, inerte gurorë, qeramike, tulla. Ekspertim për vlerësim mjedisi, mbarështim faune, flore dhe peshku. Në fushën e ndërtimit, projektimin dhe zbatimin duke përfshirë, por pa u kufizuar në punime e vepra urbane, civile, industriale, arkitekturore, rrugore dhe hekurudhore, ura dhe vepra të artit, si dhe punime inxhinierike topografike dhe hidrologjike, inxhinierike të impianteve të prodhimit dhe transmetimit të energjisë etj.

Para transaksionit, shoqëria zotërohej në XX% të kapitalit nga z. Ermal Tahiraj dhe në XX% të kapitalit nga z. Arjan Latifi.

II. Përqendrimi

Më datë [] është nënshkruar dokumenti “Kontratë shitblerje pasuri e luajtshme (Kuota Kapitali)” ndërmjet shoqërisë 4 A-M SHPK (blerësi) dhe z. Ermal Tahiraj (shitësit), si palë të kësaj kontrate.

Referuar objektit të kontratës, z. Tahiraj, i shet palës blerëse, shoqërisë 4 A-M SHPK, kuotën që zotëron në shoqërinë ILIRIADA SHPK, e cila përbën XX % kapitalit të regjistruar të shoqërisë target.

Në përfundim të transaksionit, ortakët e shoqërisë target do të jenë shoqëria 4 A-M SHPK, zotërues i 1 (një) kuote, e cila përfaqëson XX% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ILIRIADA SHPK dhe Arjan Latifi zotërues i 1 (një) kuote, e cila përfaqëson XX% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ILIRIADA SHPK.

Nga vlerësimi i transaksionit, shoqëria target do të kontrollohet nga ortaku i shumicës, shoqëria 4 A-M SHPK.

Transaksioni i përfutimit të kontrollit të shoqërisë ILIRIADA SHPK nga shoqëria 4 A-M SHPK përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e Konkurrencës

Bazuar në nenin 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i ndërtimit, duke përfshirë ndërtim linjash elektrike, rrugë, godina, ujësjellës- kanalizime. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Referuar pasqyrave financiare të shoqërisë 4 A-M SHPK, aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është punime & instalime elektrike, tregtim imp-exp materialesh, ndërtim, projektim i pakufizuar i veprave urbane dhe civile etj

Shoqëria target ushtron aktivitetin në tregun e ndërtimit të linjave elektrike, rrugë, godina, ujësjellës- kanalizime.

Transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim horizontal, duke krijuar mbivendosje të aktivitetit të palëve në tregun e ndërtimit, ndërtim linjash elektrike, rrugë, godina, ujësjellës- kanalizime, pasi palët pjesëmarrëse në transaksion operojnë në të njëjtin treg produkti.

Referuar pjesës së tregut të palëve pjesëmarrëse në transaksion, konstatohet se pjesa e vogël e tregut e shoqërisë target pritet që të mos ndikojë në përqendrimin e tregut dhe për më tepër nuk ndikon në krijimin apo forcimin e pozitës dominuese të shoqërisë 4 A-M SHPK.

Për sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ILIRIADA SHPK nga shoqëria 4 A-M SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1205, Datë 27. 08. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË AUSTRIA JUICE GMBH NGA SHOQËRIA AGRANA INTERNATIONALE VERWALTUNGS-UND ASSET-MANAGEMENT GMBH”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27. 08. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë AUSTRIA JUICE GmbH nga shoqëria AGRANA Internationale Verwaltungs-und Asset-Management GmbH.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimëve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë AUSTRIA JUICE GmbH nga shoqëria AGRANA Internationale Verwaltungs-und Asset-Management GmbH”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë AUSTRIA JUICE GmbH nga shoqëria AGRANA Internationale Verwaltungs-und Asset-Management GmbH.

Referuar dokumentit “Kontratë për shitjen dhe transferimin e aksioneve”, palët në marrëveshje janë:

Blerësi: AGRANA Internationale Verwaltungs-und Asset-Management GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit austriak, pjesë e Grupit AGRANA. Grupi AGRANA është një përpunues i lëndëve të para bujqësore, të cilat janë të strukturuar në tre divizione operative: sheqer, niseshte dhe fruta.

Shoqëria AGRANA Internationale Verwaltungs-und Asset-Management GmbH zotëron 50.01% në kapitalin aksionar të shoqërisë target, AUSTRIA JUICE GmbH (Aksioni i AGRANA-s) dhe kontrollin e përbashkët mbi shoqërinë target.

Grupi AGRANA ka një degë në Shqipëri, shoqërinë AGRANA-STUDENT Albania SHPK, e cila është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti: tregtimi me shumicë i sheqerit dhe prodhimeve të tjera ushqimore, si dhe veprimtari të tjera që kanë lidhje me tregtimin me shumicë/pakicë, distribucionin, logjistikën etj.

Shitësi: RWA International Holding GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, e themeluar sipas legjislacionit austriak, me seli të regjistruar në Korneuburg, Austri. RWA International Holding GmbH zotëron XX% në kapitalin aksionar të shoqërisë AUSTRIA JUICE GmbH (Aksioni i RWA-s).

Target: AUSTRIA JUICE GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit austriak. Shoqëria target është një prodhues dhe rishitës i koncentreve të lëngjeve, kryesisht mollët, frutat e kuq, si dhe përbërësit aromatik të pijeve. Ajo operon në 13 vende prodhimi me rreth 1000 punonjës, në Austri, Gjermani, Hungari, Poloni, Rumani, Ukraine dhe Kinë, duke prodhuar një portofol të gjerë të produkteve, lëngjeve të frutave jo nga koncentratet, përbërës të pijeve, aroma natyrale, verëra të frutave dhe mushtit si dhe ëmbëltues të frutave.

Shoqëria AUSTRIA JUICE GmbH nuk ka degë në Shqipëri dhe nuk gjeneron të ardhura.

II. Përqendrimi

Më datë [] shoqëria AGRANA Internationale Verwaltungs-und Asset-Management GmbH (Blerësi) dhe shoqëria RWA International Holding GmbH (Shitësi) kanë nënshkruar “Kontratë për shitjen dhe transferimin e aksioneve”.

Në përputhje me kushtet e kësaj kontrate, Blerësi synon të blejë dhe të marrë Aksionin RWA nga Shitësi dhe Shitësi synon të shesë dhe të transferojë Aksionin RWA tek Blerësi.

Përpara këtij transaksioni, shoqëria AGRANA Internationale Verwaltungs-und Asset-Management GmbH zotëronte XX% në kapitalin aksionar të shoqërisë AUSTRIA JUICE GmbH (Aksioni i AGRANA-s) dhe shoqëria RWA International Holding GmbH zotëronte XX% në kapitalin aksionar të shoqërisë AUSTRIA JUICE GmbH (Aksioni i RWA-s), duke patur kontroll të përbashkët mbi shoqërinë target.

Pas përfundimit të transaksionit të njoftuar, shoqëria target AUSTRIA JUICE GmbH do të zotërohet plotësisht nga shoqëria AGRANA Internationale Verwaltungs-und Asset-Management

GmbH.

Referuar dokumentacionit të palëve, transaksioni i realizuar konsiston në përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë AUSTRIA JUICE GmbH nga shoqëria AGRANA Internationale Verwaltungs- und Asset-Management GmbH, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e Konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit dhe rishitjes së koncentreve të lëngjeve të frutave, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i njoftuar konsiston në përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë AUSTRIA JUICE GmbH nga shoqëria AGRANA Internationale Verwaltungs- und Asset-Management GmbH.

AGRANA Internationale Verwaltungs- und Asset-Management GmbH është një përpunues i lëndëve të para bujqësore, të cilat janë të strukturuar në tre divizione operative: sheqer, niseshte dhe fruta.

Grupi AGRANA ka një degë në Shqipëri, shoqërinë AGRANA-STUDENT Albania SHPK, e cila ka për objekt aktiviteti tregtimin me shumicë të sheqerit dhe prodhimeve të tjera ushqimore.

AUSTRIA JUICE GmbH është një shoqëri austriake, prodhues dhe rishitës i koncentreve të lëngjeve kryesisht nga mollët, frutat e kuqe dhe manaferrat, si dhe përbërësve dhe aromave të pijeve.

Shoqëria target AUSTRIA JUICE GmbH nuk realizon të ardhura në Shqipëri dhe transaksioni i njoftuar nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun e brendshëm.

Për sa me sipër, përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

Për sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë AUSTRIA JUICE GmbH nga shoqëria AGRANA Internationale Verwaltungs-und Asset-Management GmbH.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1206, Datë 27. 08. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRIVE ENERGOTEHNİKA-JUŽNA BAĆKA DOO NOVI SAD DHE ELEKTROMONTAŽA D.O.O. KRALJEVO NGA SHOQËRIA MVM ENERGETİKA ZÁRTKÖRÜEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELİJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27. 08. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërive Energotehnika-Južna Baćka doo Novi Sad dhe ELEKTROMONTAŽA D.O.O. KRALJEVO nga shoqëria MVM Energetika Zártkörűen Működő Részvénytársaság.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërive Energotehnika-Južna Baćka doo Novi Sad dhe ELEKTROMONTAŽA D.O.O. KRALJEVO nga shoqëria MVM Energetika Zártkörűen Működő Részvénytársaság,

VËREN SE :

[_____]

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121,

datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërive Energotehnika-Južna Bačka doo Novi Sad dhe ELEKTROMONTAŽA D.O.O. KRALJEVO nga shoqëria MVM Energetika Zártkörűen Működő Részvénytársaság.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1207, Datë 27. 08. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NGA KRIJIMI I SHOQËRISË JUST FUN BALKANS SHPK NËPËRMJET KONTROLLIT TË PËRBASHKËT NGA SHOQËRITË BALFIN B.V. DHE PIAZ INVESTMENT DOO SKOPJE DHE KRIJIMI I SHOQËRISË JUST FUN DISTRIBUTION SHPK NËPËRMJET KONTROLLIT TË PËRBASHKËT NGA SHOQËRITË BALFIN – BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SHPK DHE PIAZ INVESTMENT DOO SKOPJE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27. 08. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nga krijimi i shoqërisë Just Fun Balkans SHPK nëpërmjet kontrollit të përbashkët nga shoqëritë Balfin B.V. dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje dhe krijimi i shoqërisë Just Fun Distribution SHPK nëpërmjet kontrollit të përbashkët nga shoqëritë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe Raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i krijimit të shoqërisë Just Fun Balkans SHPK nëpërmjet kontrollit të përbashkët nga shoqëritë Balfin B.V. dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje dhe krijimi i shoqërisë Just Fun Distribution SHPK nëpërmjet kontrollit të përbashkët nga shoqëritë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar mbi transaksionin e krijimit të shoqërisë Just Fun Balkans

SHPK nëpërmjet kontrollit të përbashkët nga shoqëritë Balfin B.V. dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje dhe krijimi i shoqërisë Just Fun Distribution SHPK nëpërmjet kontrollit të përbashkët nga shoqëritë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje.

Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në transaksion janë:

Pala 1: Balfin B.V. është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Holandës. Shoqëria vepron si një holding financiar dhe veprimtaria e saj kryesore konsiston në zotërimin dhe administrimin e pjesëmarrjeve në shoqëri të tjera. Balfin B.V. mban pjesëmarrje në një sërë shoqërish të regjistruara në Holandë dhe në Maqedoninë e Veriut dhe në disa raste kontribuon në kapitalin e këtyre shoqërive për të mbështetur zhvillimin e tyre. Fusha kryesore e veprimtarisë së këtyre shoqërive bija është sektori i pasurive të paluajtshme.

Balfin B.V. zotërohet X% nga Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK.

Pala 2: Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: (i) investimi në instrument financiar (të cilët përfshijnë pa kufizime titujt e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërive tregtare, titujt e borxhit, aksionet ose kuotat në fonde investimesh etj), investimin në pasuri të paluajtshme dhe në asete (të prekshme apo të paprekshme), si dhe (ii) ofrimi i shërbimeve të konsulencës për shoqëritë e kontrolluara prej saj dhe/ose nga të tretë (të cilët përfshijnë pa kufizime konsulencën e natyrës financiare, manaxheriale, ligjore, IT, zhvillim softwares etj), në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, etj.

Aksionar i kësaj shoqërie është Z. Samir Mane me X% të kuotave.

Pala 3: PIAZ INVESTMENT DOO Skopje është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Maqedonisë së Veriut, e cila ushtron aktivitetin në ndërtimin e ndërtesave rezidenciale dhe jo-rezidenciale. Veprimtaria kryesore e shoqërisë përqendrohet në zhvillimin e projekteve ndërtimore dhe të pasurive të paluajtshme në territorin e Maqedonisë së Veriut.

PIAZ INVESTMENT DOO Skopje zotërohet X% nga Z. Ilir Papraniku dhe X% nga Z. Arsim Papraniku.

Pala 4: Julian Mane, shtetas shqiptar.

Pala 5: Steven Grunerud, shtetas i huaj.

Ndërmarrja e përbashkët 1: Just Fun Balkans SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: tregtia me shumicë dhe pakicë, importi dhe eksporti, shpërndarja, marketingu dhe shitja e mallrave të konsumit të përditshëm, por pa u kufizuar në artikuj dekorativë për shtëpi, kancelari, lodra, enë kuzhine, produkte sezonale dhe të stilit të jetesës, si dhe organizimi dhe operimi i dyqaneve me marrëveshje

franchise. Ky objekt përfshin të gjitha aktivitetet e dizajnit, promovimit, logjistikës dhe operimit që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me zhvillimin dhe menaxhimin e këtyre dyqaneve dhe platformave online, si dhe ushtrimi i të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me ose plotësojnë, direkt ose indirekt aktivitetin e mësipërm.

Ndërmarrja e përbashkët 2: Just Fun Distribution SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: tregtia me shumicë dhe pakicë, importi dhe eksporti, shpërndarja, marketingu dhe shitja e mallrave të konsumit të përditshëm, por pa u kufizuar në artikuj dekorativë për shtëpi, kancelari, lodra, enë kuzhine, produkte sezonale dhe të stilit të jetesës, si dhe organizimi dhe operimi i dyqaneve me marrëveshje franchise. Ky objekt përfshin të gjitha aktivitetet e dizajnit, promovimit, logjistikës dhe operimit që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me zhvillimin dhe menaxhimin e këtyre dyqaneve dhe platformave online, si dhe ushtrimi i të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me ose plotësojnë, direkt ose indirekt aktivitetin e mësipërm.

II. Transaksionet

I. Më datë [_____], aksionarët: shoqëria Balfin B.V., shoqëria PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, z. Julian Mane dhe z. Steven Grunerud, kanë nënshkruar Aktin e Themelimit dhe Statutin (shtojca A), mbi krijimin e shoqërisë Just Fun Balkans SHPK.

Referuar akteve të miratuara, shoqëria Just Fun Balkans SHPK do të funksionojë si një shoqëri me kohëzgjatje të pakufizuar. Kapitali themeltar i shoqërisë X EUR përbëhet nga (4) katër kuota ku shoqëria Balfin B.V. zotëron X% të kapitalit themeltar (me kontribut X EUR), shoqëria PIAZ INVESTMENT DOO Skopje zotëron X% të kapitalit themeltar (me kontribut X EUR), z. Julian Mane zotëron X% të kapitalit themeltar (me kontribut X EUR) dhe z. Steven Grunerud zotëron X% të kapitalit themeltar, (me kontribut X EUR).

Sipas kontributeve të mësipërme: shoqëria Balfin B.V. zotëron (1) kuotë, të barabartë me X% të kapitalit themeltar, PIAZ INVESTMENT DOO Skopje zotëron (1) kuotë, të barabartë me X% të kapitalit themeltar, z. Julian Mane zotëron (1) kuotë, të barabartë me X% të kapitalit themeltar dhe z. Steven Grunerud zotëron (1) kuotë, të barabartë me X% të kapitalit themeltar.

Bazuar në nenin 9 “Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj”, organi vendimmarrës i shoqërisë do të jetë Asambleja e Përgjithshme, e cila do të vendosë mbi çështje të rëndësishme të shoqërisë ku mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë anëtarë që zotërojnë të paktën 51% të kuotave të nënshkruara me të drejtë vote, sipas nenit 9.2, *përveç sa është parashikuar në nenin 9.3 të Statutit*. Neni 9.3 i Statutit citon se: *Pavarësisht nga neni 9.2, nëse ortakët duhet të votojnë dhe të vendosin në lidhje me ndonjë nga vendimet thelbësore si: (i) ndryshimin e Statutit, duke përfshirë qëllimin tregtar të shoqërisë, (ii) miratimin e emërimit të opsioneve ose të çdo mënyre tjetër të parashikuar nga shoqëria që jep të drejtën për emërtimin e kuotave të reja, (iii) rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të regjistruar të shoqërisë, (iv) shpërndarjen e dividendëve dhe (v) transformimin, ndarjen, bashkimin, dorëzimin e pjesës së*

aktiveve, likuidimin, prishjen ose riorganizimin e shoqërisë në çfarëdo forme, *Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë anëtarë që kanë të paktën X% të totalit të kuotave të nënshkruara me të drejtë vote*. Në këtë rast, vendimet do të miratohen me shumicën e votave prej të paktën X% të ortakëve që marrin pjesë në mbledhje.

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, të shprehë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kuotave që ai zotëron në kapitalin e shoqërisë, *pra secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital*.

Sa më sipër rezulton se: shoqëria Balfin B.V., e cila zotëron X% të kuotave dhe shoqëria PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, që zotëron X% të kuotave arrijnë së bashku X% të totalit të kuotave në miratimin e vendimeve të cilat kërkojnë të paktën X% të ortakëve që marrin pjesë në mbledhje. Ndërmjet anëtarëve të tjerë nuk arrihet pjesëmarrja me të paktën e X% të ortakëve (sipas kuotave) që marrin pjesë në mbledhje.

Shoqëria Balfin B.V. dhe shoqëria PIAZ INVESTMENT DOO Skopje rezultojnë të gëzojnë të drejtën e ushtrimit të influencës vendimmarrëse mbi shoqërinë target Just Fun Balkans SHPK. Referuar Aneksit të Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, citohet se: *Një person fizik me aktivitete të tjera ekonomike ka përfutur kontrollin e përbashkët tek një ndërmarrje dhe është konsideruar si ndërmarrje pjesëmarrëse*. Z. Julian Mane i cili zotëron (1) kuotë, të barabartë me 10% të kapitalit themeltar dhe z. Steven Grunerud i cili zotëron (1) kuotë, të barabartë me 5% të kapitalit themeltar, nuk kanë kontrollin e një ndërmarrje tjetër dhe janë aksioner në shoqërinë target si persona fizik pa të drejtën e ushtrimit të influencës vendimmarrëse mbi shoqërinë target, por gëzojnë të drejtën e aksionerëve pjesëmarrës sipas Aktit të Themelimit dhe Statutit në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

II. Më datë [_____], aksionarët: shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK, shoqëria PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, z. Julian Mane dhe z. Steven Grunerud, kanë nënshkruar Akt Themelimit dhe Statutin (shtojca A), mbi krijimin e shoqërisë Just Fun Distribution SHPK.

Referuar akteve të miratuara, shoqëria Just Fun Distribution SHPK do të funksionojë si një shoqëri me kohëzgjatje të pakufizuar. Kapitali themeltar i shoqërisë X EUR përbëhet nga (4) katër kuota ku shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK zotëron X% të kapitalit themeltar (me kontribut X EUR), shoqëria PIAZ INVESTMENT DOO Skopje zotëron X% të kapitalit themeltar (me kontribut X EUR), z. Julian Mane zotëron X% të kapitalit themeltar (me kontribut X EUR) dhe z. Steven Grunerud zotëron X% të kapitalit themeltar (me kontribut X EUR).

Bazuar në kontributet e mësipërme: shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK zotëron (1) kuotë, të barabartë me X% të kapitalit themeltar, PIAZ INVESTMENT DOO Skopje zotëron (1) kuotë, të barabartë me X% të kapitalit themeltar, z. Julian Mane zotëron (1) kuotë, të barabartë me X% të kapitalit themeltar dhe z. Steven Grunerud zotëron (1) kuotë, të barabartë me X% të kapitalit themeltar.

Bazuar në nenin 9 “Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj” organi vendimmarrës i shoqërisë do të jetë Asambleja e Përgjithshme e cila do të vendosë mbi çështje të rëndësishme të shoqërisë ku mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë anëtarë që zotërojnë të paktën X% të kuotave të nënshkuara me të drejtë vote, sipas nenit 9.2, përveç sa është parashikuar në nenin 9.3 të Statutit. Neni 9.3 i Statutit citon se: Pavarësisht nga neni 9.2, nëse ortakët duhet të votojnë dhe të vendosin në lidhje me ndonjë nga Vendimet thelbësore si: (i) ndryshimin e Statutit, duke përfshirë qëllimin tregtar të shoqërisë, (ii) miratimin e emërimit të opsioneve ose të çdo mënyre tjetër të parashikuar nga shoqëria që jep të drejtën për emërtimin e kuotave të reja, (iii) rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të regjistruar të shoqërisë, (iv) shpërndarjen e dividendëve dhe (v) transformimin, ndarjen, bashkimin, dorëzimin e pjesës së aktiveve, likuidimin, prishjen ose riorganizimin e shoqërisë në çfarëdo forme, *Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë anëtarë që kanë të paktën X% të totalit të kuotave të nënshkruara me të drejtë vote*. Në këtë rast, vendimet do të miratohen me shumicën e votave prej të paktën X% të ortakëve (sipas kuotave) që marrin pjesë në mbledhje (shumicë e cilësuar).

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, të shprehë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kuotave që ai zotëron në kapitalin e shoqërisë, pra secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Sa më sipër rezulton se: shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK, e cila zotëron X% të kuotave dhe shoqëria PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, që zotëron X% të kuotave arrijnë së bashku X% të totalit të kuotave në miratimin e vendimeve të cilat kërkojnë të paktën X% të ortakëve që marrin pjesë në mbledhje. Ndërmjet anëtarëve të tjerë nuk arrihet pjesëmarrja me të paktën e X% të ortakëve (sipas kuotave) që marrin pjesë në mbledhje.

Shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe shoqëria PIAZ INVESTMENT DOO Skopje rezultojnë të gëzojnë të drejtën e ushtrimit të influencës vendimmarrëse mbi shoqërinë target Just Fun Distribution SHPK. Referuar Aneksit të Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, citohet se: *Një person fizik me aktivitete të tjera ekonomike ka përfutur kontrollin e përbashkët tek një ndërmarrje dhe është konsideruar si ndërmarrje pjesëmarrëse*. Z. Julian Mane i cili zotëron (1) kuotë, të barabartë me X% të kapitalit themeltar dhe z. Steven Grunerud i cili zotëron (1) kuotë, të barabartë me X% të kapitalit themeltar, nuk kanë kontrollin e një ndërmarrje tjetër dhe janë aksionar në shoqërinë target si persona fizik pa të drejtën e ushtrimit të influencës vendimmarrëse mbi shoqërinë target, por gëzojnë të drejtën e aksionarëve pjesëmarrës në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Transaksionet e njoftuara konsistojnë në krijimin e shoqërisë Just Fun Balkans SHPK, nëpërmjet kontrollit të përbashkët nga shoqëritë Balfin B.V. dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, dhe krijimin e shoqërisë Just Fun Distribution SHPK, nëpërmjet kontrollit të përbashkët nga shoqëritë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, duke

plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si të tilla kërkojnë autorizimin e Komisionit të Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shpërndarjes me shumicë dhe shitjes me pakicë të produkteve të konsumit të përditshëm jo-ushqimore të markës “Flying Tiger Copenhagen” dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në krijimin e shoqërisë Just Fun Balkans SHPK nëpërmjet kontrollit të përbashkët nga shoqëritë Balfin B.V. dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje dhe krijimin e shoqërisë Just Fun Distribution SHPK nëpërmjet kontrollit të përbashkët nga shoqëritë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje.

Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK është një grup i diversifikuar investimesh, i angazhuar kryesisht në shitjen me pakicë, pasuritë e paluajtshme, veprimtarinë minerare dhe shërbimet bankare.

PIAZ INVESTMENT DOO Skopje ushtron aktivitetin në ndërtimin e ndërtesave rezidenciale dhe jo-rezidenciale dhe nuk ka prezencë juridike dhe nuk ka realizuar xhiro në Shqipëri.

Shoqëria franshizëmarrëse Just Fun Balkans SHPK do të operojë në tregun e shitjes me pakicë të produkteve të konsumit të përditshëm të markës “Flying Tiger Copenhagen”, nëpërmjet dyqaneve të konceptuara dhe operuara nga ku përfshihen produkte të tilla si artikuj dekorativ për shtëpi, lodra, produkte sezonale dhe artikuj të stilit të jetesës.

Shoqëria Just Fun Distribution SHPK do të operojë në tregun e shpërndarjes me shumicë të produkteve të konsumit të përditshëm të markës “Flying Tiger Copenhagen”, i cili përfshin veprimtarinë e importit, magazinimit dhe shpërndarjes. Shoqëria Just Fun Distribution SHPK do të operojë në mbështetje të shoqërisë Just Fun Balkans SHPK.

Shoqëritë e krijuara veprojnë në sektorin e tregtimit të produkteve të artikujve dekorativ për shtëpi, kancelari, lodra, produkte sezonale dhe artikuj të stilit të jetesës, por Just Fun Balkans SHPK në cilësinë e shitësit me pakicë dhe franshizëmarrësit të produkteve të markës ndërkombëtare “Flying Tiger Copenhagen”, ndërsa Just Fun Distribution SHPK në cilësinë e importuesit, magazinuesit dhe shpërndarësit në mbështetje të Just Fun Balkans SHPK.

Nga sa më sipër, konstatohet se krijimi i dy shoqërive të reja, Just Fun Balkans SHPK dhe Just Fun Distribution SHPK do të sigurojë hyrjen e dy ndërmarrjeve konkurruese në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve të konsumit të përditshëm jo-ushqimore, si dhe futjen në treg të një marke të re ndërkombëtare “Flying Tiger Copenhagen”, duke zgjeruar zgjedhjen konsumatore. Eksperienca dhe fuqia ekonomike e ortakeve të shoqërisë, janë siguri për një

ndërmarrje të suksesshme dhe një konkurrent potencial të fuqishëm.

Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nga krijimi i shoqërisë Just Fun Balkans SHPK nëpërmjet kontrollit të përbashkët nga shoqëritë Balfin B.V. dhe PLAZ INVESTMENT DOO Skopje.
2. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nga krijimi i shoqërisë Just Fun Distribution SHPK nëpërmjet kontrollit të përbashkët nga shoqëritë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe PLAZ INVESTMENT DOO Skopje.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1208, Datë 27. 08. 2025

“PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRIVE BALFIN B.V., BALFIN – BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SHPK DHE PIAZ INVESTMENT DOO SKOPJE, PËR MOS NJOFTIMIN BRENDË AFATIT TË PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NDËRMARRJES SË PËRBASHKËT, ME FUNKSIONE TË PLOTA, JUST FUN BALKANS SHPK DHE JUST FUN DISTRIBUTION SHPK”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27 .08. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i sjelljes së ortakëve të shoqërive Just Fun Balkans SHPK dhe Just Fun Distribution SHPK, për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të shoqërive të përbashkëta, me funksione të plota.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, nenet 53, nenet 73 dhe 75 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i krijimit të shoqërisë Just Fun Balkans SHPK nëpërmjet kontrollit të përbashkët nga shoqëritë Balfin B.V. dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, dhe krijimi i shoqërisë Just Fun Distribution SHPK nëpërmjet kontrollit të përbashkët nga shoqëritë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje.”,

VËREN SE :

I. Procedura

Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 666 prot. i AK, datë 15.07.2025 “Njoftim për Përqendrimin që konsiston në krijimin e dy shoqërive të reja lidhur me zgjerimin e markës ndërkombëtare “Flying Tiger Copenhagen” në Shqipëri”, është njoftuar mbi transaksionin e krijimit të shoqërisë Just Fun Balkans SHPK, nëpërmjet kontrollit të përbashkët nga shoqëritë Balfin B.V. dhe

PIAZ INVESTMENT DOO Skopje dhe të shoqërisë Just Fun Distribution SHPK nëpërmjet kontrollit të përbashkët nga shoqëritë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje..

- Më datë 02.05.2025, aksionarët: shoqëria Balfin B.V., shoqëria PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, z. Julian Mane dhe z. Steven Grunerud, kanë nënshkruar Aktin e Themelimit dhe Statutin (shtojca A), mbi krijimin e shoqërisë Just Fun Balkans SHPK.

Sipas kontributeve të ortakeve, shoqëria Balfin B.V. zotëron (1) kuotë, të barabartë me 55% të kapitalit themeltar, PIAZ INVESTMENT DOO Skopje zotëron (1) kuotë, të barabartë me 30% të kapitalit themeltar, z. Julian Mane zotëron (1) kuotë, të barabartë me 10% të kapitalit themeltar dhe z. Steven Grunerud zotëron (1) kuotë, të barabartë me 5% të kapitalit themeltar.

Bazuar në nenin 9 “Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj” të statutit të shoqërisë Just Fun Balkans SHPK , *Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë anëtarë që kanë të paktën 75% të totalit të kuotave të nënshkruara me të drejtë vote*. Në këtë rast, vendimet do të miratohen me shumicën e votave prej të paktën 75% të ortakëve që marrin pjesë në mbledhje.

Nga sa më sipër, shoqëria Balfin B.V. dhe shoqëria PIAZ INVESTMENT DOO Skopje rezultojnë të gëzojnë të drejtën e ushtrimit të influencës vendimmarrëse mbi shoqërinë target Just Fun Balkans SHPK.

- Më datë 06.05.2025, aksionarët: shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK, shoqëria PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, z. Julian Mane dhe z. Steven Grunerud, kanë nënshkruar Akt Themelimit dhe Statutin (shtojca A), mbi krijimin e shoqërisë Just Fun Distribution SHPK.

Sipas kontributeve të ortakeve, shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK zotëron (1) kuotë, të barabartë me 55% të kapitalit themeltar, PIAZ INVESTMENT DOO Skopje zotëron (1) kuotë, të barabartë me 30% të kapitalit themeltar, z. Julian Mane zotëron (1) kuotë, të barabartë me 10% të kapitalit themeltar dhe z. Steven Grunerud zotëron (1) kuotë, të barabartë me 5% të kapitalit themeltar.

Bazuar në nenin 9 “Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj” të statutit të shoqërisë Just Fun Distribution SHPK , *Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë anëtarë që kanë të paktën 75% të totalit të kuotave të nënshkruara me të drejtë vote*. Në këtë rast, vendimet do të miratohen me shumicën e votave prej të paktën 75% të ortakëve që marrin pjesë në mbledhje.

Nga sa më sipër, shoqëria Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe shoqëria PIAZ INVESTMENT DOO Skopje rezultojnë të gëzojnë të drejtën e ushtrimit të influencës vendimmarrëse mbi shoqërinë target Just Fun Balkans SHPK.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksionet e njoftuara konsistojnë në krijimin e

shoqërisë Just Fun Balkans SHPK, nëpërmjet kontrollit të përbashkët nga shoqëritë Balfin B.V. dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, dhe krijimi i shoqërisë Just Fun Distribution SHPK, nëpërmjet kontrollit të përbashkët nga shoqëritë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, të cilët përbëjnë përqendrime në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë janë objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

II. Njoftimi i përqendrimit në shkelje të afatit ligjor

Bazuar në nenin 12, pika 2 e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, një përqendrim duhet të njoftohet pranë Autoritetit të Konkurrencës brenda 30 ditëve nga lidhja e marrëveshjes.

Sipas parashikimit të nenit 53 të ligjit, kanë detyrimin për njoftim: a) ndërmarrjet pjesëmarrëse në bashkim; b) ndërmarrjet që marrin nën kontroll të gjithë ose pjesë të një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera; c) në rast krijimi të një ndërmarrjeje të përbashkët, sipas pikës 3 të nenit 10, ndërmarrjet që kanë kontrollin e ndërmarrjes së përbashkët.

Në rastin e krijimit të shoqërisë Just Fun Balkans SHPK, detyrimin për njoftim e kanë patur shoqëritë Balfin B.V. dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje. Në rastin e krijimit të shoqërisë Just Fun Distribution SHPK, detyrimin për njoftim e kanë patur shoqëritë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje.

Për mos respektim të afatit të përcaktuar, bazuar në nenin 73, pika 1, germa dh) e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës vendos gjobë në masën jo më shumë se 1% e xhiros totale të vitit paraardhës financiar, mbi ndërmarrjet apo grupimet e ndërmarrjeve nëse nuk njofton një përqendrim, sipas neneve 10 dhe 12 të këtij Ligji.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe neni 73, pika 1, germa dh) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të shoqërisë Just Fun Balkans SHPK, nëpërmjet kontrollit të përbashkët, nga shoqëritë Balfin B.V. dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje dhe krijimi i shoqërisë Just Fun Distribution SHPK, nëpërmjet kontrollit të përbashkët, nga shoqëritë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, vendosjen e gjobës mbi:

- a. shoqërinë Balfin B.V., në masën XX ([....]) lekë,
- b. shoqërinë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK, në masën në masën XX ([....]) lekë,
- c. shoqërinë PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, në masën në masën XX ([....]) lekë,

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vendimit.
3. Ngarkohet Sekretariati për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1209, Datë 11. 09. 2025

“PËR NJË KORRIGJIM GABIMI NË PËRLLOGARITJE TË GJOBËS SË VENDOSUR SHOQËRIVE BALFIN B.V. DHE PIAZ INVESTMENT DOO SKOPJE ME VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR. 1208, DATË 27.08.2025, “PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRIVE BALFIN B.V., BALFIN – BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SHPK DHE PIAZ INVESTMENT DOO SKOPJE, PËR MOS NJOFTIMIN BREND A FATIT TË PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NDËRMARRJES SË PËRBASHKËT, ME FUNKSIONE TË PLOTA, JUST FUN BALKANS SHPK DHE JUST FUN DISTRIBUTION SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11. 09 .2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti:

Për një korrigjim gabimi në përlllogaritje të gjobës së vendosur shoqërive Balfin B.V. dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1208, datë 27.08.2025, “Për vendosje gjobe ndaj shoqërive Balfin B.V., Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të ndërmarrjes së përbashkët, me funksione të plota, Just Fun Balkans SHPK dhe Just Fun Distribution SHPK”.

Baza Ligjore:

Neni 2, neni 24, germa d, neni 73 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe neni 112 i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi vlerësimin e gjobës për shoqëritë Balfin B.V. dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje

VËREN SE :

Procedura

Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr.1208, datë 27.08.2025, “Për vendosje gjobe ndaj shoqërive Balfin B.V., Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të ndërmarrjes së përbashkët, me funksione të plota, Just Fun Balkans SHPK dhe Just Fun Distribution SHPK”, vendosi

1. Për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të shoqërisë Just Fun Balkans SHPK, nëpërmjet kontrollit të përbashkët, nga shoqëritë Balfin B.V. dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje dhe krijimi i shoqërisë Just Fun Distribution SHPK ,nëpërmjet kontrollit të përbashkët, nga shoqëritë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, vendosjen e gjobës mbi:
 - a. shoqërinë Balfin B.V., në masën XX ([....]) lekë,
 - b. shoqërinë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK, në masën XX ([....]) lekë,
 - c. shoqërinë PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, në masën XX ([....]) lekë,

Nga verifikimi i të dhënave financiare të shoqërive Balfin B.V. dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje. “Deklaratat”, dërguar pranë Autoritetit të Konkurrencës me e-mail në datë 21.08.2025, Komisioni i Konkurrencës konstatoi se xhiroja nga aktiviteti ekonomik i shoqërisë Balfin B.V është 0 lekë dhe xhiroja nga aktiviteti ekonomik i shoqërisë PIAZ INVESTMENT DOO Skopje është ne vlerën xxx euro ose xxx lekë.

Nga vlerësimi i këtij informacioni, konstatohet se masa e gjobës së vendosur me vendimin nr.1208, datë 27.08.2025 për shoqëritë Balfin B.V. dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje , ka tejkaluar masën e përqindjes sipas parashikimeve të nenit 73 të ligjit.

Për sa më sipër dhe mbështetur në nenin 112 “Korrigjimi i gabimeve materiale në aktet administrative” të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni i Konkurrencës gjykon se është në kushtet që organi publik, në çdo kohë, mund të korrigjojë gabimet në përlllogaritje, të një akti administrativ, dhe mbështetur në nenin 73, pika 1 e ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, përlllogariti dhe korrigjoi masën e gjobës ndaj shoqërive Balfin B.V. dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, duke e vendosur brenda kufijve të përcaktimit ligjor.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe neni 73, pika 1, germa dh) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe nenin 112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të ndryshojë pikën 1, germa a) dhe c) të vendimit nr.1208, datë 27.08.2025, “Për vendosje gjobe ndaj shoqërive Balfin B.V., Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të ndërmarrjes së përbashkët, me funksione të plota, Just Fun Balkans SHPK dhe Just Fun Distribution SHPK”, si më poshtë:

- a. shoqërinë Balfin B.V., në masën XX ([....]) lekë,
 - c. shoqërinë PIAZ INVESTMENT DOO Skopje, në masën XX ([....]) lekë,
2. Ngarkohet Sekretariati për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 1210, Datë 11. 09. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË NRG POWER SHPK NGA SHOQËRITË SUSTAINABLE ENERGY SOLUTIONS S.M.S.A. DHE DEPA COMMERCIAL S.A..”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11. 09. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë NRG Power SHPK nga shoqëritë SUSTAINABLE ENERGY SOLUTIONS S.M.S.A. dhe DEPA Commercial S.A..

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë NRG Power SHPK nga shoqëritë SUSTAINABLE ENERGY SOLUTIONS S.M.S.A. dhe DEPA Commercial S.A..

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i ndryshimit të kontrollit të shoqërisë NRG Power SHPK.

Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në marrëveshje janë:

Blerësi 1: SUSTAINABLE ENERGY SOLUTIONS S.M.S.A. (SENS), është një shoqëri anonime, e regjistruar sipas legjislacionit grek, e angazhuar në zhvillimin dhe operimin e

projekteve të energjisë së rinovueshme dhe asaj konvencionale.

SENS është në pronësi të shoqërisë GEK TERNA S.A., shoqëri e listuar në bursën e Athinës, shoqëria mëmë, përfundimtare e Grupit GEK TERNA. Grupi është aktive në fushën e ndërtimit, infrastrukturës, prodhimit të energjisë elektrike, furnizimit dhe tregtimit të energjisë së pastër nga burimet termike dhe të rinovueshme, furnizimin dhe tregtimin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, koncesioneve, menaxhim të mbetjeve, minierave si dhe menaxhim të pasurive të paluajtshme.

GEK TERNA Holdings, Real Estate & Constructions Societe Anonyme zotëron X% të kuotave në shoqërinë FIER THERMOELECTRIC SHA në Shqipëri.

Blerësi 2: DEPA Commercial S.A. (DEPA), është një shoqëri anonime, e themeluar dhe që vepron sipas legjislacionit të Greqisë, e angazhuar në furnizimin, shitjen me shumicë dhe tregtimin e gazit natyror, si dhe në furnizimin me pakicë të energjisë elektrike.

DEPA Commercial S.A. zotërohet X% nga Fondi i Zhvillimit të Pasurive të Republikës Helenike dhe X% nga Hellenic Petroleum S.A.

DEPA ka realizuar të ardhura në tregun shqiptar, nëpërmjet importit dhe eksportit të energji elektrike në dhe nga Shqipëria.

DEPA Commercial S.A. zotëron X% të kuotave në shoqërinë FIER THERMOELECTRIC SHA në Shqipëri.

Shoqëria **FIER Thermoelectric SHA** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, i cili është pronar, titullar i licencës, zhvillues dhe operator i një termocentrali për prodhimin e energjisë, me turbina me cikël të kombinuar prej rreth 170MW në Roskovec, pranë Fierit, që do të lidhet me sistemin e transmetimit të gazit të Trans Adriatic Pipeline AG.

FIER Thermoelectric SHA zotërohet X% nga GEK TERNA S.A. dhe DEPA, secili, dhe X% nga ABA FTE.

Referuar pasqyrave financiare të vitit X, shoqëria FIER Thermoelectric SHA nuk ka realizuar të ardhura në tregun shqiptar.

Shitësi 1: z. Lorenc Xhumetiku, shtetas shqiptar, zotërues i X% të kapitalit të shoqërisë target.

Shitësi 1: z. Kostaq Milo, shtetas shqiptar, zotërues i X% të kapitalit të shoqërisë target.

Shoqëria Target: NRG Power SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: tregtimi dhe furnizimi (duke përfshirë importin) e energjisë elektrike, gazit dhe çdo segmenti tjetër të sektorit të energjisë, në çfarëdo forme, duke përfshirë telematiken, në Bursat Italiane të Energjisë Elektrike dhe në çdo bursë tjetër të huaj të energjisë elektrike, si dhe tregtimi i Certifikatave Gjellbër dhe Bardhë dhe Certifikatat e Emisionit CO2 (I ashtuquajtur "tregtimi i emetimeve"). Blerja e instrumenteve financiare derivativë në lidhje me secilin segment të sektorit energjetik ose produkt energjetik, megjithëse jo kryesisht të synuara

për shitje tek publiku, me përjashtim të operacioneve të mbledhjes së kursimeve, të cilat janë të rezervuara për institucionet kreditore dhe financiare. Ofrimi i shërbimeve pas kontraktorit, si impiantet dhe teknologjia, me synimin për të optimizuar dhe racionalizuar konsumin e energjisë elektrike, duke përfshirë certifikimin dhe lëshimin e "Certifikatave të Bardha" dhe në çdo rast të gjitha aktivitetet për të cilat ESCO ("Shoqëria e Kursimit të Energjisë") ka të drejte për të kryer. Ofrimi i shërbimeve të konsulencës dhe asistencës teknike lidhur me çështjet e energjisë elektrike, etj.

Shoqëria zotëron një degë në Kosovë, e quajtur NRG Power Shpk Dega në Kosovë, e regjistruar në Agjensionin e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë.

II. Transaksioni

Më datë [____], ndërmjet shoqërive SUSTAINABLE ENERGY SOLUTIONS S.M.S.A. dhe DEPA Commercial S.A. (në cilësinë e blerësve), z.Lorenc Xhumetiku dhe z. Kostaq Milo (në cilësinë e shitësve) është nënshkruar dokumenti "Marrëveshje shitblerje aksionesh", në lidhje me aksionet e NRG POWER SHPK.

Në përputhje me termat dhe kushtet e marrëveshjes, Shitësit do të shesin dhe transferojnë të Blerësit dhe Blerësit do të blejnë dhe marrin nga Shitësit të drejtat ligjor dhe faktike të shitësve mbi Aksionet Objekt Shitje, të lira nga çdo pengesë dhe bashkë me të gjitha të drejtat që lidhen me të, tani dhe në të ardhmen, në mënyrë që secili nga Blerësit të bëhet pronar i vetëm dhe i plotë i aksioneve që përfaqësojnë X% të kapitalit të shoqërisë në mbyllje.

Po në datë [____], palët SUSTAINABLE ENERGY SOLUTIONS S.M.S.A.; DEPA Commercial S.A. dhe NRG POWER SHPK kanë nënshkruar dokumentin "Marrëveshje e Aksionarëve në lidhje me NRG POWER SHPK", e cila ka për qëllim të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e palëve në lidhje me menaxhimin dhe funksionimin e shoqërisë dhe marrëdhëniet mes tyre në kuadër të saj.

Referuar pikës 6.6 dhe 6.7 të marrëveshjes, është parashikuar që kurumi në mbledhjen e ortakëve të shoqërisë duhet të jetë me prezencën e X% të ortakëve dhe vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme do të miratohen në mënyrë unanime. Shoqëria do të këtë [____] administratore, të cilët do të zgjidhen nga secili ortak dhe Bordi i Drejtoreve do të përbehet nga [____] Drejtore, [____] prej të cilëve do të zgjidhet nga SENS-i dhe [____] prej DEPA-s.

Për sa më sipër, transaksioni i njoftuar konsiston në përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë NRG POWER SHPK nga shoqëritë SUSTAINABLE ENERGY SOLUTIONS S.M.S.A. dhe DEPA Commercial S.A., duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenit 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si edhe

Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i furnizimit me energji elektrike dhe treg përkatës gjeografik, territori i Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria SUSTAINABLE ENERGY SOLUTIONS S.M.S.A. është e regjistruar në shtetin grek dhe, sipas informacionit të depozituar nga palët, nuk ka kryer aktivitet dhe nuk ka gjeneruar të ardhura në Shqipëri.

Shoqëria DEPA Commercial S.A., është aktive në tregun e furnizimit, shitjes me shumicë dhe tregtimin e gazit natyror, si dhe në furnizimin me pakicë të energjisë elektrike dhe ka realizuar të ardhura nga eksporti i energjisë elektrike në Shqipëri. Referuara volumit të sasisë së eksportuar në Shqipëri, rezulton se kjo shoqëri ka mbuluar rreth X% të volumit të importeve të realizuar nga sistemi energjetik shqiptar.

DEPA Commercial S.A. kontrollon shoqërinë FIER Thermoelectric SHA, shoqëri e themeluar me qëllimin e ndërtimit të TEC me fuqi prej rreth 170MW në Roskovec, që do të lidhet me sistemin e transmetimit të gazit të Trans Adriatic Pipeline AG. Ndërtimi i TEC është ende në fazën e projektimit.

Shoqëria target, NRG Power SHPK, është licencuar nga ERE në furnizimin me energji elektrike, por nuk ka kryer aktivitet dhe nuk ka realizuar të ardhura gjatë vitit X.

Nëpërmjet këtij transaksioni palët synojnë zgjerimi i aktivitetit të tyre në sektorin e furnizimit të energjisë elektrike jashtë Greqisë si dhe zgjerimi në fushën e furnizimit me energji elektrike në Shqipëri.

Transaksioni i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje horizontale apo vertikale midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në strukturat e tregun shqiptar.

Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë NRG Power SHPK nga shoqëritë SUSTAINABLE ENERGY SOLUTIONS S.M.S.A. dhe DEPA Commercial S.A..

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1211, Datë 11. 09. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. NGA SHOQËRITË EURIZON CAPITAL REAL ASSET SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A. dhe ERSEL ASSET MANAGEMENT SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A.. (i ndryshuar⁵)”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11. 09. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. nga shoqëritë EURIZON CAPITAL REAL ASSET SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A. dhe ERSEL ASSET MANAGEMENT SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A..

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. nga shoqëritë EURIZON CAPITAL REAL ASSET SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A. dhe ERSEL

⁵ Ndryshuar me VKK nr. date 10.10.2025 “PËR NJË KORRIGJIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR.1211, DATË 11. 09.2025, “MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. NGA SHOQËRITË EURIZON CAPITAL REAL ASSET SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A. DHE ERSEL ASSET MANAGEMENT SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A.”.

ASSET MANAGEMENT SOCIETA' DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A.,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. nga shoqëritë EURIZON CAPITAL REAL ASSET SOCIETA' DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A. dhe ERSEL ASSET MANAGEMENT SOCIETA' DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A..

Referuar dokumentit “Marrëveshje Investimi”, të nënshkruar më datë [____], palët në marrëveshje janë:

Investitori 1: EURIZON CAPITAL REAL ASSET SOCIETA' DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A. (ECRA) është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit Italian, me aktivitet kryesor menaxhimi i fondeve. Shoqëria është në pronësi të plotë të EURIZON CAPITAL SGR S.P.A..

EURIZON CAPITAL SGR S.P.A., është shoqëri e krijuar sipas legjislacionit Italian, e regjistruar në Torino dhe pjesë e Grupit Intesa Sanpaolo.

Eurizon është shoqëria administruese e Fondit të Rezervuar ECRA dhe Fondit Jo-Rezervuar ECRA, e cila i ka deleguar ECRA-s të veprorë në emër dhe për llogari të saj në Marrëveshjen e Investimit.

Grupi Intesa Sanpaolo Bank është i pranishëm në Shqipëri përmes filialit të zotëruar tërësisht prej tij INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SHA, një shoqëri që operon në tregun e shërbimeve bankare.

Investitori 2: ERSEL ASSET MANAGEMENT SOCIETA' DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A. (ERSEL) është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit Italian dhe me objekt aktiviteti: ofrimi i shërbimeve të menaxhimit kolektiv të aseteve të kryera përmes promovimit, krijimit dhe organizimit të fondit të investimeve të ndërsjellta dhe administrimit të marrëdhënieve me pjesëmarrësit, si dhe menaxhimit të aseteve të ndërmarrjeve të investimeve kolektive, të institucioneve të saja apo të tjera, përmes investimeve në instrumenta financiar, kreditë, apo prona të tjera; ofrimi i menaxhimit individual të portofolit të investimeve në emër të palëve të treta, krijimi i menaxhimit të fondit të pensionit, etj.

Shoqëria ERSEL i përket grupit bankar të shoqërive ERSEL. Grupi ERSEL nuk ka degë dhe nuk gjeneron xhiro në Shqipëri.

Shitësi: TECHBAU S.P.A. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Italisë.

Target: TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. (TBGE) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Italisë dhe me objekt aktiviteti kryesor: prodhimi i

energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme dhe aktivitet të zgjeruar: të operojë aktivitete që lidhen me impiantet për prodhimin e energjisë nga burime të ripërtëritshme, me fokus të veçantë energjinë.

Shoqëria target aktualisht janë në pronësi të plotë të shoqërisë TECHBAU S.P.A.

Shoqëria TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. nuk ka prezencë ligjore dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri.

II. Transaksioni

Më datë [____], Shoqëria EQUITER SGR S.P.A (në emër dhe për llogari të shoqërisë ERSEL ASSET MANAGEMENT SGR S.P.A, (investitori 1) , EURIZON CAPITAL REAL ASSET SGR S.P.A (investitori 2), TECHBAU S.P.A (shitësi) dhe shoqërisë target TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. kanë nënshkruar “Marrëveshje Investimi”.

Me këtë Marrëveshje, Palët synojnë të rregullojnë termat dhe kushtet e një transaksioni, i cili parashikon hyrjen e Investitorit në kapitalin aksionar të shoqërisë target TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. dhe, në përgjithësi, kapitalizmin e shoqërisë target, që synon ti sigurojë asaj kapitalin e rrezikut të nevojshëm, bazuar në vlerësimin e shitësit, për të përfunduar Impiantet Tokësore në pronësi dhe Impiantet në Çati në pronësi si dhe të rregullojnë qeverisjen korporatave të shoqërisë TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. duke filluar nga data e ekzekutimit.

Në varësi të termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, në varësi të përmbushjes të kushteve precedentë, në Datën e Mbylljes, Shitësi do t’ia shesë Investitorit, i cili do të pranojë dhe blejë nga shitësi, pronësinë e plotë dhe ekskluzive të një pjese prej X% të kapitalit aksionar të shoqërisë (Kuota Investuese), të lirë dhe të pastër nga çdo pengesë.

Transferimi i pronësisë së Kuotës Investuese do të ndodhë në Datën e Mbylljes, me gëzim të plotë të të gjitha të drejtave administrative dhe pronësore që lidhen me të që nga Data e Mbylljes.

Transaksioni i propozuar ka për qëllim të kalojë në disa hapa: (i) Ku me përfundimin e Marrëveshjes së Investimit, rezultat i së cilës JVCo – një mjet korporativ i kontrolluar bashkërisht nga Ersel dhe Ecra do të mbajë një pjesë prej X% të kapitalit aksionar të shoqërisë target TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L., përqindje e cila në bazë të statutit që do të miratohet nga shoqëria target pas përfundimit të transaksionit do tu japë kontroll të përbashkët Investitorëve/Palëve Njoftuese dhe (ii) themelimin nga ERSEL ASSET MANAGEMENT SGR S.P.A dhe EURIZON CAPITAL REAL ASSET SGR S.P.A të një mjeti korporativ në formën e një shoqërie aksionare (JVCo), kapitali i së cilës do të mbahet X% nga shoqëri në pronësi të plotë të EURIZON CAPITAL REAL ASSET SGR S.P.A dhe X% nga fondi EQUITER SGR S.P.A në emër dhe për llogari të shoqërisë ERSEL ASSET MANAGEMENT SGR S.P.A, duke u kontrolluar bashkarisht nga ERSEL ASSET MANAGEMENT SGR S.P.A dhe EURIZON CAPITAL REAL ASSET SGR S.P.A.

Shoqëritë ERSEL ASSET MANAGEMENT SGR S.P.A, EURIZON CAPITAL REAL ASSET SGR

S.P.A, TECHBAU S.P.A dhe TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. kanë rënë dakord për hartimin e tekstit të statutit të ri që do të miratohet nga TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. dhe do të depozitohet në Regjistrin kompetent të shoqërive pas mbylljes.

Marrëveshja e Investimit dhe Marrëveshja e Aksionarëve midis palëve njoftuese, synon krijimin dhe kapitalizimin e JVCo-së, si dhe mekanizmin e qeverisjes korporative të kësaj të fundit. Marrëveshja JVCo-së do të nënshkruhet në [_____].

Pas përfundimit të transaksionit, shoqëria target TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. do të kontrollohet bashkërisht nëpërmjet JVCo, nga ERSEL ASSET MANAGEMENT SGR S.P.A, EURIZON CAPITAL REAL ASSET SGR S.P.A..

Sa më sipër, ERSEL ASSET MANAGEMENT SGR S.P.A dhe EURIZON CAPITAL REAL ASSET SGR S.P.A., do të ushtrojnë kontroll të përbashkët tek shoqëria target pas transaksionit dhe struktura e pronësisë dhe të drejtat e votës janë: (a) EURIZON CAPITAL REAL ASSET SGR S.P.A. dhe ERSEL ASSET MANAGEMENT SGR S.P.A do të mbajnë përkatësisht X% dhe X% të kapitalit aksionar dhe të drejtave të votës në JVCo; (b) JVCo do të mbajë një pjesë prej X% të kapitalit aksionar të shoqërisë target TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. JVCo-së do ti alokohen aksione të shumfishta me të drejtë vote (dy vota për aksion), të cilat do të garantojnë shumicën e votave në mbledhjen e asamblesë (dhe për këtë arsye edhe shoqërisë ERSEL ASSET MANAGEMENT SGR S.P.A dhe EURIZON CAPITAL REAL ASSET SGR S.P.A.), duke i dhënë kështu asaj kontroll ekskluziv mbi shoqërinë target. Pjesa e mbetur prej X% do të mbahet nga pala shitëse TECHBAU S.P.A, aktualisht pronar i shoqërisë target.

Palët synojnë të mbyllin transaksionin deri në fund të muajit [_____].

Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. nga shoqëria ERSEL ASSET MANAGEMENT SGR S.P.A dhe EURIZON CAPITAL REAL ASSET SGR S.P.A., duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet: (i) tregu i prodhimit, integritetit dhe shpërndarjes së sistemeve fotovoltaike dhe (ii) tregu i prodhimit dhe furnizimit me shumicë i energjisë elektrike, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme , tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur.

Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. nga shoqëria ERSEL ASSET MANAGEMENT SGR S.P.A. dhe

EURIZON CAPITAL REAL ASSET SGR S.P.A.

EURIZON CAPITAL REAL ASSET SGR S.P.A. i përket Grupit Intesa Sanpaolo Bank. Grup është i pranishëm në Shqipëri përmes filialit të zotëruar tërësisht prej tij INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SHA, e cila operon në tregun e shërbimeve bankare.

ERSEL ASSET MANAGEMENT SGR S.P.A. është një degë e Grupit Ersel, aktive në menaxhimin e aseteve. Ersel SGR menaxhon fonde të përbashkëta italiane të harmonizuara të diferencuara sipas politikës së menaxhimit, tregut dhe letrave me vlerë, dy fonde pasurish të paluajtshme dhe një fond mbrojtës. Grupi Ersel nuk është aktiv në Shqipëri.

Shoqëria target është një shoqëri italiane, aktive në tregun italian për prodhimin, integrimin dhe shpërndarjen e sistemeve fotovoltaike si dhe tregtimin e energjisë së prodhuar nga këto sisteme, e cila nuk është prezent dhe nuk realizon xhiro në tregun përkatës në Shqipëri.

Për sa më sipër, përqendrimi i njoftuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese pasi nuk do të krijohet mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. nga shoqëritë EURIZON CAPITAL REAL ASSET SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A. dhe ERSEL ASSET MANAGEMENT SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A..
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1212, Datë 11. 09. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM, INDIREKT, TË SHOQËRIVE E.ON ENERGIE ROMÂNIA S.A. DHE E.ON ASIST COMPLET S.A. NGA SHOQËRIA MVM ENERGETIKA ZÁRTKÖRÜEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11. 09. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përfitim të kontrollit të vetëm, indirekt, të shoqërive E.ON ENERGIE ROMÂNIA S.A. dhe E.ON ASIST COMPLET S.A. nga shoqëria MVM Energetika Zártkörűen Működő Részvénytársaság.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të vetëm, indirekt, të shoqërive E.ON ENERGIE ROMÂNIA S.A. dhe E.ON ASIST COMPLET S.A. nga shoqëria MVM Energetika Zártkörűen Működő Részvénytársaság,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i propozuar i përfitimit të kontrollit të shoqërive E.ON ENERGIE ROMÂNIA S.A. dhe E.ON ASIST COMPLET S.A. nga shoqëria MVM Energetika Zártkörűen Működő Részvénytársaság.

Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në marrëveshje janë:

Blerësi: MVM Energetika Zártkörűen Működő Részvénytársaság është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas legjislacionit të Hungarisë, me objekt aktiviteti: Veprimtari të shoqërive holding, instalimi i makinerive dhe pajisjeve industriale, ndërtimi i objekteve të infrastrukturës për energji elektrike dhe telekomunikacion, etj.

Shoqëria MVM Energetika Zártkörűen Működő Részvénytársaság zotërohet 100% nga Shteti Hungarez që vepron përmes Ministrisë Hungareze të Energjisë. MVM është një shoqëri holding me termocentralet e tij, rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike, rrjetin e shpërndarjes së gazit natyror dhe energjisë elektrike, si dhe tregtinë me gaz natyror (nga tregtia me shumicë deri te shërbimet universale) dhe tregtinë me energji elektrike (nga tregtia me shumicë deri te shitja e drejtpërdrejtë tek konsumatorët). Grupi MVM me filialet e tij të huaja operon kryesisht në Republikën Çeke, Serbi, Kroaci, Austri, Sllovaki, Rumani, Zvicër, Maqedoni dhe Kinë.

Grupi MVM nuk ka asnjë filial, degë apo zyrë përfaqësimi në Republikën e Shqipërisë, por ka realizuar të ardhura.

E.ON ROMÂNIA S.A. është një shoqëri aksionare, e themeluar dhe e organizuar sipas ligjeve të Rumanisë, e cila ofron shërbime holding për grupin E.ON Romania.

Target 1: E.ON ENERGIE ROMÂNIA S.A. është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Rumanisë, e cila operon në Rumani biznesin e shitjes me pakicë dhe asistencës teknike për konsumatorin e grupit E.ON, me aktivitet të saj kryesor furnizimin me energji elektrike dhe gaz natyror për konsumatorët. Përveç kësaj, shoqëria ofron në një masë më të vogël, shërbime *Future Energy Home*, që përfaqësojnë zgjidhje individuale ngrohjeje, zgjidhje ftohjeje ku përfshihen dhe teknologjitë tradicionale, ashtu edhe pompat e nxehtësisë së teknologjive të reja, sisteme dhe shërbime ngarkimi për automjete elektrike, si dhe shërbime asistence.

Aktualisht shoqëria E.ON ENERGIE ROMÂNIA S.A. zotërohet X% nga E.ON ROMÂNIA S.A. dhe X% nga Ministria e Energjisë.

Target 2: E.ON ASIST COMPLET S.A. është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Rumanisë, aktive vetëm në Rumani, ku ofron shërbime për konsumatorët, të tilla si instalime pajisjesh, shërbime teknike dhe mirëmbajtje (instalimet e gazit natyror dhe instalime elektrike, panelet fotovoltaike, sistemet e ngrohjes, kaldajat, njësitë e kondicionimit të ajrit dhe pajisjet mbrojtëse).

Aktualisht shoqëria E.ON ASIST COMPLET S.A. zotërohet X% nga E.ON ROMÂNIA S.A. dhe X% nga Sind Gaz S.r.l.

Shoqëritë target nuk kanë asnjë filial, degë apo zyrë përfaqësimi në Republikën e Shqipërisë.

II. Transaksioni

Ndërmjet shoqërisë MVM Energetika Zártkörűen Működő Részvénytársaság (blerësi) dhe

shoqërisë E.ON ROMÂNIA S.A. (shitësi), është nënshkruar “Marrëveshja e Blerjes dhe Shitjes së Aksioneve”, nënshkruar më datë [_____].

[_____].

Pas realizimit të transaksionit të propozuar, shoqëria MVM Energetika Zártkörűen Működő Részvénytársaság, nëpërmjet Sonnet Romania Holding S.A. do të zotërojë X% të kapitalit të shoqërisë E.ON ENERGIE ROMÂNIA S.A dhe X% të kapitalit të shoqërisë E.ON ASIST COMPLET S.A., duke fituar kështu kontroll influencues të tërthortë mbi shoqëritë target.

Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm, indirekt, të shoqërive E.ON ENERGIE ROMÂNIA S.A. dhe E.ON ASIST COMPLET S.A. nga shoqëria MVM Energetika Zártkörűen Működő Részvénytársaság, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenit 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shitjes me pakicë dhe asistencës teknike në lidhje me furnizimin e energjisë elektrike dhe gazit natyror për konsumatorët e grupit E.ON., por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm, indirekt, të shoqërive E.ON ENERGIE ROMÂNIA S.A. (EER) dhe E.ON ASIST COMPLET S.A. (EAST) nga shoqëria MVM Energetika Zártkörűen Működő Részvénytársaság.

MVM Energetika Zártkörűen Működő Részvénytársaság është pjesë e Grupit MVM, i cili nuk ka asnjë filial, degë apo zyrë përfaqësimi në Republikën e Shqipërisë, por ka realizuar të ardhura.

Shoqëritë target nuk kanë asnjë filial, degë apo zyrë përfaqësimi dhe nuk kanë realizuar të ardhura në Republikën e Shqipërisë.

Për sa më sipër, përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përfitim të kontrollit të vetëm, indirekt, të shoqërive E.ON ENERGIE ROMÂNIA S.A. dhe E.ON ASIST COMPLET S.A. nga shoqëria MVM Energetika Zártkörűen Működő Részvénytársaság.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1213, Datë 11. 09. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË IVECO GROUP N.V. NGA SHOQËRIA TML CV HOLDINGS PTE. LTD.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11. 09. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Iveco Group N.V. nga shoqëria TML CV HOLDINGS PTE. LTD.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfitimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Iveco Group N.V. nga shoqëria TML CV HOLDINGS PTE. LTD.,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar për përfitim e kontrollit të vetëm të shoqërisë Iveco Group N.V. nga shoqëria TML CV HOLDINGS PTE. LTD.

Referuar dokumentit “Marrëveshje Bashkimi”, nënshkruar më datë 30 korrik 2025, palët në marrëveshje janë:

Ofertuesi: TML CV HOLDINGS PTE. LTD. është një shoqëri private me përgjegjësi të

kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Singaporit, me ortak të vetëm TATA MOTORS LIMITED dhe me objekt aktiviteti kryesor: mbajtja e shoqërive të tjera holding.

Pala konfirmuese: TATA MOTORS LIMITED është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Indisë, pjesë e Tata Motors Group, e cila prodhon makina, kamionë, furgonë dhe autobusë. Shoqëria TATA MOTORS LIMITED, është e listuar si në Bursën e Bombeit, ashtu edhe në Bursën Kombëtare të Indisë dhe rregullohet nga Bordi i Letrave me Vlerë të Indisë.

TATA MOTORS LIMITED nuk ka prezencë ligjore dhe nuk ka gjeneruar të ardhura në tregun shqiptar në vitin financiar raportues mars 2024/mars 2025.

Shoqëria Target: Iveco Group N.V. është një shoqëri e ngjashme me shoqëri publike, e themeluar sipas legjislacionit të Holandës, dhe me objekt aktiviteti: projektimin, prodhimin, dhe shitjen e kamionëve, automjete të tjera tregtare dhe autobusë, si dhe produkte të sistemit të transmetimit të fuqisë (powertrains) dhe produkte financiare për tregtarët dhe klientët e shoqërisë.

Iveco Group N.V. është një shoqëri tregtare e listuar në bursën e Euronext Milan.

Iveco Group N.V. nuk ka filiale të regjistruara në Shqipëri, por realizon të ardhura nëpërmjet distributorëve vendas dhe aktiviteti i saj në Shqipëri konsiston në shpërndarjen, shitjen dhe ofrimin e shërbimeve pas shitjes të kamionëve dhe autobusëve.

II. Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë TML CV HOLDINGS PTE. LTD. (ofertuesi), shoqërisë TATA MOTORS LIMITED (Pala konfirmuese) dhe shoqërisë Iveco Group N.V. (target) është lidhur “Marrëveshje Bashkimi”, nënshkruar më datë 30 korrik 2025, lidhur me një ofertë në një tender publik nga ofertuesi për të gjitha aksionet e zakonshme të emetuara të shoqërisë.

Në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje Bashkimi, Ofertuesi nuk zotëron asnjë aksion në shoqëri.

Më datë 25 prill 2025, shoqëria ka lidhur Marrëveshje Konfidencialiteti. Bordi i Drejtorëve të shoqërisë Iveco Group N.V. e ka mbështetur në mënyrë unanime dhe të plotë Ofertën dhe ka rekomanduar atë për pranimin nga aksionarët e shoqërisë target.

Ofertuesi ka hyrë në një angazhim të pakthyesëm me Exor NV, aksionari më i madh i shoqërisë target, i cili aktualisht ushtron kontroll të vetëm dhe zotëron 27.06% të aksioneve të zakonshme dhe 43.11% të drejtave të votës të shoqërisë target, në lidhje me ofertën (zotim i pakthyesëm). Exor NV do të: (1) ofrojë të gjitha aksionet e saj të zakonshme në Ofertë; dhe (2) mbështesë plotësisht blerjen dhe do të votojë në favor të rezolutave të Mbledhjes së Përgjithshme të Aksioneve në lidhje me ofertën.

Ofertuesi dëshiron të ketë kontroll të plotë të shoqërisë target (duke përjashtuar Biznesin e Mbrojtjes) në përputhje me kushtet e kësaj marrëveshje, e cila do të kryhet nëpërmjet një oferte

publike vullnetare që do të bëhet nga Ofertuesi për të gjitha Aksionet e Zakonshme.

Transaksioni i propozuar pritet të finalizohet në fund të muajit prill 2026.

Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë Iveco Group N.V. nga shoqëria TML CV HOLDINGS PTE. LTD., duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenit 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu (i) tregu për shpërndarjen e kamionëve dhe autobusëve, dhe (ii) tregu për ofrimin e shërbimeve pas shitjes për kamionët dhe autobusët, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur.

Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë Iveco Group N.V. nga shoqëria TML CV HOLDINGS PTE. LTD.

TML CV HOLDINGS PTE. LTD. është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Singaporit, me objekt aktiviteti mbajtja e shoqërive holding, pjesë e Tata Motors Group.

Tata Motors Group nuk është prezente dhe nuk ka realizuar xhiro në Shqipëri.

Iveco Group N.V. është një shoqëri publike me përgjegjësi të kufizuar, aktive në projektimin, prodhimin dhe shitjen e kamionëve, automjeteve të tjera tregtare dhe autobusëve, si dhe produkteve të sistemit të transmetimit të fuqisë dhe produkte financiare për tregtarët dhe klientët e Iveco-s.

Iveco Group N.V. nuk ka filiale të regjistruara në Shqipëri, por ka realizuar xhiro nëpërmjet distributorëve vendas.

Iveco ka qenë aktive në tregun shqiptar përmes shitjes së kamionëve, dhe vetëm në një masë të kufizuar në shpërndarjen e autobusëve, ndërsa Tata Motors nuk ka qenë aktive dhe nuk ka realizuar xhiro në këto segmente.

Për sa më sipër, përqendrimi i njoftuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese pasi nuk do të krijohet mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Iveco Group N.V. nga shoqëria TML CV HOLDINGS PTE. LTD.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1214, Datë 26. 09. 2025

**“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE AUTORITETIT TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE LIDHUR ME DOKUMENTIN
PËR KËSHILLIM PUBLIK “ANALIZË E TREGUT TELEFONISË FIKSE: TREGJET
ME SHUMICË TË TERMINIMIT DHE TRANZITIMIT TË THIRRJEVE NË
RRJETET TELEFONIKE PUBLIKE NGA VENDNDODHJE FIKSE”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26. 09. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënia e disa rekomandime Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare lidhur me dokumentin nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit “Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse”.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 70 e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE :

1. Këshilli Drejtues i AKEP-it me Vendimin nr. 11, datë 27.08.2025, miratoi nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit “Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse”.
2. AKEP në vijim të bashkëpunimit dhe detyrimeve që përcakton Ligji nr. 54/2024 “Për Komunikimet Elektronike ne Republikën e Shqipërisë”, (Ligji nr. 54/2024), dhe nenet 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (Ligji nr. 9121/2003), me shkresën nr. 1278/2 prot., datë 29.08.2025 (protokolluar pranë AK me nr. 763 prot., datë 01.09.2025), mirëpret komentet e Autoritetit të Konkurrencës për dokumentin e nxjerrë për

këshillim publik, lidhur me “Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse”.

3. Terminimi i thirrjeve nga rrjetet fikse (FTR) është një shërbim me shumicë i ofruar nga operatori i një rrjeti fiks për t’i mundësuar konsumatorëve të rrjetit të tij marrjen e thirrjeve. Kur ofruesit e shërbimeve të thirrjeve nga rrjetet fikse ose mobile ju mundësojnë pajtimtarëve të tyre dërgimin (kryerjen) e thirrjes në numrat e rrjeteve fikse të Republikës së Shqipërisë, ata i paguajnë operatorit që u mundëson terminimin e thirrjes një tarifë me shumicë për këtë shërbim, që quhet ‘tarifa e terminimit të thirrjes në rrjetet fikse’. FTR-të përcaktohen mbi bazë tarifimi për minutë dhe aktualisht, sipas parashikimeve të legjislacionit të tregut të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, janë subjekt rregullimi, rregullim i cili bëhet nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).
4. Bazuar në rregulloren nr. 9, datë 17.07.2009 “Për Analizën e tregut”, e ndryshuar, AKEP analizon për FNT tregjet përkatëse të kësaj rregulloreje si tregje të mundshme për ndërhyrje ex-ante në territorin e Republikës së Shqipërisë në fushën e komunikimeve elektronike, inter alias:
 - Tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjete publike telefonike individuale të ofruara nga vendndodhje fikse. Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve kombëtare nga rrjetet fikse është pjesë e listës së tregjeve të përcaktuar në rregulloren 9/2009 dhe listës së tregjeve në rekomandimin e KE të vitit 2014 dhe pjesë e analizave të mëparshme të realizuara nga AKEP, si i tillë për analizën e këtij tregu nuk është e nevojshme kryerja e testit të tre kriterëve.
 - Ndërsa për tregje të tjera të cilat nuk janë pjesë e listës së tregjeve dhe Rekomandimit të fundit të KE-së, AKEP mbart detyrimin e aplikimit të testit të 3 kriterëve. Në këtë dokument është aplikuar testi i 3 kriterëve për tregun me shumicë të tranzitimit të thirrjeve kombëtare nga vendndodhje fikse.
5. AKEP, duke marrë në konsideratë rrethanat kombëtare harton dokumentin e analizës për shërbimet e komunikimeve elektronike dhe përcakton tregjet përkatëse, dhe në vijim të kësaj analize përcakton nëse në këto tregje ka konkurrencë efektive. Në rastet kur AKEP evidenton se një apo më shumë sipërmarrës ka/kanë Fuqi të Ndjeshme në Treg, atëherë ai vendos masat e nevojshme, të njohura si kushtet dhe detyrimet për sipërmarrësin/sipërmarrësit e përcaktuar me FNT, me qëllim adresimin/parandalimin e problematikave të tregut.
6. Gjatë periudhës 2020 – 2024, në tregun vendas janë shënuar ndryshime të rëndësishme në tregjet e komunikimeve elektronike, si në aspektin e zhvillimeve teknologjike dhe cilësisë së shërbimit, ashtu edhe në aspektin e ndryshimeve strukturore të sipërmarrësve kryesorë që ofrojnë shërbime nëpërmjet rrjeteve fikse dhe atyre mobile. Disa nga zhvillimet kryesore

strukture paraqiten si më poshtë vijon:

- a. *Përfitimi i kontrollit të shoqërisë ACom SHPK nga shoqëria Vodafone Albania sh.a., autorizuar me vendim të Komisionit të Konkurrencës nr. 676, datë 7.2.2020. Ndryshim i cili i ka mundësuar shoqërisë Vodafone Albania të jetë tashmë një ndër konkurrentët kryesorë edhe në tregun e shërbimeve të ofruara nëpërmjet rrjeteve fikse;*
 - b. *Sipas pikës 3 të VKD 23/2020, është vendosur kalimi i detyrimeve të vendosura për FNT (Fuqi të Ndjeshme në Treg), ndaj sipërmarrësit “Acom” sh.p.k tek sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a, në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 24, datë 30.03.2018 “Për përcaktimin e sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese” dhe Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 77, datë 01.10.2018 “Për rregullimin e tarifave të sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese”.*
 - c. *Komisioni i Konkurrencës, me anë të vendimit nr. 855, datë 14.1.2022 ka vendosur për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nga përfitimi i kontrollit nëpërmjet blerjes së 80.27% të aksioneve të shoqërisë Albtelecom sh.a., nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag (4iG Nyrt);*
 - d. *Komisioni i Konkurrencës, me anë të vendimit nr. 869, datë 8.3.2022, autorizoi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Albania Telecom Invest AD nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag;*
 - e. *Këshilli Drejtues i AKEP, me anë të vendimit nr.14, datë 7.11.2022, ka miratuar transferimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave të dhëna sipas regjimit të autorizimit individual dhe regjimit të autorizimit të përgjithshëm, si dhe për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP nga sipërmarrësi “Albtelecom sh.a.” te sipërmarrësi “One Telecommunications sh.a.”;*
 - f. *Këshilli Drejtues i AKEP, me anë të vendimit nr.15, datë 16.12.2022, ka miratuar transferimin e të drejtave të përdorimit të disa frekuencave nga sipërmarrësit “Albtelecom sh.a.” dhe “One Telecommunications sh.a.” tek sipërmarrësi “Vodafone Albania sh.a.”.*
7. Si rezultat edhe i ndryshimeve të ndodhura në tregun e ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike (pika 8), duke filluar nga data 1 janar 2023 One Albania dhe Vodafone Albania ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të dyja tregjet e ofrimit të shërbimeve mobile dhe fikse. Të dy këto shoqëri janë sipërmarrësit me pjesët më mëdha në tregun e ofrimit të shërbimit broadband nëpërmjet rrjeteve fikse për numër pajtimtarësh.
8. Ky dokument që nxirret për këshillim publik përmban analizën e tregut për tregjet përkatës të mëposhtëm:

- i. *Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjete publike telefonike individuale të ofruara nga vendndodhje fikse;*
 - ii. *Tregu me shumicë i shërbimeve të tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse.*
9. Në tregun përkatës të terminimit të thirrjeve secili operator i rrjetit të telefonisë individuale të ofruar nga vendndodhje fikse është me fuqi të ndjeshme në treg pasi është monopolist në ofrimin e terminimit të thirrjeve në rrjetin e vet.
10. AKEP bazuar në përcaktimet e Ligjit nr. 9918/2008 (nenet 31 e në vijim, të Kreut VI mbi Rregullimin e konkurrencës), Rregulloren për Analizën e Tregut, gjatë periudhës 2017–2018 kreu procedurën e analizës së tregut të telefonisë fikse, në përfundim të së cilës u miratuan vendimet e mëposhtme:
 - i. Vendimi nr. 21, datë 30.03.2018, për *“Miratimin e Dokumentit: Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse -Dokumenti përfundimtar”;*
 - ii. Vendimi nr. 22, datë 30.03.2018, për *“Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese për shërbimet e terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjet fikse”;*
 - iii. Vendimi nr. 23, datë 30.03.2018, për *“Përcaktimin e sipërmarrësit One Telecommunications Sh.a., sipërmarrës me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik One Telecommunications drejt numrave gjeografikë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese”;*
 - iv. Vendimi nr. 24, datë 30.03.2018, për *“Përcaktimin e sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese”;*
11. Vendimet e mësipërme të AKEP përmbanin:
 - Përcaktimin e Albtelecom sh.a. sipërmarrës me FNT në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin e vet publik telefonik të ofruara nga vendndodhje fikse dhe në tregun me shumicë të tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike fikse dhe vendosjen e masave rregullues;
 - Përcaktimin e sipërmarrësve (operatorë alternativë) me FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetet e tyre individuale të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese;
 - Përcaktimin e One Telecommunications sh.a sipërmarrës me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik One Telecommunications drejt numrave gjeografikë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese.
12. Në lidhje me statusin e FNT të Albtelecom për terminimin dhe tranzitimin e thirrjeve, AKEP

ne vitin 2018 vendosi detyrimet e mëposhtme:

- Detyrimi i Mosdiskriminimit (Neni 39);
- Detyrimi i transparencës (Neni 40);
- Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42);
- Detyrimi për kontroll të tarifave dhe orientim në kosto (Neni 45).

13. Masat rregulluese ndaj operatorëve Alternativë dhe të One Telecommunications (One Telecommunications fiks) për FNT në terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre në vitin 2018 janë:

- Detyrimi i Mosdiskriminimit (Neni 39);
- Detyrimi i transparencës (Neni 40);
- Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42);
- Detyrimi për kontroll tarife dhe orientim në kosto (neni 45).

*Detyrimet për këta operatorë nuk përfshijnë publikim të RIO-s, si dhe një sërë detyrimesh të tjera të vendosura ndaj Albtelecom. Detyrimi i kontrollit të tarifës përfshin rregullimin nga AKEP të tarifave të terminimit të operatorëve alternativë.

14. Në zbatim të parashikimeve të Kodit të ri të Komunikimeve Elektronike Evropiane, Komisioni Evropian miratoi Rregulloren e Deleguar 2021/654, datë 18.12.2020, për implementimin e një tarife maksimale të përbashkët terminimi në të gjithë Bashkimin Evropian. Sipas kësaj Rregullore, që nga data 1 korrik 2021 ka filluar implementimi i tarifave të përbashkëta të terminimit në vendet e BE-së në vlerën 0.07 eurocent për minutë.

15. Nga të dhënat e paraqitura në këtë document sa më sipër vërehet se tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet telefonike fikse në Shqipëri janë dukshëm më të larta se ato të vendeve të BEREC, si për mesataren e thjeshtë të 37 vendeve ashtu edhe për atë të 27 vendeve të BE. Gjithashtu, tarifa aktuale e terminimit fiks FTR në Shqipëri është shumë herë më e lartë në krahasim me tarifën e përbashkët të terminimit FTR 0.07 eurocent/min e implementuar në vendet e BE.

16. Në kushtet në të cilën ndodhet tregu i telefonisë fikse në vendin tonë, në mungesë të ndërtimit të modelit BU LRIC të pastër, AKEP ka përdorur metodën e rregullimit sipas tarifës mesatare në vendet e BE/rajonit (benchmark). Tregu i telefonisë fikse në vendin tonë karakterizohet nga:

- një normë mjaft e ulët e penetrimit rreth 6.9% për vitin 2024) krahasuar me vendet e tjera në BE dhe rajonit, norma e penetrimit në vitin 2024 u rrit lehtë krahasuar me periudhen pararendese, si pasojë e uljes së bazës së popullsisë nga të dhënat e Census 2023;

- një rënie e ndjeshme e trafikut të thirrjeve të origjinuara nga rrjetet e telefonisë fikse në vite dhe të ardhurave respektive të sipërmarrësve të telefonisë fikse;
 - kërkesa gjithnjë e në rënie e përdorimit të shërbimeve të telefonisë fikse, si rrjedhojë edhe e rritjes së përdorimit në masë të shërbimeve të telefonisë mobile ku përfshihen edhe përdorimi i aplikacioneve OTT.
17. Në mungesë të një modeli kostosh sipas metodës BU-LRIC, duke pasur parasysh karakteristikat e tregu të ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse në Shqipëri, si edhe argumentet e parashtruara sa më sipër AKEP propozon vijimin e rregullimit të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse duke u bazuar në metodologjinë e benchmark.
18. Shërbimet e rrjeteve fikse telefoni dhe/ose internet në Shqipëri ofrohen/janë njoftuar nga rreth 251 sipërmarrës, të cilët zotërojnë rrjetet infrastrukturore të tyre, përfshirë rrjetin e aksesit apo të lidhjes direkt me përdoruesit fundorë, nga të cilët numri i operatorëve që ofrojnë shërbimin e telefonisë fikse (të pajisur me numeracion gjeografik) është 29.
19. Një pjesë e madhe e operatorëve alternativë janë të vegjël dhe me prani shumë të kufizuar rrjeti në zona urbane apo rurale afër qendrave urbane. Sipas të dhënave statistikore të depozituara në AKEP rezulton se numri i operatorëve të aktivë të rrjeteve të telefonisë fikse është 29.
20. Gjatë periudhës 2018–2024, tregu i telefonisë fikse në Shqipëri ka përjetuar një rënie të ndjeshme dhe të vazhdueshme të numrit të pajtimtarëve. Nga rreth 249 mijë pajtimtarë në vitin 2018, ky numër ka zbritur në rreth 165 mijë në fund të vitit 2024, që përfaqëson një ulje me afërsisht 33% në harkun e gjashtë viteve. Vetëm gjatë vitit të fundit (2023–2024), rënia është rreth 4%. Ky trend reflekton zhvillimet strukturore dhe teknologjike në treg, përfshirë, zëvendësimin e telefonisë fikse me shërbime të lëvizshme dhe zgjidhje mbi rrjetet IP (VoIP), zhvillimin e rrjeteve të internetit broadband, që ofrojnë komunikim të integruar dhe më efikas, ndryshimet demografike, veçanërisht reduktimin e popullsisë, të pasqyruar pas regjistrimit të Censusit 2023, që ka ndikuar në përlllogaritjen e normës së penetrimit. Pavarësisht rënies në terma absolutë, norma e penetrimit në vitin 2024 u rrit lehtë në 6.88%, si pasojë e uljes së bazës së popullsisë. Megjithatë, kjo normë mbetet shumë më e ulët krahasuar me mesataren botërore, që është rreth 11% si dhe me vendet e zhvilluara, ku telefonia fikse ende ruan një normë përdorimi rreth 33%. Të dhënat konfirmojnë se rënia e pajtimtarëve nuk është një fenomen i përkohshëm, por një orientim afatgjatë i tregut drejt alternativave më fleksibël dhe bashkëkohore të komunikimit elektronik.
21. Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse për 100 banorë në Shqipëri është dukshëm më ulët se ai në vendet e tjera të rajonit, normat më të larta të pajtimtarëve për 100 banorë për vitin 2023

janë në Serbi (37), Mal të Zi (30), në Maqedoninë e Veriut (24), e ndjekur nga Bosnja Hercegovina me (19).

22. Operatori me pjesën më të madhe në treg është One Albania rreth 81.1 %, i ndjekur nga ASC me rreth 7.1%, Vodafone me rreth 4.4%, OA të tjerë me 5.3% dhe Nisatel me 2.1%. Pavarësisht se numri i pajtimtarëve të telefonisë ka shënuar rënie të vazhdueshme pesha e pjesës së tregut të pajtimtarëve të One Albania ka vazhduar të rritet që nga viti 2018 e në vazhdim, kjo si rrjedhojë e normës së rënies më të lartë të operatorëve të tjerë. Ajo që konstatohet është se për vitin 2024 pjesa e pajtimtarëve për operatorët kryesor ka pësuar rënie krahasuar me vitin 2023, ndërkohë që ASC ka shënuar një rritje të lehtë dhe Nisatel ka pasur rritje me rreth 4%.
23. Aktualisht ASC është operatori alternativ me numrin më të madh të linjave të telefonisë fikse, i cili ka pasur të njëjtin nivel gjatë vitit 2024 krahasuar me vitin 2023. Vlen të vihet në dukje se një pjesë e konsiderueshme e pajtimtarëve të shërbimeve nga rrjete fikse janë përdorues të paketave të integruara, që përfshijnë Internetin broadband fiks dhe IPTV si shërbim kryesor, ndërsa përdorimi i telefonisë fikse është shumë i ulët.
24. Nga të dhënat në këtë dokument evidentohet se One Albania është operatori i vetëm me shtrirje të rrjetit në të gjitha qarqet e vendit, si edhe zotëron një pjesë të konsiderueshme të infrastrukturës kombëtare për ofrimin e shërbimeve nga rrjetet fikse. Operatorët e tjerë, janë të përqendruar në qarqet më të mëdha të vendit, kryesisht zonat me densitet të lartë të popullsisë.
25. One Albania ka ruajtur pjesën më të madhe të tregut për thirrjet dalëse në telefoninë fikse, si rrjedhojë e bazës më të madhe të pajtimtarëve, por ashtu si operatorët e tjerë, edhe ky operator ka regjistruar një rënie të vazhdueshme të volumit të trafikut në këtë segment. Ecuria e pjesëve të tregut për trafikun dalës të One Albania nga 2018 deri në vitin 2024, ka pësuar rënie nga 86% në 2018 në 62% pjesë tregu në vitin 2024. Ndërsa pjesa tjetër e tregut për thirrjet dalëse i përket operatorëve të tjerë të telefonisë fikse, ku në tërësinë e tyre reflektohet rënie e trafikut dalës nga rrjetet e tyre. Në harkun kohor të referuar me sipër, veçanërisht në periudhën 2020-2024, Vodafone Albania ka shënuar një rritje të pjesëve të tregut nga viti 2020 deri në 2024 (nga 7% në rreth 13% në vitin 2024) periudhe kohore në të cilën është realizuar dhe bashkimi me përthithje nga Vodafone për operatorin Abcom.
26. Bazuar në të dhënat e raportuara, për vitin 2024 operatorët me pjesët më të mëdha të tregut broadband fiks për sa i përket treguesit të numrit të pajtimtarëve paraqiten si më poshtë vijon:
 - One Albania zotëron rreth 22% pjesë tregu;
 - Vodafone Albania zotëron rreth 21% pjesë tregu;

- A.S.C zotëron rreth 9% pjesë tregu;
- Abissnet me rreth 6% pjesë tregu;
- Digicom zotëron rreth 5% pjesë tregu;
- Nisatel zotëron rreth 4% pjesë tregu;
- OA (operator të tjerë), me rreth 33% të tregut.

27. Bazuar në ecurinë e pjesëve të tregut për numër pajtimtarësh të telefonisë fikse të One Albania dhe operatorëve alternativë për periudhën 2019-2024. operatori me pjesën më të madhe në treg, për vitin 2024 vazhdon të jetë One Albania me rreth 80.7%, i ndjekur nga ASC me rreth 7.14%, Vodafone Albania me rreth 4.4%, dhe operatorët e tjerë me 7.4%. Ajo që konstatohet është se pavarësisht se pjesa e tregut të One Albania në përqindje ka pësuar rritje, rënia e numrit të pajtimtarëve të këtij shërbimi ka qenë në ulje të vazhdueshme edhe për këtë sipërmarrës.
28. Gjatë vitit 2024, rreth 78% e të ardhurave të këtij tregu janë gjeneruar nga 6 sipërmarrës kryesorë, konkretisht: One Albania (26%), Vodafone sh.a (24%), ASC (8%), Digicom (6%), Abissnet (6%), Nisatel (4%), ndërsa operatorët e tjerë alternativë (OA) kanë gjeneruar rreth 24% të të ardhurave të këtij tregu. Në krahasim me vitin 2023 vihet re një renie e dukshme e One Albania me rreth 26 %, një rritje në peshën e të ardhurave nga Vodafone Albania me 4.5 %, rritje me 13 % nga ASC, rritje me 39 % nga Abisnet ndërsa operatorët e tjerë një rritje rreth 12.6 %.
29. Tregu i shërbimeve fikse po diversifikohet dhe po rristrukturohet, me një tendencë të qartë në favor të operatorëve alternativë më të vegjël (Digicom, Abissnet, ASC), të cilët po fitojnë terren falë ofertave fleksibile dhe investimeve në teknologji të re. Operatorët më të mëdhenj tradicionalë si One Albania janë përballur me sfida që lidhen me mbajtjen e pjesës së tregut dhe rentabilitetin në kushte konkurruese. Rritja e vazhdueshme e Vodafone dhe ASC tregon strategji efektive për integrimin e shërbimeve fikse dhe mobile dhe zhvillimin e infrastrukturës.
30. Shërbimet në nivelin me shumicë janë shërbime të nevojshme për operatorët e rrjeteve fikse dhe celulare dhe ofruesit e shërbimeve që të ofrojnë shërbimet të telefonisë përdoruesve fundorë, pra në nivelin me pakicë. Në nivelin me shumicë shërbimet e nevojshme të operatorëve për të ofruar thirrje drejt rrjeteve të tjera janë origjinimi, terminimi dhe tranzitimi i thirrjeve të cilat janë elemente të nevojshme për të ofruar thirrje telefonike pajtimtarëve të rrjeteve fiks, thirrje drejt pajtimtarëve të rrjeteve fiks dhe për të vijuar thirrjet drejt këtyre pajtimtarëve. Njëkohësisht këto shërbime shërbejnë si inpute edhe për ofrimin e thirrjeve nga rrjetet celulare drejt rrjeteve fikse.

31. Terminimi dhe tranzitimi i thirrjeve në rrjetet fikse janë shërbime me shumicë, të cilët përbën një input të domosdoshëm për operatorët e rrjeteve të tjerë (fikse dhe celulare) që t'u ofrojnë thirrje përdoruesve të rrjetit të vet drejt përdoruesve të një rrjeti fiks.
32. Kontrolli 100% i rrjetit terminues nga secili ofrues i shërbimit të terminimit të thirrjeve në rrjetin e tij, përbën në këtë mënyrë edhe 100% pjesë tregu, duke e identifikuar si monopolist në ofrimin e këtij shërbimi. Ky përcaktim mbi pjesën e tregut në masën 100% nga secili operator i telefonisë fikse ruan të njëjtën linjë arsyetimi të përdorur edhe në analizat pararendëse. Pjesa e tregut të terminimit të thirrjeve drejt abonentëve të rrjetit nuk varet nga madhësia e rrjetit, pasi pavarësisht madhësisë apo numrit të pajtimtarëve në rrjet, secili operator është monopolist në ofrimin e terminimit të thirrjeve drejt abonentëve të vet.
33. Pjesa e tregut prej 100% që secili operator ka në terminimin e thirrjeve në rrjetin e tij, nuk pritet të ndryshojë pasi nuk ka as alternativë teknike për zëvendësimin e tij:
- Teknikisht nuk ka asnjë mundësi për terminimin e thirrjeve nga një rrjet A në një rrjet B pa ndërveprimin e operatorit që zotëron pajtimtarët drejt të cilëve është destinuar thirrja;
 - Barrierat e natyrës teknike janë të paevitueshme për të mundësuar shërbimin e terminimit të një rrjeti tjetër në mungesë të koordinimit dhe gjetjes së një vije sjellje të përbashkët në negociatat që mund të zhvillohen.
34. Në Shqipëri, duke filluar nga data 1.01.2016, AKEP ka përdorur metodën e rregullimit sipas tarifës mesatare në vendet e BE/rajonit (benchmark) duke aplikuar një reduktim të përshkallëzuar (glide path), për unifikimin e tarifës së terminimit (simetrike për të gjithë operatorët fikse). Tarifa e terminimit në rrjetet fikse të ofrimit të shërbimit të terminimit aktualisht është në vlerën maksimale 0.70 lekë/min, e cila është sa tarifa mesatare (benchmark) e vendeve të BEREC që aplikojnë një segment dhe sa mesatarja e tre segmenteve në vendet e BEREC dhe BE, më 1.01.2014.
35. Në përdorimin e metodologjisë së rregullimit sipas tarifës mesatare në vendet e BE/rajonit (benchmark) AKEP ka marrë parasysh Rekomandimin e KE-së Maj 2009 për trajtimin rregullator të tarifave të terminimit në rrjetet mobile dhe rrjetet fikse, si dhe kushtet e tregut të telefonisë fikse në Shqipëri. Rekomandimi i KE-së përcakton vendosjen e tarifave simetrike për FTR sipas kostos së operatorit efikas. Përcaktimi i tarifave të terminimit të orientuara në kosto është në përputhje me kuadrin rregullator (ligji i komunikimeve elektronike Nr.9918, i ndryshuar). Përdorimi i metodologjisë benchmark për përcaktimin e tarifave të terminimit ka gjeneruar rezultate efikase në përcaktimin e tarifave të terminimit. Në rekomandimin e KE (2009/396/EC) i rekomandohet autoriteteve rregullatore mundësia e aplikimit të një metode alternative (siç është metoda benchmark) për vendet që nuk kanë mundësi të implementojnë modelin e kostove LRIC për arsye të burimeve të kufizuara. AKEP do të vijojë me përdorimin e metodës së rregullimit sipas tarifës mesatare në vendet e BE/rajonit (benchmark) për

përcaktimin e tarifave të terminimit në rrjetet fikse (FTR).

36. Tranzitimi i thirrjeve shërben për të lidhur dy rrjete që nuk kanë lidhje direkte me njëri-tjetrin apo kur kjo lidhje direkte nuk konsiderohet ekonomike nga palët. Për tranzitimin e thirrjeve kombëtare One Albania (ish Albtelecom) aktualisht është operator me FNT, mbi të cilin ka masa rregullatore përfshirë dhe kontrollin për tarifat e tranzitimit, të cilat rregullohen nga AKEP.
37. Ky treg është konsideruar si treg i nevojshëm për tu analizuar dhe vlerësuar për FNT, pasi është aplikuar testi i 3 kriterëve në analizat pararendëse, si një imponim nga Rregullorja e Analizës së Tregut të AKEP, që nga momenti që është hequr nga lista e tregjeve të nevojshme për ndërhyrje ex-ante nga BE dhe mbi këtë bazë është analizuar dhe vlerësuar.
38. Tre kriteret e testit të aplikuar dhe në nevojshme për ri-vlerësim në mënyrë sintetike janë:
- i. Barriera të larta hyrjeje në treg: Tregu duhet të karakterizohet nga barriera të larta hyrjeje që pengojnë konkurrencën efektive.
 - ii. Priorja për konkurrencë e pamjaftueshme: Struktura e tregut duhet të tregojë se nëse hiqet rregullimi, konkurrenca nuk do të zhvillohet në mënyrë të kënaqshme brenda një periudhe të arsyeshme kohore.
 - iii. Rregullimi ex-post nuk është i mjaftueshëm: Vetëm mjetet juridike të zbatimit të ligjit të konkurrencës (rregullimi ex-post) nuk janë të mjaftueshme për të adresuar problemet e konkurrencës në treg.
39. Nga analiza e tre kriterëve rezulton se dy prej tyre nuk plotësohet dhe në përputhje me rregulloren e analizës së tregut dhe rekomandimet e KE, tregu me shumicë të shërbimit tranzit të thirrjeve telefonike kombëtare në rrjetet telefonike publike të ofruara nga vendndodhje fikse, nuk plotëson testin e tre kriterëve dhe nuk konsiderohet si treg i justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante, rrjedhimisht konstatohet se: Në tregun përkatës të tranzitimit të thirrjeve kombëtare nuk ka dominancë nga asnjë prej ofruesve të shërbimit të tranzitit kombëtar për thirrjet e telefonisë fikse.
40. Nga sa arsyetuar nga, si dhe në mbështetje të të dhënave statistikore të cituara më sipër, One Albania (ish- Albtelecom) vlerësohet të ketë humbur statusin e fuqisë së ndjeshme. Në bazë të përcaktimeve të ligjit 54/2024, rregullores së analizës së tregut dhe direktivave dhe rekomandimeve të BE/BEREC, propozohet që detyrimet ndaj sipërmarrësit One Albania (ish Albtelecom) për FNT në këtë treg të përcaktuara në analizën pararendëse propozohet të hiqen. Heqja e këtyre detyrimeve propozohet të bëhet pas marrjes së vendimit për FNT dhe masat rregulluese për One Albania (ish- Albtelecom) sipas konkluzioneve të versionit final të kësaj analize tregu, pas këshillimit publik.

41. Në pikën 2, të nenit 92 të ligjit 54/2024, parashikohet se kur një sipërmarrës përcaktohet se ka fuqi të ndjeshme në një treg përkatës, mbi bazën e një analize tregu, të kryer në përputhje me këtë ligj, AKEP-i, sipas rastit, vendos detyrimet e përcaktuara në nenet 93 deri në 99 dhe në nenet 101 dhe 106 të këtij ligji. Në përputhje me objektivat e nenit 5 të këtij ligji, dhe bazuar në parimin e proporcionalitetit, AKEP-i zgjedh mënyrën më efikase dhe me sa më pak ndërhyrje për adresimin e problemeve të evidentuara në analizën e tregut.
42. Pika 3 e Nenit 92 të ligjit 54/2024, përcakton midis të tjerave se AKEP-i vendos detyrimet e përcaktuara në nenet 93 deri 99, 101 dhe 106 të këtij ligji, vetëm për sipërmarrësit që janë përcaktuar me fuqi të ndjeshme në treg, në përputhje me pikën 2 të këtij neni, dhe pa cenuar:
- a) parashikimet për aksesin sipas kreut XII të këtij ligji;
 - b) nenet 58 dhe 36 të këtij ligji, si dhe çdo angazhim që sipërmarrësi që merr të drejtat e përdorimit, ka bërë në kuadrin e një procesi të rinovimit të autorizimit ose përpara dhënies së autorizimit, ose, sipas rastit, ndaj ftesës për aplikim për të drejtat e përdorimit, nenet 135 dhe 145 të këtij ligji dhe dispozitat përkatëse të kreut XIX të këtij ligji, që përmbajnë detyrime ndaj sipërmarrësve, të ndryshme nga ato të përcaktuara si me fuqi të ndjeshme në treg; ose
 - c) nevojën për të përmbushur angazhimet ndërkombëtare.
43. Pika 3, e nenit 90 të ligjit 54/2024, parashikon se kur AKEP-i arrin në përfundimin se një treg përkatës nuk e justifikon vendosjen e detyrimeve rregullatore, në përputhje me procedurën e pikave 1 dhe 2 të këtij neni, ose kur kushtet e parashikuara në pikën 5 të këtij neni, nuk përmbushen, AKEP-i nuk vendos ose nuk mban ndonjë detyrim specifik rregullator në përputhje me nenin 92 të këtij ligji. AKEP-i heq detyrimet e vendosura ndaj sipërmarrësit në tregun përkatës, duke siguruar që palët e ndikuara nga ky vendim të njoftohen në një periudhë të përshtatshme kohore.
44. Në bazë të analizës së kryer për tregjet e telefonisë fikse, rezulton se: Sipërmarrësi One Albania sh.a vlerësohet se përmbush kushtet për t'u shpallur me FNT në: Tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik One Albania të ofruar nga vendndodhje fikse.
45. AKEP gjykon se karakteristikat e tregjeve me shumicë nga FNT e One Albania për terminimin e thirrjeve kombëtare ruajnë të njëjtën natyrë me ato të identifikuara në analizën e mëparshme, kështu që ndaj operatorit me FNT One Albania propozohet që vendosen detyrimet si më poshtë vijon:
- i. Detyrimi i transparencës (Neni 93);
 - ii. Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 95);

- iii. Detyrimi për akses dhe përdorim të elementeve specifike të rrjetit dhe faciliteteve shoqërues (Neni 98);
 - iv. Tarifa e Terminimit (Neni 100).
46. Përveç detyrimeve të cituara më sipër, për One Albania propozohet të zbatohet dhe detyrimet e Ligjit 54/2024 për Marrëveshjet e Aksesit të parashikuara në nenin 94 të këtij ligji, përfshirë afatet kohore të dhënies së ofertës së aksesit kërkuar dhe dorëzimin në afat të MI-ve dhe publikimin/përditësimin e RIO. Detajimi i detyrimeve të operatorëve me FNT në lidhje me interkoneksionin, si edhe RIO janë pjesë e rregullores të Aksesit dhe Interkoneksionit.
47. One Albania duhet të vazhdojë të publikojë gjithashtu marrëveshje të Nivelit të Shërbimit (Service Level Agreement-SLA), si dhe Tregues Kryesorë të Performancës (Key Performance Indicators - KPI) për interkoneksionin sipas përcaktimeve të Rregullores të Aksesit dhe Interkoneksionit.
48. Në kushtet e de-rregullimit të tregut me shumicë të shërbimit tranzit të thirrjeve telefonike kombëtare në rrjetet telefonike publike të ofruara nga vendndodhje fikse, atëherë detyrimet aktuale të vendosura ndaj operatorit One Albania (ish-Albtelecom) nga analizat pararendëse, propozohet të hiqen. Afati për tërheqjen e masave rregullatore në fuqi, përcaktohet në vendimin e KD-se, sipas përcaktimeve të ligjit 54/2024, heqja e detyrimeve bëhet efektive pas marrjes së vendimeve të AKEP (në versionin final të analizës dhe vendimmarrjes përkatëse pas përfundimit të kështillimit publik të këtij dokumenti, si dhe të qëndrimeve përkatëse që do të vlerësohen mbi propozimet e paraqitura në këtë dokument).
49. AKEP ka vlerësuar nëpërmjet analizës, që operatorët alternativë të rrjeteve të telefonisë fikse plotësojnë kushtet për FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale. Në lidhje me masat rregullatore/detyrimet për FNT të këtyre operatorëve AKEP gjykon që të kenë të njëjtat detyrime të vendosura edhe në analizën e tregut të kryer në vitin 2018:
- i. Detyrimi i transparencës (Neni 93);
 - ii. Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 95);
 - iii. Detyrimi për akses dhe përdorim të elementeve specifike të rrjetit dhe faciliteteve shoqërues (Neni 98);
 - iv. Tarifa e Terminimit (Neni 100).
- Detyrimi i mosdiskriminimit përfshin ndalimin e aplikimit të tarifave të ndryshme të terminimit të thirrjeve hyrëse kombëtare për operatorë të ndryshëm kombëtar origjinues të thirrjeve të terminuara në rrjetin e operatorit alternativ. Pra nëpërmjet këtij detyrimi një operator alternativ nuk mund të aplikojë tarifa të ndryshme terminimi për operatorë të ndryshëm si celulare ashtu edhe fiks. AKEP, si edhe në analizat e mëparshme gjykon që

operatorët alternativë të mos kenë detyrim për publikimin e ofertës referencë të interkoneksionit, pasi kjo masë nuk është e nevojshme dhe do të ishte jo-proporcionale.

- Detyrimi i transparencës përfshin publikimin nga operatori alternativ të tarifës/tarifave të terminimit në rrjetin e tij si dhe të adresës së pikës së interkoneksionit me këtë rrjet. Në kushtet e mos-vendosjes së detyrimit për publikim RIO ky detyrim gjykohet i nevojshëm për zbatimin e mos-diskriminimit në tarifa. Detyrimi i dhënies akses për interkoneksion është detyrim që operatorët e rrjeteve publike telefonike të japin akses për terminimin në rrjetet e tyre me qëllim realizimin e interkoneksionit të rrjeteve publike telefonike.
- AKEP propozon që tarifat e terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet e operatorëve që ofrojnë shërbimin e telefonisë fikse të rishikohen sipas vlerave dhe afateve të mëposhtme, ku për përcaktimin e tarifave të terminimit është përdorur tarifa e përcaktuar në rregulloren e BE 2021/654 (Commission Delegated Regulation (EU) 2021/654), si edhe krahasimi me tarifat mesatare të vendeve të rajonit.

50. Sa më sipër, AKEP ka ngritur disa pyetje rreth këtij dokumenti për Këshillim Publik, si vijon:

51. *Cili është opinionimi juaj për stadin aktual të tarifave të terminimit të thirrjeve kombëtare të telefonisë fikse dhe reduktimin e përshkallëzuar sipas metodologjisë së benchmarkut të vendeve të BE-së dhe rajonit?*
52. Lidhur me pyetjen e parë, tarifat e terminimit të thirrjeve kombëtare të telefonisë fikse në Shqipëri kanë shënuar rënie të vazhdueshme vitet e fundit, por mbeten në disa raste mbi nivelet mesatare të BE/rajonit; pra, reduktimet e propozuara që përdorin metodologjinë e benchmark-ut me vendet e BE dhe të rajonit duken të arsyeshme. Vlerësohet se i një glide-path i justifikuar duhet të jetë i orientuar drejt kostos dhe në mbikëqyrje dhe për efektet apo reflektimin në ofertat pakicë.
53. *Çfarë mendoni në lidhje me ecurinë e tregut të telefonisë fikse në Shqipëri, a pritët të ketë ndryshime në pjesët e këtij tregu?*
54. Lidhur me pyetjen e dytë, tregu pakicë i telefonisë fikse ka pasur tkurrje të numrit të abonentëve dhe të volumit të thirrjeve (trend 2018–2024), dhe pjesa e të ardhurave nga fiksi ka pësuar ndryshime strukturore për shkak të konvergjencës me shërbimet broadband dhe ofertave të integruara. Kjo pritët të vazhdojë: pjesa e tregut për shërbimet tradicionale fikse do të ulet, ndërsa shërbimet të cilat përfshijnë broadband/VoIP mund të zënë më shumë hapësirë. Prandaj priten ndryshime në pjesët e tregut (veçanërisht për operatorin incumbent vs alternativët). Vlerësohet se një monitorim i vazhdueshëm i ndarjes së tregut dhe hyrjeve/daljeve të operatorëve është i nevojshëm.

55. *A jeni dakord me përfundimet e AKEP për përkufizimin e tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet individual fikse?*
56. Lidhur me pyetjen e tretë, përkufizimi i tregut si “terminimi i thirrjeve në rrjete publike telefonike individuale të ofruara nga vendndodhje fikse”, është në përputhje me praktikën e Komisionit Evropian/BEREC dhe me natyrën teknike të shërbimit të terminimit. Ky përkufizim i lejon rregullatorit analizën e FNT për secilin rrjet individual, gjë që është e arsyeshme kur ekzistojnë dallime strukturore dhe të qasjes midis operatorëve.
57. *A mendoni se të gjithë operatorët aktivë të rrjeteve telefonike publike fikse, përmbushin kriteret për FNT në terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale?*
58. Lidhur me pyetjen e katërt, pavarësisht se në tregun përkatës të terminimit të thirrjeve secili operator i rrjetit të telefonisë individuale të ofruar nga vendndodhje fikse është me fuqi të ndjeshme në treg pasi është monopolist në ofrimin e terminimit të thirrjeve në rrjetin e vet, nuk është realist të thuhet se “të gjithë” operatorët përmbushin kriteret për FNT. Operatorët alternativë me pjesë të vogla tregu dhe varësi nga infrastrukturat e të tjerëve zakonisht nuk plotësojnë kriteret për FNT prandaj vlerësohet për një aplikim të diferencuar të masave dhe identifikim të qartë të operatorëve që plotësojnë testin e FNT.
59. *A mendoni se në kushtet aktuale dhe në përputhje me gjetjet nga evidenca statistikore të referuara në dokument, tregu i tranzitimit të thirrjeve kombëtare të telefonisë fikse nuk është e nevojshme të ketë ndërhyrje ex-ante, pra ky treg duhet të jetë i de-rregulluar?*
60. Lidhur me pyetjen e pestë, bazuar në evidencën statistikore dhe analizën e kryer nga AKEP për periudhën 2018–2024, vërehet se tregu i tranzitimit të thirrjeve fikse ka pësuar ndryshime të ndjeshme strukturore. Konkretisht, pjesa e tregut e One Albania ka rënë ndjeshëm, ndërkohë që operatorë alternativë kanë hyrë dhe janë bërë aktivë në këtë treg, duke siguruar një nivel të mjaftueshëm konkurrence. Aktualisht, nuk identifikohen barrierat ligjore apo strukturore të hyrjes që do të justifikonin mbajtjen e këtij tregu nën rregullim ex-ante. Në këto kushte, duke qenë se tregu nuk plotëson më testin e tre kriterëve, mendojmë se nuk është e nevojshme ndërhyrja ex-ante dhe se tregu i tranzitimit të thirrjeve kombëtare fikse duhet të de-rregullohet.
61. *A mendoni se çdo mosmarrëveshje e mundshme në tregun e tranzitit të thirrjeve kombëtare të telefonisë fikse është e mundur të adresohet për zgjidhje nga rregullatori i fushës AKEP dhe se instrumentet ligjore sigurojnë zgjidhje efikase në raste hipotetike të mosmarrëveshjeve të mundshme?*

62. Lidhur me pyetjen e gjashtë, po, mosmarrëveshjet e mundshme në tregun e tranzitimit të thirrjeve fikse mund të adresohen nga AKEP përmes kuadrit ligjor ekzistues, i cili parashikon mekanizma efektivë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet operatorëve.
63. *Çfarë mendoni për masat rregullatore të propozuara në këtë dokument për terminimin e thirrjeve kombëtare në rrjetet fikse?*
64. Lidhur me pyetjen e shtatë: Masat rregullatore të propozuara nga AKEP për terminimin e thirrjeve kombëtare në rrjetet fikse janë të arsyeshme dhe të balancuara, duke siguruar konkurrencë efektive, qasje të barabartë për operatorët alternativë dhe transparencë në tarifat e terminimit. Ato adresojnë fuqinë e ndjeshme të operatorit dominues dhe barrierat për hyrje, ndërkohë që ruajnë interesin e konsumatorëve.
65. *Cili është opinionimi juaj në lidhje me skemën e re të reduktimit të FTR të të gjitha rrjeteve fikse?*
66. Lidhur me pyetjen e tetë: Skema e re e reduktimit të FTR të të gjitha rrjeteve fikse është e arsyeshme dhe pozitive, pasi promovon konkurrencë efektive, çmime më të ulëta për përdoruesit si dhe tarifat e terminimit janë të unifikuara (simetrike për të gjithë operatorët fiks).
67. Edhe pse dokumenti i AKEP “Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse”, analizon tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve fikse, çdo vendim mbi tarifat në nivel shumice ka pasoja të drejtpërdrejta në tregun e pakicës. Tarifat e shumicës përbëjnë një kosto hyrëse për operatorët dhe, si të tilla, ndikojnë në çmimet që u ofrohen konsumatorëve finalë. Ulja e tarifave të shumicës duhet të shoqërohet me një monitorim të kujdesshëm për të siguruar që përfitimet të reflektohen tek konsumatorët finalë dhe jo të mbeten thjesht në nivelin e operatorëve.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Ti rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, që gjatë zbatimit të masave të parashikuara në dokumentin “Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse”, të ketë në vëmendje ndikimin që reduktimi i kostove të shumicës mund të prodhojë në tregun e pakicës, me qëllim sigurimin që përfitimet e rregullimit të

reflektohen edhe në interes të konsumatorit final.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1215, Datë 26. 09.2025

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR. 1171, DATË 26.03.2025 “PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE PËR NDËRMARRJET: OTP BANK ALBANIA SHA, BANKA KOMBËTARE TREGTARE SHA, CREDINS BANK SHA, BANKA RAIFFEISEN SHA, BANKA E TIRANËS SHA, INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SHA, UNION BANK SHA, E-BUSINESS SOLUTIONS SHPK, BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË SHA, BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA DHE ABI BROKER SIGURIMESH SHA DHE NË TREGUN E KREDIDHËNIES ME SIGURIM JETE PËR KREDITË QË JEPEN BRENDA BANKËS BANKËS SË PARË TË INVESTIMEVE SHA DHE BANKËS PROCREDIT SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26. 09. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1171, datë 26.03.2025 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA”.

Bazë ligjore: Neni 4, neni 9, neni 24, germa (d), neni 26 dhe neni 43, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit

të Konkurrencës:

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1171, datë 26.03.2025 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar për të vlerësuar sjelljen e bankave në tregun e sigurimit të jetës për kredi.
2. Për realizimin e procedurave hetimore bazuar në nenin 33 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, janë kërkuar të dhëna dhe informacione nga bankat e nivelit të dytë si dhe nga shoqëritë e sigurimit për vlerësimin e konkurrencës në tregun në tregun e sigurimit të jetës për kredi.
3. Gjatë procedurës së hetimit të thelluar janë realizuar komunikime të vazhdueshme me bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e sigurimit dhe kredimarrësit, si në formë shkresore ashtu edhe përmes intervistave e inspektimeve. Shumë nga përgjigjet e ardhura kanë qenë jo ezauruese për Sekretariatit e Autoritetit, çka ka detyruar të rikërkohet informacion dhe të bëhen kërkesa për saktësim ose plotësim të të dhënave të paraqitura.
4. Koha e mbetur pas depozitimit të informacionit rezulton e pamjaftueshme për përpunimin, vlerësimin dhe analizimin e sjelljes së bankave në tregun e sigurimit të jetës për kredi, duke e bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit brenda afatit të përcaktuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1171, datë 26.03.2025.
5. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraparak me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në treg, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 9, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1171, datë 26.03.2025 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA”, pika “III”, të ndryshohet si vijon:

“III. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 10 Tetor 2025.”.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1216, Datë 26. 09. 2025

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË NJËSISË SË BIZNESIT TË SHOQËRISË CAPITANI S.R.L. NGA SHOQËRIA ILLYCAFFÈ S.P.A.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26. 09. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të vetëm të Njesisë së Biznesit të shoqërisë CAPITANI S.R.L. nga shoqëria ILLYCAFFÈ S.P.A.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfitimit të kontrollit të vetëm të Njesisë së Biznesit të shoqërisë CAPITANI S.R.L. nga shoqëria ILLYCAFFÈ S.P.A.,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përfitim të kontrollit të vetëm të Njesisë së Biznesit të shoqërisë CAPITANI S.R.L. nga shoqëria ILLYCAFFÈ S.P.A.

Referuar dokumentit “Marrëveshje Kuadër”, nënshkruar më datë [...], palët në marrëveshje janë:

Blerësi: ILLYCAFFÈ S.P.A. është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Italisë, me objekt aktiviteti kryesor: përpunimi i çajit dhe kafesë dhe aktivitet dytësor: prodhim i makinerive për përpunimin e ushqimit, pijes dhe duhanit, tregti me shumicë jo të specializuar.

ILLYCAFFÈ S.P.A. operon si në kanalet e shitjes me pakicë ashtu dhe në ato jashtë vendit në nivel global, dhe shpërndan produktet e saj përmes shitjeve direkte dhe indirekte, kafeneve me françizë dhe platformave të tregtisë elektronike.

ILLYCAFFÈ S.P.A. zotërohet nga Gruppo ILLY me XX% të kapitalit, Ambrosia Holdings SARL me 20% të kapitalit, Sunshine S.R.L me XX% të kapitalit dhe Finilly A S.R.L. me XX% të kapitalit.

Gruppo ILLY nuk ka degë apo zyrë përfaqësimi në Shqipëri, por ka gjeneruar të ardhura nga shitjet tek një shpërndarës lokal i produkteve të mëposhtme të markës ILLY.

Shitësi: CAPITANI S.R.L. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Italisë, me objekt aktiviteti: prodhimi i pajisjeve elektrike shtëpiake, përpunimi i çajit dhe kafesë, etj. CAPITANI S.R.L. kontrollohet tërësisht nga aksionarët, znj. Anna Capitani, znj. Cinzia Capitani dhe znj. Gionata Capitani dhe është pronare, ndër të tjera, e Njesisë së Biznesit të angazhuar në prodhimin dhe tregtimin e makinave për ushqim, pije dhe makinave të kafes me kapsula dhe mbushje (Biznesi i Target).

Pala shitëse dhe shoqëria target nuk kanë degë apo zyrë përfaqësimi në Shqipëri. Biznesi i Target ka gjeneruar xhiro shumë të kufizuar në Shqipëri, gjatë vitit 2024.

CAPITANI S.R.L., në përputhje me marrëveshjen e arritur me blerësin, krijoi shoqërinë target ALPHA SRL, tek e cila do të transferohet Biznesi i Targetit nëpërmjet kontributit në natyrë.

Shoqëria Target: ALPHA SRL është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Italisë. ALPHA SRL aktualisht zotërohet 100% nga CAPITANI S.R.L.

II. Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë CAPITANI S.R.L. (shitësi), znj. Anna Capitani, znj. Cinzia Capitani dhe znj. Gionata Capitani (aksionerë të palës shitëse) dhe shoqërisë ILLYCAFFÈ S.P.A. (blerësi) është lidhur “Marrëveshje Kuadër”, nënshkruar më datë 01 gusht 2025.

Referuar termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshje, [...]

[...]

[...]

[...]

Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm të Njesisë së Biznesit të shoqërisë CAPITANI S.R.L. nga shoqëria ILLYCAFFÈ S.P.A., duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shitjes së makinave të kafesë për përdorim shtëpiak, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm të Njesisë së Biznesit të shoqërisë CAPITANI S.R.L. nga shoqëria ILLYCAFFÈ S.P.A.

ILLYCAFFÈ S.P.A. është një shoqëri aktive në prodhimin, marketingun dhe shpërndarjen e kafesë Premium dhe produkteve të lidhura me të.

Shoqëria blerëse nuk ka asnjë filial, degë apo zyrë përfaqësimi në Shqipëri, por ka realizuar të ardhura kryesisht nga shitja të një shpërndarës lokal i produkteve të markës ILLY si kapsula kafeje IPSO, pako kafeje 250 g (produkt kafeje për kanalin shtëpiak) dhe pako kafeje 3kg/1.5 kg, të cilat janë të destinuara për kanale profesionale.

ALPHA SRL është një shoqëri e themeluar për qëllime të transaksionit nga shoqëria Capitani S.R.L. Capitani zotëron njësinë e biznesit të angazhuar në prodhimin dhe tregtimin e makinave për ushqim, pije dhe makinave të kafes me kapsula dhe mbushje, e cila do t’i transferohet Targetit.

CAPITANI dhe Target nuk kanë prezencë ligjore në Shqipëri por kanë realizuar xhiro përmes Njesisë së Biznesit nga shitja e makinave të kafesë me kapsula ose me mbushje dhe pjesë këmbimi për makinat.

[...]

Nga analiza e mësipërme, u konstatua se përqendrimi i njoftuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese pasi nuk do të krijohet mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të vetëm të Njesisë së Biznesit të shoqërisë CAPITANI S.R.L. nga shoqëria ILLYCAFFÈ S.P.A..
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1217, Datë 26. 09. 2025

**MBI MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR PËRJASHTIMIN E DISA KATEGORIVE TË MARRËVESHJEVE TË KËRKIMIT
DHE ZHVILLIMIT”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26. 09. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbi miratimin e Rregullores “Për përjashtimin e disa kategorive të marrëveshjeve të kërkimit dhe zhvillimit”.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Draft - rregullores “Për përjashtimin e disa kategorive të marrëveshjeve të kërkimit dhe zhvillimit”

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për përjashtimin e disa kategorive të marrëveshjeve të kërkimit dhe zhvillimit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

<https://caa.gov.al/wp-content/uploads/2025/11/VENDIMI-NR-1217MBI-MIRATIMIN-E-RREGULLORES.pdf>

**VENDIMET E
KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS**

2025

BULETINI ZYRTAR



2025